
PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XXXVI, viti 2007

	Faqe
<hr/>	
<i>Procesi i Integritimit dhe Reforma Ligjore:</i>	
Impakti i anëtarësimit në BE në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Shqipërisë	
Alfred KELLERMANN	4
Sigurimi i standarteve të larta të cilësisë në aktivitetin legjislativ të parlamentit	
Mimoza PANO	35
<hr/>	
<i>E Drejta Parlamentare:</i>	
Kontroll partiak mbi legjislatura të bazuara në komisione? Rasti i Parlamentit European	
Richard WHITAKER	41
Korrupsioni dhe karrierat politike, refleksione mbi rastin italian	
Donatella DELLA PORTA	78
<hr/>	
<i>E Drejta Kushtetuese:</i>	
Raport i Grupit të të Urtëve mbi mënyrat dhe mjetet për garantimin e efektshmërisë afatgjatë të Gjykatës Europiane	
	104
<hr/>	
<i>Legjislacioni i miratuar:</i>	
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	
Filip LAKO	136
<hr/>	

TABLE OF CONTENTS:

36th issue, year 2007

Page

Integration Process and Legal Reform:

Impact of the membership in EU within the legal order
of the Republic of Albania

Alfred KELLERMANN 4

Assuring high quality standards in the legislative
activity of Parliament

Mimoza PANO 35

Parliamentary Law:

Party control in a Committee-Based Legislature? The Case of the European
Parliament

Richard WHITAKER 41

Corruption and political carriers; reflexions on Italian case

Donatella DELLA PORTA 78

Constitutional Law:

Report on the ways and manners to guarantee a longterm effectiveness of the
European Court

104

Legislation passed by the Assembly:

Information on laws passed by the Assembly

Filip LAKO 136

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Analizë ligjore mbi ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit

*Qendra e Studimeve
Parlamentare*

Kjo analizë ka për qëllim të nxjerrë në pah kuadrin ligjor dhe institucional në bazë të të cilit realizohet regjistrimi, shqyrtimi, verifikimi dhe ndjekja e procedurave lidhur me ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit, problemet përkatëse, si dhe të rekomandojë masa që synojnë rritjen e përgjegjshmërisë së gjyqtarit ndaj publikut. Raporti është përgatitur në kuadrin e zbatimit të projektit “Ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit: Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së gjyqësorit ndaj publikut”, mbështetur nga Programi i Shtetit Ligjor të USAID.

I. ANKESAT E QYTETARËVE NDAJ GJYQËSORIT

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 parashikon të drejtën e qytetarëve për të bërë ankesë, si një nga të drejtat themelore.

“Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.”¹

Ashtu si në shumë vende europiane, edhe në Shqipëri tri janë institucionet kryesore, të cilat kanë juridiksion lidhur me verifikimin e ankesave të qytetarëve ndaj gjyqësorit. Në këtë analizë do të përqendrohemi në

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 48

veprimtarinë që kryen Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Presidentit të Republikës në lidhje për ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit.

Ligji nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”² evidentojnë, ndërmjet funksioneve të tjera, rolin që Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Inspektorati i tij luajnë në verifikimin e ankesave të qytetarëve.

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Inspektoratit të saj, kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.³ Përveç inspektimit tematik të përgjithshëm, Ministria e Drejtësisë kryen edhe inspektime të veçanta lidhur me procedimin disiplinor të gjyqtarëve, në bazë të ankesave të marra nga qytetarët dhe institucionet e tjera.

Në bazë të Kushtetutës, Presidenti i Republikës është Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.⁴ Në pozitën e tij si Kryetar, ai thërret dhe drejton mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe kujdeset për zbatimin e ligjit gjatë zhvillimit të mbledhjeve dhe për marrjen e vendimeve.⁵

Emërimet e gjyqtarëve bëhen me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Vendimi, për t’i propozuar Presidentit të Republikës emërimin e një gjyqtari, merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe shpallet publikisht.⁶ Gjate viteve të

²Rregullore Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, miratuar me vendimin nr. 195, datë 5.7.2003.

³ Ligji nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, neni 6 (9)

⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 147 (2)

⁵ Ligji nr. 8811, datë 17/5/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 11

⁶ Ibid, neni 30

fundit, Presidenti i Republikës, në një numër të konsiderueshëm, rastesh nuk i ka dekretuar propozimet e ardhura nga KLD-ja. Rastet e para të mosdekretimeve hapën një diskutim të gjerë në radhët e KLD-së dhe të bashkësisë ligjore në përgjithësi. Shumë juristë ishin të mendimit se propozimet e KLD-së duhej të miratoheshin, por ato dekretohen nga Presidenti i Republikës, pasi Presidenti nuk ka kompetencë kushtetuese të rrëzojë propozimet e një trupe profesionale, siç është Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Megjithatë, dispozita kushtetuese e vendos emërimin e gjyqtarëve, në mënyrë tipike, sipas parimit të kontrollit dhe balancës (check & balance). Pra, Presidenti i Republikës nuk mund të kryejë i vetëm emërimin e një gjyqtari, nëse nuk vihet në lëvizje nga propozimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Por, nga ana tjetër, as Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk është ekskluziv në emërimin e një gjyqtari pasi, pas propozimit të tij, kërkohet dekreti i Presidentit të Republikës për përfundimin e procesit të emërimit të gjyqtarit.

Numri i konsiderueshëm i mosdekretimeve të Presidentit solli edhe diskutime të tjera nëse cenohej ose jo karriera e gjyqtarëve. Është e vërtetë që çdo gjyqtar ka të drejtën e tij për të bërë karrierë, por, nga ana tjetër, nuk ka detyrim të Presidentit të Republikës të promovojë ata gjyqtarë që nuk plotësojnë kriteret dhe standardet për të bërë karrierë. Vërtet që kandidatët i plotësojnë kriteret që janë vendosur në ligj dhe ndoshta kaq ka marrë për vlerësim dhe KLD kur ka votuar propozimet e veta. Por, në këtë rast nuk bëhet fjalë për një të drejtë substanciale, por për një të drejtë potenciale. Pra, kriteret e vendosura në ligj duhet të jenë bazë për fillimin e vlerësimit të një kandidature, por, promovimi i një gjyqtari përfshin dhe elemente të tjera që plotësojnë figurën e tij, të tilla si: pjekuria e duhur njerëzore dhe profesionale për t'u promovuar; aftësitë e duhura profesionale për të ngjitur shkallët e karrierës dhe plotësimi i standardeve të etikës së gjyqtarit.

Praktika e vendosur nga Presidenti i Republikës për shqyrtimin e informacionit dhe të dhënave të gjyqtarëve të propozuar nga KLD-ja për dekretim, është bazuar në tri grupe të dhënash: volumi i punës dhe cilësia e

punës së gjyqtarit (p.sh. numri i çështjeve të gjykuara, i çështjeve të kthyera nga gjykatat e shkallëve më të larta etj.) ankesat e qytetarëve dhe ndjekja e ecurisë së kësaj ankese, si dhe informacione nga institucione të tjera. Pra, marrja në konsideratë e ankesave të qytetarëve është një element i rëndësishëm për vlerësimin e emërimit ose të vlerësimit të një gjyqtari. Verifikimi i ankesave të qytetarëve bëhet nëpërmjet Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kjo praktikë e vendosur nga Presidenti i Republikës ishte një risi në procedurat e emërimit dhe të promovimit të gjyqtarëve. Si e tillë, ndoshta ka nevojë për më tepër kristalizim praktike në marrjen e vendimit. Ndoshta është e natyrshme që Presidenti i Republikës nuk mund të shpjegojë arsyet dhe shkaqet për dekretimin ose mosdekretimin e një gjyqtari, pasi, edhe për arsyet e paraqitura më sipër, Presidenti nuk mund të shpjegojë diskrecionin e tij për promovimin e gjyqtarëve. Për më tepër, kur, nga shërbime të specializuara ka informacione që nuk mund të bëhen publike. Për këtë shkak do të ishte ndoshta e nevojshme që gjyqtarët në momentin e dorëzimit të aplikimit të tyre të marrin përsipër edhe përgjegjësitë që mbart promovimi. Pra, të heqin dorë vullnetarisht nga imuniteti i tyre për këtë fazë të procesit, në mënyrë që emërimi dhe promovimi i tyre të bëhet sipas standardeve më të mira të mundshme. Gjithashtu, nga KLD-ja është parë e nevojshme vendosja e një afati, brenda të cilit Presidenti jep vendimin e tij për dekretimin ose mosdekretimin e propozimit të KLD-së⁷.

Cili është niveli i ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me të drejtën për të bërë ankesë?

⁷ Rregullore e Komisionit të Shqyrtimit të kandidatave për gjyqtarë. (Vendimi nr.137, datë 21.2.2003). Neni 12 i kësaj Rregulloreje përcakton se, në qoftë se Presidenti i Republikës brenda 30 ditëve nuk bën emërimin e kandidatit të propozuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ky i fundit, nga kandidaturat konkurruese, i paraqit Presidentit propozimin për një kandidat tjetër.

Numri i ankesave pranë KLD-së është gjithnjë e në rritje. Kjo reflektohet në numrin e ankesave të regjistruara në zyrën e protokollit dhe në regjistrin e veçantë të ankesave që mban Inspektorati i KLD-së. Çdo vit, janë rreth 100 ankesa të dërguara në KLD, të cilat nuk konsistojnë në shkelje të mundshme të disiplinës.⁸

II. JURIDIKSIONI

Ligji nr. 8811, datë 17 maj 2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë” parashikojnë detyrat dhe funksionet e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë verifikon ose i dërgon Ministrin të Drejtësisë për trajtim ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera që i drejtohen Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati verifikon vetëm ato ankesa, të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Verifikon ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera drejtuar Ministrin të Drejtësisë, të cilat gjykohen prej tij për t’u ndjekur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.⁹

Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe 9 gjyqtarë, të të gjitha niveleve, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.¹⁰

Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbëhet nga Kryeinspektori dhe inspektorët. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit

⁸ Revista “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore”, Botimi nr. 26 i Qendrës së Studimeve Parlamentare.

⁹ Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 16 (1) (a)

¹⁰ Ibid, neni 3

dhe numri i inspektorëve përcaktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Kryeinspektori dhe inspektorët emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Zëvendëskryetarit. Kandidaturat e inspektorëve përzgjidhen, pas shpalljes publike, ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t' u emëruar gjyqtarë në gjykatat e apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet.¹¹

Objekti i veprimtarisë së Inspektoratit të KLD-së është përqendruar në mbledhjen e të dhënave rreth veprimtarisë së gjykatave dhe gjyqtarëve, nëpërmjet verifikimit të ankesave, inspektimit të gjykatave, inspektimit të gjyqtarëve dhe vlerësimit të aftësive të tyre profesionale, mbi të cilat Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvillon përgjegjësitë e tij ligjore.¹²

Aktualisht vetëm gjashtë inspektorë operojnë pranë Inspektoratit të KLD-së. Gjatë bisedimeve, të mbajtura me përfaqësues të këtij Inspektorati, u theksua se numri i inspektorëve që operojnë aktualisht është shumë i vogël dhe ngarkesa e punës është shumë e madhe. Kryeinspektori vendos se cili inspektor do të jetë i ngarkuar me verifikimin e një çështjeje të caktuar, duke u bazuar në ngarkesën e punës së inspektorit, si dhe në bazë të drejtimit të punës, pra rretheve ku ai është duke punuar në momentin e caktimit të detyrës së re. Në praktikë nuk ekzistojnë kritere të përcaktuara në ligj ose në rregullore lidhur me caktimin e çështjeve inspektorëve të KLD-së dhe kjo mund të çojë në njëfarë subjektiviteti nga ana e Kryeinspektorit.

III. REGJISTRIMI I ANKESËS

Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë” rregullon punën dhe veprimtarinë e Inspektoratit. Ankesat drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të depozitohen

¹¹ Ibid, neni 14

¹² Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 1

nëpërmjet shërbimit postar ose drejtpërdrejt në zyrën e protokollit. Ankesat e depozituara në zyrën e protokollit i kalojnë menjëherë për trajtim Kryeinspektorit.

Ankesat e depozituara, si dhe ato të bëra publike nëpërmjet medias, regjistrohen në Regjistrin e Ankesave. Regjistri i Ankesave është i ndarë në rubrika, të tilla si: identiteti i ankuesit, gjykata ose gjyqtari ndaj kujt adresohet ankesa, lënda e ankesës, lloji i shkeljes së pretenduar, data e nxjerrjes së urdhrin të verifikimit, inspektori i ngarkuar për verifikim, data e marrjes së ankesës dhe urdhri i verifikimit nga inspektori, data e depozitimit të praktikës së verifikimit nga inspektori. Regjistri i Ankesave mbahet nga Kryeinspektori.¹³

Regjistri mbahet në mënyrë manuale dhe elektronike, por ky i fundit nuk reflekton progresin e çështjeve. Rregullorja e Inspektoratit të KLD-së nuk parashikon ndonjë dispozitë që lejon aksesueshmërinë e regjistrin nga ana e publikut. Në Inspektoratin e KLD-së theksohet se Regjistri është i aksesueshëm nga qytetarët. Në këtë këndvështrim, mungesa e dispozitave ligjore që parashikojnë aksesueshmërinë e regjistrin jo domosdoshmërisht nënkupton ndalimin e këtij aksesi, përderisa nuk ekzistojnë rregulla për të këtë qëllim.

IV. VERIFIKIMI I ANKESËS

Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë” parashikon një informacion të plotë lidhur me formën dhe objektin e ankesës. Ankesa duhet të ketë të paktën elementet e mëposhtme, në mënyrë që të merret në konsideratë për verifikim nga ana e Inspektoratit:

¹³ Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 25.

a) Faktet ose rrethanat që kanë të bëjnë me mosfunksionimin normal të zyrës së gjyqtarit.

b) Faktet ose rrethanat që mund të konsiderohen shkelje në referim të detyrave gjyqësore të gjyqtarit, të cilat përgjithësisht kanë të bëjnë me mosrespektimin formal të ligjit, me mosrespektimin e solemnitetit gjatë gjykimit, me planifikimin dhe organizimin e punës, si dhe me sjelljen e gjyqtarit gjatë ose jashtë gjykimit, që nga ana tjetër kanë ndikuar ose tregojnë dukshëm për zvarritje të pajustificuar të procesit.

c) Faktet ose rrethanat që mund të konsiderohen shkelje në referim të normave të sjelljes dhe etikës së gjyqtarit.¹⁴

Rregullorja përcakton faktet dhe rrethanat që nuk konsistojnë në objektin e verifikimit të ankesave. Në këtë këndvështrim, Rregullorja ka sjellë diçka të re për sa i përket kritereve të domosdoshme për fillimin e procedimit.

Inspektorati ka detyrimin të verifikojë vetëm ato ankesa, të cilat nuk mund të zgjidhen me anë të apelimit gjyqësor ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues

Fillimi i procesit të verifikimit

Procesi i verifikimit është rregulluar deri në njëfarë mase nga Rregullorja e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Por Rregullorja nuk parashikon hapa të detajuar dhe konkrete që duhet të ndiqen për verifikimin e ankesave. Kur ankesa i drejtohet Inspektoratit të KLD-së, ajo i a kalon për trajtim Kryeinspektorit.

Sipas nenit 147 pika 6 te Kushtetutës, gjyqtari mund të shkarkohet nga KLD-ja për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore ose fizike, për akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Pra, inspektorët nuk mund të trajtojnë përmbajtjen e çështjes.

¹⁴ Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 24 (1)

Pra, për të qenë sa më në përputhje me dispozitën kushtetuese, e cila përcakton se gjyqtari mund të shkarkohet për arsye profesionale vetëm nëse shkel etikën ose për pamjaftueshmëri profesionale, si dhe për vlerësimin sa më real dhe të paanshëm të punës së një gjyqtari, KLD-ja ka miratuar një sistem vlerësimi për gjyqtarët, i cili është testuar në tri gjykata pilot. Aktualisht KLD-ja po analizon efektet dhe ndryshimet në këtë sistem vlerësimi.

Inspektorati i KLD-së mban qëndrimin, në bazë të të cilit Kryeinspektori është autoriteti i vetëm i ngarkuar lidhur me ankesat ndaj gjyqësorit, duke përfshirë këtu jo vetëm ankesat e dërguar drejtpërdrejt në KLD, por, gjithashtu, edhe ato të referuara nga institucione si: Zyra e Presidentit, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Ministrave dhe Avokati i Popullit.

Gjatë bisedimeve të mbajtura me përfaqësues të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, u theksua se ky Inspektorat kryen inspektime të pavarura nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në bazë të dispozitave ligjore që janë në fuqi, të dy inspektoratet, ai i KLD-së dhe ai i Ministrisë së Drejtësisë kanë juridiksion për të kryer verifikime të pavarura nga njëra-tjetra. Në praktikë, të dy inspektoratet mund të ngrenë grupe pune të përbashkëta, për të kryer inspektime lidhur me ankesat e qytetarëve.

Bashkëpunimi midis dy inspektorateve është rregulluar rishtazi nga Marrëveshja e Bashkëpunimit (*Memorandum of Cooperation*), e cila përcakton skemën për një marrëdhënie pune të hapur dhe pozitive ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me synimin për të vendosur një mirëkuptim të përbashkët dhe për të ngritur kuadrin procedural për inspektimin e gjyqtarëve dhe gjykatave, për të kryer funksione, të cilat ata i ndajnë në përputhje me ligjin. Kjo Marrëveshje nuk synon në asnjë mënyrë të zëvendësojë dispozitat e zbatueshme të ligjeve përkatëse. Kjo Marrëveshje, më shumë se sa një ndarje të kompetencave, shpreh një vullnet të mirë dhe një angazhim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së me qëllim të dyanshëm: të zgjidhë konfuzionin ligjor lidhur me disa koncepte për sa i përket inspektimit të gjyqtarëve dhe gjykatave, terminologjisë ligjore,

riorganizimit të procedurave të inspektimit të gjyqësorit, si dhe praktikës.¹⁵

Marrëveshja e Bashkëpunimit thekson se në bazë të përgjegjësive të caktuara me ligj, për sa i përket verifikimit të ankesave të bëra nga individë ose persona juridikë lidhur me shkeljet gjyqësore ose jashtë gjyqësore nga anëtarë të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, Ministri i Drejtësisë dhe KLD-ja marrin përsipër të bashkëpunojnë për sa i përket:

a) *Standardizimit të procesit të verifikimit të ankesës.* Si rezultat, shërbimet e inspektimit të gjyqtarëve dhe gjykatave, nga të dy institucionet, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të udhëhiqen nga një akt normativ, i cili përcakton në detaje hapat që duhet të ndërmerren lidhur me veprimet dhe bashkëveprimet, fazat dhe ndarjen në kohë, organizimin, burimet dhe kushtet e kërkuara nga momenti i marrjes së ankesës deri në dorëzimin e raporteve të verifikimit pranë autoriteteve përkatëse;

b) *Standardizimit të procedurës së regjistrimit të ankesave.* Procedura e standardizimit, e përmendur më sipër, duhet të parashikojë përgatitjen e një regjistri të ankesave në Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është organizuar për sa i përket formës, përmbajtjes, duke lejuar një shkëmbim efektiv të të dhënave dhe informacionit, si dhe një sistem kompjuterik të përbashkët për të dy institucionet në të ardhmen.¹⁶

V. VLERËSIMI I ANKESËS

Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë” parashikon vlerësimin paraprak të ankesës. Në çdo rast, Kryeinspektori, pasi studion ankesën dhe materialet bashkëngjitura asaj, vlerëson nëse ka vend për verifikim. Çdo rast Kryeinspektori ia relaton

¹⁵ Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë të Drejtësisë së Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, datë 13 korrik 2006.

¹⁶ Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë të Drejtësisë të Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, datë 13 korrik 2006.

Zëvendëskryetarit dhe, me miratimin e tij, urdhëron arkivimin ose kryerjen e verifikimit të ankesës. Në rastin kur ankesa vlerësohet e papërshtatshme në formë dhe në përmbajtje dhe kur urdhërohet arkivimi i saj, ankuesit i kthehet menjëherë përgjigje nga Kryeinspektori, ku parashtrihen shkaqet dhe arsyet e moskryerjes së verifikimit.

Në rastin kur vlerësohet se ka vend për verifikim të ankesës, Kryeinspektori me urdhër ngarkon për kryerjen e tij një ose disa inspektorë.

Zëvendëskryetari, kur e vlerëson të përshtatshme verifikimin e një ankesë, mund t'ia ngarkojë Kryeinspektorit.¹⁷

Inspektori, në çdo rast, pavarësisht nga detyrat e lëna në urdhrin e verifikimit, verifikon vërtetësinë e pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, si dhe kryesisht çdo çështje që lidhet me funksionimin ose veprimtarinë normale të gjyqtarit, që është e dukshme dhe që mund të konsiderohet nga ligji si shkelje disipline.

Në çdo rast verifikimi, inspektori vë paraprakisht në dijeni kryetarin e gjykatës dhe gjyqtarin përkatës, duke i njohur ata me ankesën dhe urdhrin e verifikimit.

Përfundimisht, me urdhër të Zëvendëskryetarit ose Kryeinspektorit, gjyqtari mund të mos njihet me përmbajtjen e ankesës, kur vlerësohet se kjo do të shkaktojë një situatë të papërshtatshme, por në çdo rast gjyqtarit i bëhen të ditura pretendimet e ankuesit.

Në rastin kur vërehet se ankesa lidhet me një proces gjyqësor që është në gjykim e sipër, inspektori duhet të marrë të gjitha masat dhe të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura që veprimtaria e tij të mos ndikojë në pavarësinë e gjyqtarit ose të gjyqtarëve të asaj çështje konkrete dhe as të përcillet në mënyrë të tillë. Në këtë rast, verifikimi kryhet vetëm për pretendime që lidhen me zvarritje të procesit gjyqësor ose për çështje të etikës së gjyqtarit.¹⁸

¹⁷ Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 27.

¹⁸ Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 30.

Në përputhje me verifikimin, inspektori përgatit raportet për të gjitha veprimet verifikuese të kryera prej tij.

Verifikimi i ankesës dhe dorëzimi i informacionit nga inspektori para Kryeinspektorit bëhet jo më tej se 30 ditë nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin e Ankesave. Ky afat mund të shtyhet nga Kryeinspektori, mbi kërkesën e inspektorit, vetëm për shkaqe të përligjura.¹⁹

Verifikimi i ankesës mund të përfundojë me:

- arkivimin e rastit, kur nga verifikimi i ankesës nuk vërehen ose nuk konfirmohen fakte ose rrethana domethënëse për inicimin e një procesi të caktuar ose kur ato janë të pamjaftueshme, ose të papërshtatshme, duke iu kthyer përgjigje subjektit ankues, ku të parashtrihen rezultatet e verifikimit, si dhe mungesa e shkaqeve dhe e arsyeve për verifikim të mëtejshëm të atij rasti ose ndërmarrjen nismave të tjera. Me këtë mënyrë, përfundimi vihet në dijeni dhe gjyqtari konkret.

Përgatitjen e relacioneve, për t'ia përcjell Ministrit të Drejtësisë nëpërmjet Zëvendëskryetarit, për fillimin e një procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari konkret, kur nga verifikimi vërehen fakte ose rrethana të atilla që mund të inicohet një proces disiplinor.

Mënyra e përfundimit të verifikimit urdhërohet nga Zëvendëskryetari pas relatimit të tij nga Kryeinspektori.²⁰

Inspektimi i gjyqtarit kryhet me vendim të KLD-së.

Inspektimi i gjyqtarit mund të ketë karakter njohës për efektivitetin e veprimtarisë ose bëhet për efektin e evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve disiplinore të tij.²¹

VI. PROPOZIMI I MASËS DISIPLINORE

¹⁹ Ibid. Neni 32

²⁰ Ibid. Neni 33

²¹ Ibid. Neni 36

Kryerja e procedurave disiplinore rregullohet nga ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe rregullorja “Për procedurat disiplinore të gjyqtarëve”. Kërkesa për procedim disiplinor i dërgohet KLD-së nga Ministri i Drejtësisë, duke u bazuar në raportet e dërguara nga inspektorët.

Ministri i Drejtësisë kryen inspektime sipas programeve të posaçme tematike ose territoriale, të hartuara kryesisht ose në zbatim të detyrave të caktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vijim të procesit të verifikimit të ankesave të shtetasve dhe të subjekteve juridike, si dhe sipas të dhënave, për të cilat vihet në dijeni kryesisht ose nëpërmjet Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe depoziton dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kërkesa për procedimin disiplinor, përveç dokumentacionit me të dhënat përkatëse, të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari, përmban edhe propozimin për llojin e masës disiplinore që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit të proceduar disiplinarisht.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur ngarkohet me detyra verifikuese, është i detyruar që brenda 15 ditëve të kryej procedurat e verifikimit dhe të depozitojë raportin përkatës.

Në çdo rast, në përfundim të procesit të verifikimit ose të inspektimit, Ministri i Drejtësisë ose Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet t’i kërkojnë gjyqtarit, që procedohet, që të paraqesë me shkrim pretendimet e tij, të cilat janë të detyruar t’i pasqyrojnë në dokumentacionin përfundimtar.²²

Propozimi i masës disiplinore duhet të mbështet, gjithashtu, në pretendimet

²² Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 31

dhe provat, të cilat gjyqtari kundër të cilit është marrë masa disiplinore ka paraqitur përpara inspektorit. Gjykata Kushtetuese ka gjykuar një rast që lidhet me rolin e Ministrit të Drejtësisë si inspektor dhe nismëtar i procesit të disiplinimit. Gjykimi kishte të bënte me çështjen, nëse roli i Ministrit të Drejtësisë është kushtetues ose jo. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendosi se roli i Ministrit të Drejtësisë është kushtetues.²³ Gjithsesi, ky debat për rolin e Ministrit të Drejtësisë si inspektor dhe nismëtar i procesit të disiplinimit vazhdon të mbetet i hapur. Çështja në këtë rast qëndron në përdorimin e pushtetit të Ministrit të Drejtësisë, për të mos filluar procedimin disiplinor edhe atëherë kur ka prova të qarta kundër një gjyqtari. Ministri i Drejtësisë nuk është i detyruar të arsyetojë vendimin e tij përpara KLD-së edhe pse ai duhet të njoftojë KLD-në për mosfillimin e procedimit disiplinor në bazë të ankesës së dërguar Ministrit të Drejtësisë nga KLD-ja për verifikim.

Mund të ekzistojnë disa zgjidhje për këtë problem. Për shembull, njëra zgjidhje mund të jetë që Ministri i Drejtësisë të informojë publikisht arsyet për mosfillimin e procedimit disiplinor ose të lejojë KLD-në të inspektojë çështjen dhe të vendosë për fillimin e procedimit. Një zgjidhje tjetër mund të jetë delegimi i kompetencave për fillimin e procedurave disiplinore një organi tjetër. Gjithashtu, për sa kohë që fillimi i procedimit disiplinor është në diskrecion të Ministrit atëherë mundet që edhe KLD-ja të ketë kompetencë në fillimin e një çështje disiplinore. Pra, me propozim të një anëtarit dhe me miratimin e një shumice të KLD-së, atëherë mundet që të fillojë procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari.

Sapo kërkesa dorëzohet te Ministri i Drejtësisë, ajo regjistrohet në Regjistrin e Procedimeve Disiplinore²⁴ që mbahet nga Kryeinspektori. Më pas caktohet mbledhja.

Gjyqtari, ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor, duhet të njoftohet për

²³ Gjykata Kushtetuese, vendimi nr.11, datë 27.5.2004

²⁴ Rregullorja "Për procedime disiplinore të gjyqtarëve", neni 3.

datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën 48 orë përpara fillimit të saj dhe duhet t'i vihen në dispozicion materialet e plota të procedimit jo më shpejt se dhjetë ditë nga data e mbledhjes.²⁵

VII. SHQYRTIMI I PROPOZIMIT

Procedimet disiplinore diskutohen në mbledhjet e KLD-së dhe aplikohen dispozitat e përgjithshme për numrin e votave dhe mënyrën e votimit.

Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 8 anëtarë.²⁶

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar në kuptimin e nenit 37 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nuk mund të abstenojnë.²⁷

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i merr vendimet me votim të hapur. Në rastet e votimit për çështje që lidhen me anëtarë të tij, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, mund të vendosë marrjen e vendimeve me votim të fshehtë.

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që janë në kushtet e pengesës ligjore, nuk marrin pjesë në diskutimin dhe në votimin e çështjes përkatëse të rendit të ditës.

Ministri i Drejtësisë nuk merr pjesë në votim në rastet e procedimeve disiplinore të nisura prej tij, ndërsa Presidenti i Republikës nuk merr pjesë në votim në rastet e propozimeve për emërim të gjyqtarëve. Drejtuesi i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë voton i fundit.²⁸ Këshilli i Lartë i Drejtësisë merr vendimet

²⁵ Ibid, neni 5 dhe 6.

²⁶ Ligji nr. 8811, datë 17/5/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 23.

²⁷ Ibid, neni 24.

²⁸ Ibid, neni 25.

me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje.²⁹

Zëvendëskryetari merr masat e nevojshme për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në procesverbal shënohen anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje, çështjet që janë shqyrtuar, diskutimet e pjesëmarrësve, vendimmarrja, forma dhe rezultati i votimeve. Pas shqyrtimit nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, procesverbali nënshkruhet nga Zëvendëskryetari. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka të drejtë të verifikojë përmbajtjen e procesverbalit dhe të paraqesë objeksionet e veta, të cilat i bëhen të ditura Këshillit të Lartë të Drejtësisë në mbledhjen pasardhëse. Vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, së bashku me procesverbalet përkatëse, depozitohen pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti se ai ka votuar kundër vendimit të marrë, si dhe arsyet e votimit kundër.³⁰

Gjatë takimit, në fillim Ministri i Drejtësisë paraqet çështjen përpara KLD-së dhe më pas, i jepet e drejta për t'u dëgjuar gjyqtarit ose avokatit të tij. Secili anëtar i KLD-së ka të drejtë t'i drejtojë pyetje gjyqtarit, por asnjëri prej tyre nuk luan rolin e prokurorit.

Përgjithësisht, gjyqtarët kanë qenë të pranishëm në mbledhje me praninë e një avokati, por asnjëri prej tyre nuk ka paraqitur dëshmitarë ose paraqitur prova përpara KLD-së. Takimet mbahen me dyer të mbyllura. Pas përfundimit të paraqitjes të materialit nga Ministrit i Drejtësisë, së mbrojtjes së gjyqtarit nga vetë ai ose avokati i tij, ose të dy bashkë, si dhe të pyetjeve të anëtarëve të KLD-së për gjyqtarin, KLD-ja vazhdon diskutimet e saj pa praninë e gjyqtarit. KLD-ja mund t'i kërkojë inspektorit kryerjen e verifikimeve të mëtejshme, për shembull, mbledhjen e më shumë të dhënave për vendimet e padrejta të dhëna nga gjyqtari.

Edhe pse ekziston një vakum ligjor, në përgjithësi nuk ekzistojnë ankesa

²⁹ Ibid, neni 26 (1).

³⁰ Ibid, neni 27

lidhur me transparencën e procesit. Çështja është nëse procesi përputhet me standarde ndërkombëtare. Për shembull, nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që përcakton standardet e evidencës përpara se KLD-ja të vendosë nëse gjyqtari është përgjegjës ose jo. Gjithashtu, nuk ekzistojnë as dispozita ligjore për paraqitjen e dëshmitarëve nga gjyqtari. Njoftimi paraprak për mbledhjen është i shkurtër, veçanërisht për gjyqtarët që banojnë dhe punojnë jashtë Tiranës. Edhe pse Rregullorja parashikon verifikim të mëtejshëm nga Inspektorati, ligji nuk parashikon mundësinë e një mbledhjeje të dytë për këtë rast.

Zakonisht takimet për procedimet disiplinore kryhen në takime të rregullta të KLD-së, ku mund të analizohen edhe çështje të tjera. Një organizim i veçantë i këtyre takimeve me një komision *ad hoc* mund të rrisë fokusin mbi këtë proces të rëndësishëm. Kjo do t'i jepte një atmosferë më formale këtij procesi.

VIII. TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJSHMËRIA

Transparenca dhe akseset e publikut ndaj informacionit janë elemente kyçe në një shoqëri demokratike dhe shërbejnë për t'i dhënë medias, shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera të interesuara mjetet e nevojshme për të analizuar sesi pushteti i shtetit përdoret dhe se si burimet administrohen.³¹

Neni 23 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë parashikon:

“1. E drejta e informimit është e garantuar.

2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”.

Neni 11(4) i rregullores “Për procedurat disiplinore” parashikon se vendimet e KLD-së duhet të arsyetohen në të gjitha rastet. Nuk ekziston ndonjë formulim i paracaktuar i vendimit, por në përgjithësi synohet që të

³¹ Shih “Analiza e Sistemit të Drejtësisë Penale të Shqipërisë”, Raport i OSBE-së 2006.

ndiqet një skemë që fillon me përshkrimin e procedurave të vetë gjykatës, një përmbledhje e procesit të verifikimit që ndiqet nga një përmbledhje e bazës ligjore dhe kushtetuese të vendimit dhe e konkluzionit të arritur nga KLD-ja dhe mbyllet me masën disiplinore të dhënë nga KLD-ja. Zakonisht vendimet e KLD-së përbëhen nga gjashtë faqe. Vlen për t'u evidentuar, gjithashtu, se KLD-ja ka vendosur që, përgjithësisht, mbledhjet e saj do të jenë të hapura për median. Katër mbledhjet e fundit, punimet e KLD-së, edhe ato me problematikë të mprehtë, kanë qenë të hapura për median.

IX. ANKIMI NDAJ MASËS DISIPLINORE

Ankimi ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit, si dhe për çdo masë tjetër me karakter disiplinor bëhet nga ky i fundit në Gjykatën e Lartë, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e këtij Këshilli. Kryetari ose gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët, në cilësinë e tyre si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kanë marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku u mor masa disiplinore ndaj ankuesit, nuk marrin pjesë në trupin gjykues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.³²

Përfaqësimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Gjykatën e Lartë, në rastet e ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, bëhet nga personi i autorizuar nga ky Këshill.

Autorizimi për përfaqësim nënshkruhet nga Zëvendëskryetari. Në tekstin e autorizimit tregohet qartë emri i përfaqësuesit dhe çështja konkrete të cilën ai është i autorizuar të përfaqësojë.³³

Në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë thirret detyrimisht gjyqtari

³² Ligji nr. 8811, datë 17/5/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", neni 34.

³³ Ligji nr. 8811, datë 17/5/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", neni 35.

ndaj të cilit do të shqyrtohet marrja e masave disiplinore, i cili ka të drejtë të mbrohet edhe me avokat. Njoftimi bëhet në një nga mënyrat që parashikon “Kodi i Procedurës Administrative”. Mosparaqitja, për shkaqe të paarsyeshme, nuk e pengon Këshillin e Lartë të Drejtësisë të shqyrtojë dhe të vendosë për masën.³⁴ Ka shume raste kur, gjyqtarët paraqesin raporte mjekësore dhe kështu që mbledhjet e KLD-se shtyhen pa fund, pasi mungon gjyqtari. Ka pasur raste kur Gjykata Kushtetuese ose dhe Gjykata e Lartë ka kthyer në KLD vendime të cilat kjo e fundit i ka marrë pa praninë e gjyqtarit. Për këtë arsye, KLD-ja kërkon të jetë në përputhje me ligjin dhe me të tilla vendime si më sipër. Por nga ana tjetër, zgjatja e procedimit disiplinor për muaj me radhë bën që të humbasë aktualiteti i procedimit dhe thelbi i procedimit disiplinor. Ndoshta është e nevojshme që të përcaktohet se deri kur mund të presë KLD-ja që gjyqtari të paraqitet në mbledhje ose, nëse jemi përpara raporteve të shpeshta mjekësore, të paraqitet në mbledhje avokati i gjyqtarit.

X. REKOMANDIME

Juridiksioni

Kritere ose standarde të reja duhet të përcaktohen për të zhdukur një ndikim të mundshëm ose subjektivizëm që Kryeinspektori mund të ketë në caktimin e çështjeve inspektorëve. Transparenca dhe përgjegjshmëria janë të rëndësishme në këtë proces vendimmarrjeje.

RREGJISTRIMI I ANKESAVE

Në kuadrin e të drejtës për informim duhet të përcaktohen rregulla të reja lidhur me aksesueshmërinë e Regjistrimit të Ankesës nga qytetarët. Në këtë kuadër, duhet të theksohet nevoja për ndërgjegjësimin e publikut.

³⁴ Ibid, neni 33

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJSHMËRIA

Bërja publike e vendimit të arsyetuar të KLD-së është e rëndësishme për gjyqtarët, për të njohur se cilat janë ato çështje dhe vendime që mund të konsistojnë në një shkelje të ligjit. KLD-ja duhet t'i bëjë vendimet saj të njohura në një shkallë më të gjerë. Zakonisht, procedura disiplinore bëhet e njohur për median, por përmbajtja e vendimit nuk publikohet në asnjë vend. Vendimet e KLD-së mund të shpërndahen nëpërmjet publikimeve të ndryshme, për shembull, duke e vënë të gjithë përmbajtjen e vendimit në website-in e KLD-së, duke shpërndarë kopje të vendimeve të gjithë gjyqtarëve ose duke publikuar raporte periodike lidhur me procedurat disiplinore.

Automatizimi i Inspektoratit të KLD-së dhe krijimi i faqeve të internetit, ku vendimet e KLD-së publikohen, përbën një hap të rëndësishëm për një sistem të drejtësisë më transparent në Shqipëri. Përveç kësaj, shumë mbetet për të bërë për t'i ofruar medias dhe publikut të përgjithshëm aksesin në procesin e vendimmarrjes së KLD-së që është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, duke u bazuar në respektin për të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës. Prandaj KLD-ja duhet të vendosë rregulla të brendshme, si dhe të krijojë struktura për t'iu përgjigjur në mënyrë të kujdesshme kërkesave për akses.

Material për tryezën e rrumbullakët “Ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit”

Illir Toska
Ish- Kryeinspektor

1. HISTORIK I SHKURTËR LIDHUR ME KRIJIMIN DHE VEPRIMTARITË E INSPEKTORATIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË.

Aktualisht, detyrat e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë të përcaktuara shprehimisht në nenin 16 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Tej këtij referimi ligjor dhe në plotësim të kuadrit normativ, mbështetur në nenin 14 pika 1 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka miratuar rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka evoluar në kohë, në praktikë, por edhe në kuadrin e normimit të veprimtarisë së tij.

Kështu, Inspektorati është organizuar dhe ka filluar të funksionojë në fillim të vitit 1998, mbështetur në ligjin nr.8265, datë 18.12.1997 “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas nenit 17 të këtij Ligji “Pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë krijohet Inspektorati. Këshilli i Lartë i Drejtësisë emëron inspektorët gjyqtarë dhe inspektorët prokurorë, të cilët ngarkohen të inspektojnë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, si dhe prokuroritë pranë tyre, verifikojnë ankesat e shtetasve dhe të institucioneve, organizimet e shërbimeve gjyqësore, të bëjnë

evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në kuptimin e nenit 45 të këtij ligji dhe ngarkesën në punë, si dhe në tërësi eficienten e gjykatave dhe të prokurorive”.

Në këtë periudhë, referencat e veprimtarisë së Inspektoratit gjendeshin vetëm në këtë ligj dhe nuk ka pasur një rregullore të veçantë më tej veprimtarinë e tij.

Ligji nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” ka filluar të funksionojë praktikisht në fillim të vitit 2003.

Në këtë kohë, mbështetur në nenin 14 pika 1 të ligjit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.138/1, datë 19.3.2003, ka miratuar rreguloren “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Me këtë Rregullore janë bërë përpjekje domethënëse për atë periudhë për normimin e veprimtarisë së Inspektoratit, duke synuar formalizimin e procedurave, ndërkohë që detyrat e Inspektoratit ishin të përcaktuara në nenin 16 të ligjit. Kjo Rregullore ka filluar të implemetohet menjëherë, por jo plotësisht, pasi përvoja e mëparshme ndikonte në moskuptimin e drejtë të saj. Në fillim të vitit 2004 janë bërë përpjekje serioze për zbatimin plotësisht të Rregullores dhe menjëherë janë identifikuar problematika të karakterit parimor dhe teknik.

Pas njoftimeve të herëpashershme dhe konstatimeve të bëra dhe nga vetë Këshilli, me nismën e Inspektoratit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.178, datë 15.7.2005, ka vendosur që Rregullorja e Inspektoratit të përmirësohet në disa drejtime konkrete.

Në konsideratë të problematikave të evidentuara në kohë, si dhe të përvojës së krijuar tashmë, është përgatitur projektregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” që, pas disa diskutimeve dhe përmirësimeve, është miratuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.195/2/a, datë 5.7.2006, duke u shfuqizuar Rregullorja e mëparshme.

Rregullorja e miratuar “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, lidhur me temën e kësaj tryeze, ka tentuar:

- të përcaktojë në mënyrë më të plotë dhe të qartë objektin e veprimtarisë së Inspektoratit dhe, në këtë mënyrë, rolin e tij si strukturë ndihmëse e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me synimin që të ndihmojë dhe lehtësojë zhvillimin nga Këshilli të të gjitha përgjegjësive ligjore të tij;

- të përcaktojë organizimin e Inspektoratit dhe mënyrat e funksionimit të tij, duke përcjellë idenë e funksionimit të Inspektoratit si entitet me person përgjegjës Kryeinspektorin, ndërkohë që specifikon rolin, detyrat dhe mënyrat e të vepruarit të gjithsecilit prej aktorëve përgjegjës;

- të përcaktojë për herë të parë idenë e organizmit të Inspektoratit me seksione sipas objektit dhe detyrave të veçanta që ai duhet të kryejë, organizimin i cili synon ndarjen e përgjegjësive, profilizimin e inspektorëve dhe bërjen më efektiv të tij;

- të ridetajojë detyrat e Inspektoratit të parapara në ligj dhe qëllimin që ato synojnë të përmbushin;

- të përcaktojë për herë të parë parimet e veprimtarisë së Inspektoratit, atyre të ligjshmërisë, të formalizimit të procedurave, të pjesëmarrjes në procedurë të gjyqarit, të prezumimit të pafajësisë, të trajtimit të njëjtë e të barabartë etj.;

- të përcaktojë për herë të parë nocionin e paraparë në ligj të verifikimit të ankesës, objektin e verifikimit, nismat që mund të rrjedhin dhe procedurën përkatëse që duhet ndjekur, me synimin të formalizojë atë procedurë dhe të shmang përdorim abuziv ose jokorrekt të këtij mjeti ligjor kontrolli;

- të përcaktojë për herë të parë nocionin e paraparë në ligj të inspektimit të gjyqarit, karakterin dhe llojet e tij, përmbajtjen, nismat që mund të rrjedhin dhe procedurën që duhet ndjekur, me synimin për të formalizuar dhe implemtuar në mënyrë parësore këtë mjet ligjor kontrolli;

- të përcaktojë për herë të parë nocionin e paraparë në ligj të inspektimit të gjykatave, karakterin dhe llojet e tij, përmbajtjen, nismat që mund të rrjedhin dhe procedurën që duhet ndjekur, me synimin për të formalizuar dhe implemtuar në mënyrë korrekte këtë mjet ligjor kontrolli;

- të përcaktojë në mënyrë më të plotë dhe të bëjë referenca adekuate lidhur me detyrën ligjore të verifikimit të pasurive të deklaruara nga gjyqtarët;
- të përcaktojë në mënyrë më të plotë procedurën që ndiqet lidhur me detyrën ligjore të verifikimit të pajtueshmërisë së veprimtarisë dhe sjelljes me funksionin e gjyqtarit;
- të përcaktojë në mënyrë më të plotë regjistrat, ku duhet të dokumentohen të dhënat bazë të veprimtarisë së Inspektoratit etj.

Nëpërmjet kësaj Rregulloreje është bërë një hap shumë i rëndësishëm lidhur me objektin e veprimtarisë së Inspektoratit, si dhe për qëllimin e detyrave që ai duhet të përmbushë.

Duhet përmendur se vite më parë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe, për më tepër, Inspektorati i tij, perceptoheshin thjesht dhe vetëm si organe të ndëshkimit disiplinor të gjyqtarëve. Ndërkohë që legjislacioni lidhur me përgjegjësitë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka evoluar, duke qenë ai përgjegjës për shumë aspekte thelbësore të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, mentaliteti, mënyra e kuptimit dhe e veprimit, sidomos të Inspektoratit, nuk kanë gjetur të njëjtin reflektim.

Verifikimi i ankesave ndaj gjyqtarëve ose kontrollet ndaj tyre konceptoheshin thjesht dhe vetëm me qëllim konstatimin e shkeljeve disiplinore dhe më tej për ndëshkimin disiplinor të gjyqtarëve. Situata bëhej edhe më e kontestueshme kur, përgjithësisht, fokusi i verifikimeve ose kontrolleve të Inspektoratit ishte vetëm vendimmarrja e gjyqtarëve dhe, për më tepër, zbatimi i ligjit material nga ana e tyre.

Me kalimin e kohës, përvoja dhe qëndrimet në vijimësi të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nevojat në rritje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të pasur sa më tepër informacion për gjyqtarët e të dy niveleve ose për situatat e këtyre gjykatave, ka bërë që konceptet dhe mënyra e veprimit të Inspektoratit dalëngadalë të ndryshojë. Duhet theksuar se një ndikim të rëndësishëm në këtë ndryshim kanë luajtur veprimtaria, analizat dhe opinionet e vetë Inspektoratit.

Vitet e fundit, fokusit të verifikimeve dhe kontrolleve të Inspektoratit,

përveç qëllimit për evidentimin e shkeljeve disiplinore dhe ndërmarrjen e nismave për ndëshkimin disiplinor të gjyqtarëve, i është shtuar në mënyrë krejt të natyrshme dhe qëllimi për evidentimin dhe grumbullimin e informacioneve thelbësore për veprimtarinë e gjyqtarëve dhe gjykatave, të dhëna mbi të cilat Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të ushtrojë më lehtë dhe në mënyrë më cilësore përgjegjësitë e veta ligjore, lidhur me emërimin, transferimin, edukimin dhe karrierën e gjyqtarëve.

Po kështu, verifikimet dhe kontrollet e Inspektoratit, duke u konsideruar dhe si mekanizma për zbulimin dhe identifikimin e të metave e dobësive në veprimtarinë e gjyqtarëve ose të gjykatave ose dhe për evidentimin e situatave të papërshtatshme në veprimtarinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave, të prodhuara ndonjëherë dhe nga vete legjislacioni në fuqi, kanë filluar të shërbejnë dalëngadalë edhe për bërjen e sugjerimeve dhe të rekomandimeve konkrete për gjyqtarët, gjykatat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse, me qëllim shmangien e praktikave të papërshtatshme të punë ose përmirësimin e legjislacionit.

Duhet pranuar se ende ekziston një problem i madh që duhet të gjej zgjidhje të shpejtë ligjore dhe, konkretisht, listimi sa më shumë të jetë i mundur i veprimeve të gjyqtarit që përbëjnë shkelje disiplinore. Dhe me tej, në përpjesëtim me natyrën dhe karakterin e shkeljes, si dhe pasojat e ardhura nga ajo, çdo shkeljeje disiplinore t' i referohet një mase disiplinore konkrete

Këtë çështje, të evidentuar edhe nga Inspektorati gjatë gjithë veprimtarisë se tij, e ka marrë në konsideratë edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, qoftë në një qëndrim të veçantë, të shprehur me vendimin nr.199/1, datë 15.9.2006, qoftë dhe në parashtrimin e opinioneve dhe të komentëve që Këshilli i ka bërë projektligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", që zyrtarisht i janë dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me verifikimin e ankesave të qytetarëve ose me procesin disiplinor në përgjithësi ndaj gjyqtarëve, ka vend të përmendet se gjatë vitit 2006, pas disa qëndrimeve të njëpasnjëshme të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, lidhur me problematikën e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve, si dhe pas diskutimeve dhe trajtimit në parim të problemit të procedimeve

disiplinore të gjyqtarëve, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.199/1, datë 15.9.2006, mbështetur edhe në Raportin e përgatitur nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, ka vendosur që, duke u bazuar te përfundimet e përshkuara në Raport, si dhe te mendimet e dhëna nga anëtarët e Këshillit, t'i dërgohen Ministrin të Drejtësisë propozimet për ndryshime ligjore lidhur me procedimet disiplinore të gjyqtarëve.

Në këtë rast, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka vërejtur se, nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë, në disa vendime që lidhen me shqyrtimin e kushtetutshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të KLD-së për dhënie masash me karakter disiplinor ose për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën për çështje të karakterit disiplinor të gjyqtarëve, në mënyrë të përsëritur është arritur në këto përfundime:

- Vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore është atribut vetëm i gjykatave me të larta.

- Vendimet gjyqësore të formës së prerë mund të jenë shkak për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit vetëm nëse shoqërohen me akte e sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit.

- Shkarkimi i gjyqtarit mund të bëhet vetëm për rastet që parashikohen në mënyrë të shprehur në Kushtetutë, neni 147 pika 6.

- Shkarkimi i gjyqtarit "Për akte e sjellje diskredituese" të konsiderohet se mund të behet vetëm në konsiderate të interpretimit të bërë nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.75, datë 19.4.2002.

- Në çdo rast të shkarkimit të gjyqtarit nga detyra janë të domosdoshëm konstatimi dhe parashtrimi i sjelljeve të padenja të kryera gjatë kryerjes së detyrës ose jashtë saj dhe që të kenë ndikuar në humbjen e besimit publik në dhënien e drejtësisë dhe t'i kenë sjellë dëm shtetit dhe shoqërisë.

Gjithashtu, në këtë rast, ndër të tjera, në konsideratë të çështjeve që kanë rezultuar dhe të vlerësimeve lidhur me plotshmërinë dhe mirëpërcaktimet e bëra në nenet 41, 42, 44 ose 46 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", lidhur me rastet që konsiderohen si shkelje discipline, masat disiplinore dhe mundësinë e

rishqyrtimit të procedimit disiplinor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur t' i drejtohet Ministrit të Drejtësisë, duke vlerësuar që në kuadrin e reformës ligjore, lidhur me përmirësimin e ligjit, duhen pasur në vëmendje edhe:

- ndryshimi dhe plotësimi i nenit 41 të ligjit, përmirësim që duhet të bëhet me synimin për adoptimin e një sistemi disiplinor të plotë, të efektshme dhe të ligjshëm, duke parashikuar në mënyrë sa me të detajuar të mundur dhe të qartë rastet që pasjellin përgjegjësi disiplinore për gjyqtarin, mënyrë kjo që shërben edhe si mekanizëm parandalues, pasi ndërgjegjëson dhe kontribuon në rritjen e përgjegjshmërisë së gjyqtarëve, ashtu sikundër shërben dhe për bërjen efektiv të vetë këtij sistemi, sepse eliminon interpretime të ndryshme lidhur me rastet.

(Në këtë rast, ka vend të përmendet evidentimi dhe komenti që Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka bërë formulimit të pikës 6 të nenit 41 të ligjit, duke u shprehur se “formulimi i pikës 6 konsiderohet si dispozitë e bardhë që ka lidhje me etikën e gjyqtarit dhe deri me sot nuk ka një akt zyrtar për rregullat e sjelljes së gjyqtarit, kur dhe Kodi i Etikës Gjyqësore, i miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, është një dokument autokontrolli, ku nuk ekziston ndonjë rregull, sipas të cilit mosrespektimi i Kodit passjellë përgjegjësi disiplinore për gjyqtarin”. Po kështu, ka vend të përmendet evidentimi dhe komenti që Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka bërë formulimit të pikës 7 të nenit 41 të ligjit, duke u shprehur se “formulimi i pikës 7 në vetvete përmban dy raste, ku në rastin e parë flitet në përgjithësi për veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, pa u saktësuar lloji, natyra ose karakteri i këtyre veprimeve, ndërkohë që në rastin e dytë bëhet fjalë për moskryerje të veprimeve të detyrueshme procedurale, konstatimi dhe zgjidhja e pjesës më të madhe të të cilave, përderisa kemi të bëjmë me çështje të zbatimit të ligjit, mund të bëhet vetëm nga një gjykatë më e lartë mbi ankimet gjyqësore të palëve në proces, ashtu sikundër është kreu pa vend që çdo mosrespektim i dispozitave procedurale të passjellë procedimin disiplinor dhe ndëshkimin e gjyqtarit”).

Për verifikimin e ankesave ose përgjithësisht për procesin e kontrollit të gjyqtarëve, siç u tha, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë i janë paraqitur zyrtarisht

Kuvendit të Republikës së Shqipërisë disa komente lidhur me projektligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Lidhur me opinionet që Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka dhënë për këtë projekt dhe që në mënyrë thelbësore lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e Inspektoratit për sa i përket edhe detyrës së verifikimit të ankesave, mund të përmenden:

➤ Në projektligj janë bërë përpjekje për një rregullim të procesit disiplinor ndaj gjyqtarëve, ndonëse vlerësohet se këto rregullime nuk përmbushin zbrazëtitë ligjore ose kontestet për këtë proces. Vlerësohet se ky duhet të ishte një nga aspektet parësore ku duhej të ndërhyhej, për ta bërë procesin të plotë, të hapur, profesional, efektiv, transparent dhe, më e rëndësishmja, jo monopol të një institucioni, ashtu sikundër duhet të ishin shmangur dualitetet në veprimtarinë e përditshme të strukturave përkatëse. Në këtë kuadër, ky projektligj nuk ka sjell diçka të re lidhur me listimin sa më të plotë të atyre shkeljeve që passjellin përgjegjësi disiplinore për gjyqtarin ose parashikimi i një game sa më të gjerë të llojeve të masave disiplinore që njëkohësisht do të garantonin pavarësinë e tyre në realizimin e procedurave dhe dhënien e vendimeve gjyqësore.

2. PROBLEMATIKA LIDHUR ME VERIFIKIMIN NGA INSPEKTORATI I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË TË ANKESAVE TË QYTETARËVE.

Çdo vit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë mbërrijnë një numër i konsiderueshëm ankesash drejtpërdrejt nga qytetarët ose subjektet e tjera, po ashtu dhe nëpërmjet institucioneve, si Kabineti i Presidentit të Republikës, njëherazi dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nga administrata e Kuvendit, nga Kabineti i Kryeministrit, nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, nga Zyra e Avokatit të Popullit etj. Gjithashtu, në disa raste, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi bazën e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.156, datë 23.6.2004, kryesisht ose me porosi të Zëvendëskryetarit, ka trajtuar dhe verifikuar informacionet ose shqetësimet e bëra publike në median e shkruar ose atë vizive.

Ankesat që mbërrijnë në adrese të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit kanë pasur të bëjnë si me veprimtarinë e tyre gjyqësore në çështje konkrete, në gjykim e sipër ose të përfunduara në një shkallë gjykimi, po ashtu dhe me veprimtarinë e tyre jashtëgjyqësore ose etikën e gjyqtarëve.

Po kështu, çdo vit ka pasur një numër jo të vogël ankesash që janë adresuar ndaj veprimtarisë së nëpunësve shtetërorë që nuk ushtronin funksionet e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë ose të gjykatave të apelit, si për shembull ndaj veprimtarisë së prokurorëve, përmbauesve, avokatëve ose gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, veprimtaria e të cilëve del tej kuadrin të kontrollit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Jo rrallë, e njëjta ankesë mbërrin në Këshillin e Lartë të Drejtësisë jo vetëm drejtpërdrejt nga ata ankues, por edhe nëpërmjet institucioneve të tjera shtetërore, të cilave ata iu drejtohen, duke bërë që në këtë drejtim numri tërësor i ankesave të rritet në mënyrë fiktive ose të mos pasqyrojë saktësisht realitetin.

Në çdo rast, verifikimi i ankesave është bërë brenda kuadrin ligjor ekzistues, duke pasur në konsideratë dhe vështirësitë që ekzistojnë në realizimin në terren të detyrave.

Nga viti në vit ka pasur një përmirësim të kohës së realizimit të verifikimit të ankesave, si dhe një rritje cilësore të të dhënave të marra nga ato. Është për t'u përmendur se ka një ndryshim të mënyrës së të punuarit lidhur me grumbullimin e të dhënave të vlefshme për qëllimin e verifikimit të ankesave. Nëse vite më parë, ka pasur kontakte të kufizuara me ankuesit, vitet e fundit është tentuar që të kihen sa më tepër kontakte me ta, kjo me qëllim identifikimin dhe grumbullimin e të dhënave sa me të plota dhe të vlefshme. Gjithashtu, ky lloj komunikimi ka shërbyer njëherazi edhe për sqarimin e tyre për çështje ose problematika të kompetencës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Mund të thuhet, gjithashtu, se në proceset e verifikimit të ankesave, shumë më shpesh se më parë, është kërkuar vendosja e një komunikimi me gjyqtarët që iu adresohet ankesa, ku nga verifikimi i pretendimeve të mundshme të tyre ose ballafaqimi me ata i të dhënave të grumbulluara, rezultatet kanë

qenë me korrekte dhe më cilësore.

Mund të thuhet se për çdo vit ka një numër të lartë komunikimesh të drejtpërdrejta me qytetarët që janë paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe që kishin ankesa konkrete ndaj gjyqtarëve të ndryshëm. Në çdo rast ata janë sqaruar lidhur me rolin e Këshillit, si dhe me objektin e veprimtarisë së tij në raport me përgjegjësinë për kontrollin e gjyqtarëve. Po kështu, në çdo rast që është kërkuar lidhur me verifikime konkrete ankesash, qytetarëve iu është dhënë informacioni që disponohej për çastin. Është bërë kujdes që informacioni i dhënë, në mënyrë verbale ose të shkruar, të mos përdorej për qëllime që dalin tej objektit dhe qëllimit të verifikimit të ankesave nga ana e Inspektoratit. Për ilustrimin e këtij çasti mund të sjellim një shembull që na ndodh vazhdimisht. Kështu, qytetari ngre pretendime për disa çështje të karakterit procedural, ndërkohë që për to ai ka paraqitur dhe një ankim gjyqësor në gjykatat me të larta. Në këtë rast, pavarësisht gjetjeve dhe rezultateve të verifikimit, në asnjë rast informacioni ose sqarimi verbal i ankuesit nuk ka pasur të bëjë me gjykimet tona në raport me atë çka ka rezultuar, pasi të vepruarit në mënyrë të ndryshme do të vinte në vështirësi gjykatën që do të shqyrtonte çështjen, ndërkohë që do të kapërcenim atributet që ligji na ka dhënë ose do të shkelnim ndalimet e shprehura të tij.

Është për t'u theksuar se në vazhdimësi evidentohet dukuria e mungesës së njohurive të mjaftueshme nga ana e ankuesve lidhur me përgjegjësitë dhe funksionet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe, sidomos, me objektin dhe kufijtë e kontrollit të gjyqtarëve nga ana e tij. Po kështu, në praktikë janë ndeshur raste të pakënaqësive të shprehura nga ana e ankuesve, të cilët gabimisht, duke e konsideruar Këshillin e Lartë të Drejtësisë si autoritetin më të lartë gjyqësor, kanë shpresuar në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore prej atij ose për ndikimin nga ai mbi gjyqtarët e çështjeve konkrete gjyqësore.

Gjithashtu, vazhdimisht, për shkak të mosnjohjes së ligjit, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë mbërrijnë ankesa që iu adresohen gjyqtarëve konkretë për veprimtari gjyqësore të realizuar nga ata në një periudhë kohore mbi 3-vjeçare. Shpesh, duke mos u identifikuar saktësisht periudha kohore e asaj

vendimmarrjeje, si pjesë e veprimtarisë gjyqësore të realizuar, nga ana jonë anë kryer të gjitha veprimet procedurale dhe janë marrë masa për studimin në vend të dosjes gjyqësore, që në fund kanë rezultuar të pafrytshme, për shkak se, edhe në rast se do të vëreheshin shkelje që do të përbënin shkelje disipline në kuptim të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 41, po në respektim të tij dhe pikërisht në të nenit 44, paragrafi i dytë, ka qenë e pamundur inicimi i një procedimi disiplinor, sepse shkelja konsiderohet e parashkruar. Po kështu, edhe nëse rezultatet e verifikimit do të ishin të vlefshme për iniciimin e nismave të tjera, për shkak të humbjes së aktualitetit, ato do ta bënin të pamundur iniciimin e tyre.

Në shumë nga ankesat e mbërritura në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nga qytetarët është pretenduar për ekzistencën e fakteve ose të rrethanave konkrete, por që në procesin e verifikimit ka qenë e vështirë të provohet vërtetësia e tyre, për shkak të mungesës ose pamjaftueshmërisë së burimeve provuese të tyre.

Këto vitet e fundit, ka pasur disa raste kur nga ana e gjyqtarëve, që iu ishte adresuar një ankesë për veprimtarinë e tyre gjyqësore, është paraqitur kallëzim penal kundër ankuesve. Vlen të theksohet se ligji nuk ka ndonjë parashikim të shkruar lidhur me konfidencialitetin e ankesave që paraqiten para Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përkundrazi ekziston detyrimi për vënien në dijeni të gjyqtarëve përkatës lidhur me to. Ka vend që ligji të përmirësohet dhe lidhur me përgjegjësinë që mund të ekzistojnë ndaj ankuesve për mënyrën e formulimit dhe të të shprehurit në adresë të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarëve konkrete ose dhe për mundësitë dhe mjetet ligjore të reagimit të gjyqtarëve ndaj një sjelljeje të tillë. Mund të thuhet se për këtë moment, tashmë në konsideratë dhe të përcaktimit të përfshire në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 30 pika 3, për rastet kur ankesat përmbanin përdorim të shprehjeve të papërshtatshme dhe joetike, gjatë procesit të verifikimit të tyre është shmangur njohja e gjyqtarëve me tekstin e plotë të ankesave, duke u njohur ata në çdo rast me pretendimet konkrete që ngriheshin në to.

Shpesh ka ankesa që lidhen me veprimtari gjyqësore të gjyqtarit për çështje gjyqësore në gjykim e sipër. Për këto raste ka pasur kontestime ose qëndrime të ndryshme lidhur me çastin e vënies në dijeni të gjyqtarëve për verifikimet që do të kryheshin mbi bazën e atyre ankesave. Kështu, nga disa gjyqtarë është kërkuar me insistim njohja paraprake me ankesën, ndërsa nga disa të tjerë është shprehur mendimi se kryerja e këtij veprimi ishte e parakohshme dhe premisë për cenimin e pavarësisë së tyre në zgjidhjen e çështjes konkrete. Problemi që vazhdonte ngrihet në këtë rast është vërtetë delikat dhe serioz në rrethanat kur në perceptimin e gjyqtarëve, ankesa të tilla konsiderohen si mjet presioni të palëve ndërgjyqëse ose të personave që tërheqin interesa të tjerë nga ai gjykim. Vlerësohet se ky është një problem i ligjit, që në praktikë është tentuar zgjidhja e tij, duke kryer paraprakisht verifikime formale pa tërhequr përfundime deri në përfundim të gjykimit të çështjes konkrete, përjashtuar rastet kur ankesa është vërejtur ose nga verifikimi formal është vërejtur tejzgjatje e procesit gjyqësor. Në këto raste të fundit, me porosi të Zëvendëskryetarit, gjyqtarëve përkatës iu është tërhequr verbalisht vëmendja për pasjen në konsideratë nga ata të detyrimit kushtetues dhe ligjor për përfundimin e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme.

Lidhur me shpërndarjen nga Kryeinspektori të ankesave për verifikim nga ana e inspektorëve vazhdimisht është mbajtur në konsideratë që ankesa të mos mbërrijë automatikisht te një inspektor i përzgjedhur që më parë, çka është realizuar në mënyrë të atillë që puna e inspektorëve të mos jetë e ndarë me zona ose gjykata të veçanta. Kjo mënyrë të vepruari është vlerësuar për çastin me e përshtatshme, me qëllim shmangien, parandalimin ose minimizimin e familjarizimit të inspektorëve me gjyqtarë të një rrethit gjyqësor ose zone të caktuar, shmangien e konflikteve ose të paragjyqimeve që natyrshëm mund të kenë lindur mes atyre gjatë punës disavjeçare, dhënien mundësi inspektorëve për njohjen me profilin dhe aftësitë profesionale të sa më tepër gjyqtarëve, si dhe me qëllim prezantimin e Inspektoratit si një strukturë që vepron në ekip, çka është e rëndësishme në mesazhet që puna e tyre përcjell.

Sipas rregullores së re “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 2 pika 4, është përcaktuar se Inspektorati mund të organizohet me seksione dhe konkretisht, seksioni i inspektimit, që kryen inspektimin e gjykatave ose të gjyqtarëve të urdhëruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, seksioni i ankesave, që kryen verifikimin e ankesave të paraqitura në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nga shtetas ose subjekte të tjera, si dhe ato të publikuara në media dhe seksioni i vlerësimit profesional dhe etik, që përmbush detyrimet e rrjedhura nga ligji dhe rregullorja e “Sistemit të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve”. Praktikisht, kjo mënyrë organizimi nuk është vene në zbatim për shkak se rregullorja është miratuar në mes të vitit 2006, si dhe, ajo që është me kryesorja, për shkak të numrit të kufizuar të inspektorëve.

Siç u tha, verifikimi i ankesave nga viti në vit është tentuar të realizohet brenda afateve të arsyeshme, duke nënkuptuar që verifikimi në vend është bërë në një kohe optimale, duke pasur në konsideratë dhe faktin që organika e inspektorëve vazhdimisht ka qenë e mangët dhe aktualisht e pamjaftueshme për shkak të kërkesës dhe rritjes së veprimtarive që Inspektorati duhet të realizojë në përmbushje të detyrave të rrjedhura nga ligji dhe vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Mund të thuhet se, nga viti në vit, ka pasur një rritje të numrit të përgjigjeve për ankuesit lidhur me mënyrat e përfundimit të trajtimeve ose verifikimeve, ku mund të evidentohet kthimi për ata i përgjigjes brenda një kohe të shkurtër nga çasti i përfundimit të trajtimit ose verifikimit të ankesës.

Për sa i përket kohës së përfundimit tërësor të verifikimit, mund të thuhet se vitin e fundit është praktikuar që në përfundim të verifikimeve të kryera për ankesa që lidheshin me procese gjyqësore të ankimuar gjyqësisht në gjykatat me të larta, ankuesve iu është kthyer një përgjigje paraprake, duke iu kërkuar atyre bashkëpunim që, në varësi të mënyrës së përfundimit të shqyrtimit të asaj çështje dhe përfundimeve që mund të tërhiqen nga gjykata me e larte, nëse do të vlerësonin që në atë veprimtari gjyqësore të gjyqtarëve konkret ishin lejuar shkelje të ligjit që të përbënin shkelje disipline në kuptim

të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 41, të na vinin në dijeni lidhur me to. Kjo praktikë e re pune ka bërë që periudha e përfundimit të verifikimi të jetë më e shkurtër se vitet e mëparshme, gjatë të cilave verifikimi përfundohej vetëm pasi gjykatat më të larta ishin shprehur mbi ankimet gjyqësore të palëve.

Vitet e fundit, formalizimi i procedurave të ndjekura dhe të kryera nga Inspektorati për verifikimin e ankesave është zbatuar gjerësisht, kjo dhe në respektim të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Në një numër të konsiderueshëm rastesh, ankesat e mbërritura në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kanë pasur të bëjnë me pretendime që ato palë ndërgjyqëse, ose dhe jo të tilla, kanë pasur ndaj mënyrës së zgjidhjes së çështjes në themel nga gjykatat e shkallëve të ndryshme të gjyqësorit. Në të tilla raste, kur ankesat kane pasur të bëjnë thjesht dhe vetëm me këto pretendime, si dhe kur nga sa parashtrohej në to rezultonte qartë se pavarësisht nga mënyra e përfundimit të atij verifikimi, fillimi i procedimit disiplinor do të ishte i pamundur për shkak të kalimit të afatit 3-vjeçar brenda të cilit mund të fillohej procedimi disiplinor, referuar në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 44 paragrafi i dytë, në zbatim të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ato ankesa janë trajtuar menjëherë nga Kryeinspektori ose inspektorët e ngarkuar prej tij, duke iu kthyer menjëherë përgjigje ankuesve, duke i sqaruar për mungesën e lendes për verifikim.

Duke marrë në konsideratë faktin se ankesa të tilla rrisin në mënyrë artificiale punën e Inspektoratit, por që njëkohësisht, për shkak të mungesës së duhur të kulturës juridike dhe të njohurive të mjaftueshme, veprimtaria e tij, por dhe e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk kuptohet drejt dhe në disa raste keqinterpretohet, është evidentuar nevoja që Këshilli të marrë masa të frytshme për prezantimin sa më parë dhe në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të objektit të veprimtarisë së tij për publikun e gjerë, kjo jo vetëm

për të ndërprerë atë fluks ankesash të padobishme për veprimtarinë e tij, por dhe për të thithur atë fluks ankesash që do të kishin interes për përmbushjen e misionit të tij.

Mund të thuhet se nga viti në vit numri i ankesave në adresë të gjyqtarëve është rritur, duke u evidentuar fakti se në raport me vitin 2003, në vitin 2006 numri i ankesave gati është dyfishuar. Ky fakt, në prizmin tonë, flet për rritjen e njohjes dhe të besimit nga publiku tek institucioni i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ashtu sikundër nuk do të thotë domosdoshmërisht për humbjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Nga viti në vit numri i verifikimeve të ankesave që janë mbartur për vitin pasardhës ka qenë duke u ulur, çka do të thotë për rritjen e shpejtësisë së verifikimit.

Vlen të evidentohet se, nga viti në vit, ka pasur një numër më të madh të materialeve të grumbulluara nga verifikimi i ankesave të qytetarëve që i janë përcjell Ministrit të Drejtësisë, materiale këto që lidhen me vlerësime për mospërmbushje të rregullt të detyrës nga ana e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë ose dhe të gjykatave të apelit.

Po kështu, vitet e fundit, mbi bazën e verifikimeve të ankesave, ka pasur një numër rastesh kur gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit iu është tërhequr verbalisht vëmendja (vetëm në vitin 2006 - për 6 gjyqtarë, 4 gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë dhe 2 gjyqtarë të gjykatave të apelit). Gjithashtu, mbi bazën e verifikimeve të ankesave, vitin e fundit, janë evidentuar së paku 32 raste, gjyqësore ose jashtëgjyqësore, për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të 36 gjyqtarëve, nga të cilët 29 gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë dhe 7 gjyqtarë të gjykatave të apelit.

Vlen të theksohet se, vitin e fundit, në përputhje me rregulloren e re “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, nëpërmjet Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi përfundimet e tërhequra nga verifikimi i ankesave, gjykatave dhe autoriteteve të tjera shtetërore iu janë përcjellë disa tërheqje vëmendjeje, rekomandime e sugjerime dhe konkretisht:

Drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Vlorës dhe Ministrin të Drejtësisë “Në lidhje me mbajtjen e regjistrave për kërkesat për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit”.

Drejtuar Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, gjykatave të apelit, Gjykatës së Lartë dhe Ministrin të Drejtësisë: “Mbi praktikën gjyqësore që lidhet me lëvizjen e dosjeve në rastet e ankimit ndaj vendimit të sigurimit të padisë”.

Drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore të Elbasanit dhe Përmetit: “Mbi disa shqetësime lidhur me dhënien e këshillave juridike, hartimin ose redaktimin e padive ose të kërkesave të tjera gjyqësore”.

Drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit: “Tërhiqet vëmendja lidhur me detyrimin për rishqyrtimin e vendimit të caktimit të masave mjekësore”.

Drejtuar gjykatave të apelit: “Në lidhje me praktiken e punës për shqyrtimin jashtë radhe të çështjeve gjyqësore”.

Drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës: “Në lidhje me hartimin e vendimeve për regjistrimin e personave juridik”.

Drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë: “Në lidhje me dorëzimin e vendimeve në sekretarinë gjyqësore”.

Po kështu, në kuadër të automatizimit të procesit të trajtimit të ankesave, në fund të vitit 2006, është kontraktuar një shoqëri për krijimin dhe instalimin e një sistemi të automatizuar të menaxhimit të ankesave. Aktualisht ky sistem është duke u vënë në përdorim, mënyrë kjo që jo vetëm do të ndikojë në një menaxhim me të mirë të këtij aspekti të veprimtarisë së Inspektoratit, por do të ndikojë dhe në rritjen e transparencës.

Përgjegjësia e gjyqësorit dhe e gjyqtarëve në Spanjë

Yannick DURAND

Përktheu: Diana Istrefi

HYRJE

Shembulli i Spanjës në një studim krahasues mbi përgjegjësinë e gjyqësorit dhe gjyqtarëve të saj është mjaft interesant, dhe kjo për disa arsye. Fillimisht aty ka një sistem juridik, i cili pak a shumë mund të cilësohet i ri, pra një sistem që ka ditur e ka mundur të bëjë sintezën e shembujve të afërt (ndikimet e mëdha në sistemin juridik spanjoll vijnë nga Italia, Gjermania, gjithashtu edhe nga Franca). Në këtë hyrje do të studiojmë sistemin që u vendos në vitin 1978 (A), pastaj do vazhdojmë me pak histori mbi përgjegjësinë e gjyqësorit në Spanjë (B), për të përfunduar hyrjen e këtij studimi me një ekspozë mbi bazat teorike të kësaj përgjegjësie (C).

A / Sistemi juridik i krijuar më 1978

Kushtetuta spanjolle e vitit 1978 shënoi fundin e diktaturës së gjeneralit Francisko Franko dhe pikënisjen reale dhe simbolike të demokracisë në Spanjë. Periudha e tranzicionit që nisi në vitin 1975 (me vdekjen e Frankos) dhe vazhdoi deri më 1978, e cila me të drejtë u quajti Tranzicion, nuk do të shqyrtohet në këtë studim. Thjesht mund të përmendim që gjatë kësaj periudhe u zbatua, në pjesën më të madhe, drejtësia që vinte nga regjimi frankist (sigurisht që në këtë zbatim u fshinë ato efekte që ishin tepër totalitare). Pra do të shohim se cila është tradita në administratën spanjolle (1), dhe pastaj do të tregojmë se çfarë solli kushtetuta e vitit 1978 (2).

1. TRADITA E ADMINISTRATËS SPANJOLLE

Administrata spanjolle, e cila erdhi me Shtetin spanjoll, pra me krijimin e tij, është luhatur mes shkatërrimesh dhe reformimesh të fuqishme. Në shekullin e XVII monarkia donte të kopjonte sistemin administrativ francez. Dëshira për centralizim, që ishte preokupimi i parë i të gjitha regjimeve deri në vitin 1978 (përfshijto Republikën e Dytë nga viti 1931 deri më 1939), është përballur gjithnjë me administratën lokale. Ajo që të bie në sy kur studiojmë administratën spanjolle, dhe kjo dallohet në epokë të ndryshme, është mungesa e hierarkisë dhe e koordinimit midis administratës qendrore, e dalë nga shteti spanjoll, dhe asaj vendore, shprehje e veçorive kulturore dhe juridike të provincave të ndryshme. Mund të shënojmë këtu se administrata spanjolle është ndërtuar në pak kohë, pasi mungesa e stabilitetit në regjime të ndryshme ka shkaktuar ndryshime të përhershme në organizimin administrativ. Në vitet e regjimit frankist (1939-1975) u vendos ajo që mund ta quajmë administrata qendrore moderne. Edhe pse Kushtetuta e vitit 1978 vendosi një sistem krejt të ri, u ruajtën shumë mekanizma të organizimeve administrative të cilat nisnin që nga periudha e Frankos.

E drejta administrative spanjolle, në kundërshtim me ekuivalentin e vet francez, nuk është ndërtuar mbi jurisprudencën, por mbi ligjet e dala pas Kushtetutës së vitit 1978. Para kësaj date zbatoheshin rregulla të së drejtës private, me ndryshimet apo përshtatjet e veçanta të kësaj fushe.

Për të përfunduar mbi këtë traditë të administratës spanjolle, duhet të vërejmë se administrata ishte gjithmonë e frikësuar, me arsye ose jo, kjo sipas epokave, si një instrument diktatorial, domethënë si krahu i armatosur i tiranisë. Në fakt pikënisja e sistemit të ri është Kushtetuta e vitit 1978.

2. “ERA E RE” E VITIT 1978

Shumë kohë para vdekjes së Frankos, juristët (veçanërisht universitarët) kanë reflektuar mbi atë se çfarë do të ishte tranzicioni demokratik dhe cilat do të ishin shtyllat juridike të regjimit të ri. Për sa i përket administratës dhe

të drejtës së saj, e gjitha, ose pothuajse e gjitha, duhej ndërtuar. Megjithatë duhej të respektohej diçka nga trashëgimia historiko-juridike spanjolle. Vdekja e Frankos në vitin 1975 është një datë kyç, ose më mirë të themi një pikë takimi. Regjimi që ai pati krijuar u shemb, ndërsa ai që ishte caktuar si pasuesi i tij hyri në rrugën e demokracisë. Mbreti Huan Karlos vendos atë që u quajt Tranzicion, periudha tranzitore ndërmjet diktaturës dhe demokracisë. Ishte ende e drejta “frankiste” që vazhdonte të zbatohet, por administratës dhe juridiksioneve iu kërkua që ajo të interpretohej me një lexim sa më demokratik dhe liberal që të ishte e mundur. Paradoksale është që karta themelore, pra Kushtetuta, do të votohej në një kontekst frankist (të gjitha shtresat e administratës dhe asamblëtë “parlamentare” ishin gjithnjë në duart e frankistëve, edhe pse më vonë, për sa i përket përfaqësuesve të Asamblesë Kushtetuese, kjo nuk do të jetë e vërtetë).

Procesi i hartimit të Kushtetutës së re është në përgjithësi mjaft klasik, me aprovimin, më 31 tetor 1978 të projektkushtetutës nga Dhomat (“Las Cortes Generales”), pastaj referendumi më 6 dhjetor 1978. Në datën 27 dhjetor 1978 Mbreti dekreton Kushtetutën¹, e cila hyn në fuqi më 29 dhjetor të po këtij viti. Nga teksti i kësaj kushtetute, i cili i referohet demokracisë dhe decentralizimit, rrjedhin të gjitha rregullat juridike spanjolle. Edhe pse, ashtu siç e kemi përmendur, ekzistojnë edhe ligje të epokës frankiste, që nga ky moment do të jetë vetëm kjo Kushtetutë burimi i normave juridike. Në sistemin spanjoll, imazhi klasik i piramidës së normave është real: nga maja (pra Kushtetuta) zbresin parimet drejtuese, të cilat shërbejnë si bazë juridike për krijimin e normave. Vetë Kushtetuta shpeshherë parashikon linjat drejtuese dhe ligjet që duhet të dalin për rregullimin dhe administrimin e kësaj apo asaj fushe që përmendet konstitucionalisht. Kjo Kushtetutë është moderne dhe progresiste.

¹ *Constitución Española*, Centro de Estudios Procesales, 1996, f. 211.

Një e re e saj është pikërisht krijimi i Mbrojtësit të Popullit (“Defensor del Pueblo”). Ky institucion, i cili përmendet krahas institucioneve të tjera të mëdha të regjimit (Dhomat parlamentare, Qeveria dhe Mbreti), është një novacion, edhe pse i duhet dhënë një ngjyrim juridik. Është neni 54 i Kushtetutës ai që e ka futur Mbrojtësin e Popullit në regjim dhe përcakton orientimet e mëdha mbi funksionin e tij. Ndërsa ligji organik i datës 6 prill 1981² përcakton shtrirjen e veprimit të Mbrojtësit të Popullit (neni 54 parashikonte votimin e këtij ligji organik). Misioni i tij kryesor është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore. Për ta kryer sa më mirë këtë mision, ligji organik i vitit 1981 i jep atij të drejtën e kontrollit dhe të vëzhgimit mbi gjithë administratën publike, veprimet e saj dhe nëpunësit e saj. Ai është i pavarur nga tre pushtetet (ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor) dhe nuk ka mandat detyrues nga Dhomat parlamentare, të cilat e zgjedhin atë çdo pesë vjet. Këtij institucioni mund t’i drejtohen qytetarët (individë, shoqata etj.) ose, me disa kushte dhe përjashtime të rëndësishme, edhe administrata të caktuara. Kërkesa apo ankesa te Mbrojtësi i Popullit është jashtëzakonisht e thjeshtë, gjë që u lehtëson aksesin një numri të madh qytetarësh. Fusha e tij e ndërhyrjes është tepër e hapur.

Megjithatë ka një përjashtim që është i veçantë, dhe që ne na intereson, në radhë të parë, për studimin tonë: ai ka të bëjë me kërkesat dhe ankesat lidhur me përgjegjësinë e gjyqësorit dhe keqfunksionimin e tij. Në këtë rast, kur një kërkesë e tillë i është adresuar Mbrojtësit të Popullit, ai është i detyruar t’ia transmetojë atë “Fiscalia General”-it (që është ekuivalente e Prokurorisë së Përgjithshme), ose Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor (“Consejo General del Poder Judicial”). Në këtë fushë ndërhyrja e Avokatit të Popullit lejon zgjidhjen e problemeve, por, megjithatë, pa kaluar nëpërmjet rrugës juridikionale dhe duke ofruar kështu mbrojtje suplementare të të drejtave themelore. Për të përfunduar me Mbrojtësin e Popullit, ai gjatë

² Ligji organik 3/81, datë 6 prill 1981: “Del Defensor del Pueblo”.

mandatit të vet disponon imunitet të një natyre të veçantë, të ndryshme nga ai i anëtarëve të pushtetit gjyqësor.

Pasi dhamë një pamje të shpejtë të regjimit dhe sistemit juridik spanjoll, tani do të merremi më hollësisht me përgjegjësinë e drejtësisë.

B / Historiku i përgjegjësisë së gjyqësorit

Për të kuptuar më mirë atë çka është sot përgjegjësia e gjyqësorit në Spanjë, duhet të kthehemi në kohë, për të parë se kjo përgjegjësi është e njohur si një proces klasik i së drejtës spanjolle (2), kjo pasi të kemi ekspozuar fillimisht përgjegjësinë së cilës i nënshtrohet administrata në tërësinë e saj (1).

1. PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATËS

Që të kapet më mirë kuptimi i përgjegjësisë së administratës, duhen studiuar raportet midis administratës dhe qytetarëve. Ashtu siç e kemi përmendur tashmë, ekziston një mosbesim i madh i qytetarëve ndaj administratës së tyre, dhe kjo për arsye historike që janë të thjeshta për t'u kuptuar. Administrata i nënshtrohet drejtësisë në të njëjtat juridiksione si qytetarët. Pra në të drejtën administrative spanjolle ekziston dëshira që të lehtësohen kërkesat ndaj administratës, madje të fshihen privilegjet ose avantazhet që disponon pushteti publik.

Me ligjin e datës 26 nëntor 1992³ u rregulluan përgjegjësitë e administratës. Kështu u vendos një mënyrë shumë e thjeshtë, sipas së cilës në çdo administratë mund të gjenden formularë tip, të cilat qytetarët mund t'i kërkojnë për t'i plotësuar atëherë kur kanë arsye për t'u ankuar ndaj administratës në fjalë ose ndonjë punonjësi të saj. Mbrojtësi i Popullit, për të cilin folëm më lart, mund të ndërhyjë në rastet e shkeljes së të drejtave themelore vetëm pas një kërkesë të thjeshtë të bërë nga qytetari. Procedurat

³ Ligji 30/92, datë 26 nëntor 1992: "Del Regimen Juridico de las Administraciones publicas y del Procedimiento Administrativo".

para rrugës juridiksionale janë pra të shumta dhe të ndryshme.

Në rastet kur kërkohet që përgjegjësia e administratës të dalë përpara gjykatës vihet në zbatim e drejta administrative⁴. Kjo e drejtë dallohet për ligjin e vet bazë - që nuk është vepër e jurisprudencës - , gjë që përbën një ndryshim të madh me homologun e vet francez, i cili në vitet 1980 shënoi një prodhimi tepër të madhe normash ligjore dhe rregulluese në të drejtën administrative. Megjithatë, një numër parimesh të mëdha të kësaj të drejte administrative të re, kanë si origjinë të drejtën administrative franceze, e cila e ka frymëzuar gjerësisht homologen e saj iberike. Edhe vetë nëpunësit i nënshtrohen gjithashtu përgjegjësisë, e cila mund të jetë civile, penale dhe disiplinore.

Por ajo që mund të na interesojë në mënyrë të veçantë këtu është përgjegjësia e gjyqësorit dhe nëpunësve të saj, dhe kjo në rastet e funksionimit jo të rregullt, fajeve, gabimeve gjyqësore dhe mbajtjes gabimisht në burgim të përkohshëm.

2.PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATËS GJYQËSORE: RRËNJËT E HERSHME TË SAJ

Nëse është Kushtetuta e vitit 1978 që vuri në vend përgjegjësinë e shtetit për sa i përket drejtësisë, nëpërmjet nenit 121, sipas të cilit “dëmet e shkaktuara nga një gabim gjyqësor, ashtu si edhe ato që janë pasojë e një funksionimi jo normal të administratës gjyqësore, japin të drejtën për dëmshpërblim në ngarkim të shtetit, dhe kjo bëhet konform ligjit”, i zëvendësuar nga ligji i famshëm i vitit 1985⁵, duhet ditur se përgjegjësia e drejtësisë dhe e gjyqtarëve

⁴ Ligji 30/92, datë 26 nëntor 1992: “Del Regimen Juridico de las Administraciones Publicas y del Procedimiento Administrativo”.

⁵ E drejta administrative është në qendër të mbrojtjes së qytetarit ndaj padrejtësive që mund t’i bëhen nga administrata. Ligji bazë i këtij sistemi në Spanjë, por i ndryshuar më pas, është ai i datës 27 dhjetor 1956: “Reguladora de la jurisdicción contencioso-administrativo”.

të saj është një traditë e vjetër në historinë juridike spanjolle. Kushtetuta e vitit 1978 regjistrohет pra si një vazhduese dhe trashëguese e historisë, edhe pse neni 122 i saj flet vetëm për statusin e gjyqtarit, pa përmendur përgjegjësinë tij.

Ideja e përgjegjësisë së gjyqësorit dhe gjyqtarëve ka udhëtuar së bashku me shekujt. Pikënisja e vërtetë është shekulli XV, atëherë kur u ndërtua shteti kastilian dhe ku u ndie nevoja për një drejtësi të përgjegjshme për të shmangur shkeljet⁶ (këtu është për t'u shënuar fakti se, në kohën e Inkuizicionit, magjistratët, me gjithë pushtetin e madh që u ishte dhënë, i nënshtroheshin një përgjegjësie juridike). E gjithë periudha e monarkisë, deri në pushtimin napoleonian, u dallua për dëshirën e futjes në kornizë të veprimit të gjyqtarit, për ta bërë shërbëtor të së drejtës mbretërore, përgjegjës para Mbretit, por gjithashtu edhe para të gjykuarve. Ardhja në fron e Burbonëve francezë, në shekullin e XVII, e cila do të ndryshonte një numër traditash juridike (siç janë vendosja e centralizimit dhe e një administrate të organizuar, pëpjekjet për unifikimin e së drejtës në provinca të ndryshme, sidomos në Aragonë), nuk e ndryshoi procesin e përgjegjësisë së magjistratëve ndaj atyre që gjykohen⁷. Kjo pra bëri që te këta të fundit të ngulitej ideja se magjistratët, gjatë kryerjes së funksionit, mund të jenë përgjegjës për aktet e tyre, ashtu si edhe administrata gjyqësore. Shekulli i XIX, i cili politikisht ishte tepër kaotik, e përforcoi idenë e një drejtësie e cila të inkuadronte fillimisht autonominë, pastaj pavarësinë e gjyqtarëve. Përpjekja për strukturim juridik, që vinte nga përvoja napoleoniane, vetëm sa do e mbështeste këtë ide. Periudha frankiste nuk iu kthye idesë së përgjegjësisë së gjyqësorit dhe mjetet për zbatimin e saj u komplikuan aq shumë, duke penguar kështu angazhimin e vërtetë të kësaj përgjegjësie.

Dëshira për të përgjegjësuar administratën gjyqësore pati jehonë në gjithë

⁶ López Muños Rianzares, Independencia y responsabilidad del juez, *Revisa General Informatica de Derecho*, 1997, p. 1-2.

⁷ López Muños Rianzares, *vep. e cituar*.

administratën, në kuptimin klasik dhe të përgjithshëm të fjalës. Mosbesimi i të gjykuarve ndaj paanshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit u bashkua me mungesën e besimit të qytetarëve ndaj një arbitrariteti gjithmonë të mundshëm të administratës. Opinioni publik, dhe ky është një tipar karakteristik i shoqërisë spanjolle, mendon se drejtësia nuk është as e paanshme dhe as e mirë dhe atë duhet ta vëzhgosh e ta kontrollosh papushim. Ngulmon gjithmonë frika e famshme ndaj arbitraritetit, i cili mund të shprehet edhe në një vendim gjyqësor, ndoshta edhe në punën e vetë gjyqtarit. Kjo përgjegjësi pra mund të analizohet në një platformë shtesë, që mund të vijë pas stadi më të lartë të hierarkisë juridiksionale, si një mjet plus në piramidën tradicionale të rekursit, duke u bërë kështu përpjekja e fundit që peshorja e drejtësisë të anojë nga ai që ka të drejtë.

Meqenëse është interesante të zbërthehen mekanizmat e përgjegjësisë, paraprakisht po bëjmë një ekspozë të bazës teorike të kësaj përgjegjësie në Spanjë.

C / Bazat teorike të përgjegjësisë së gjyqësorit spanjoll

Ashtu siç e pamë, përgjegjësia e gjyqtarit dhe e shtetit, për sa i përket drejtësisë në Spanjë, i ka fillimet e veta para shumë shekujsh. Pikënisja teorike është e thjeshtë dhe e ndërlikuar njëkohësisht. Pagabueshmëria e gjyqtarëve dhe gjyqësorit është e pamundur. Gjithmonë ka një rrezik, një probabilitet, sigurisht të ndryshueshëm, të gabimit dhe funksionimit jo normal të drejtësisë. Po si mund ta gjesh, dhe pastaj ta gjykosësh përgjegjësinë e atyre, roli dhe funksioni i të cilëve, me të drejtë, është të bëjnë drejtësi? Drejtësia, e cila ndodhet në themelet e ekzistencës së shtetit, duke qenë dhe një nga misionet e tij të para, a është në Spanjë një administratë klasike, një shërbim publik si të tjerët, ku mund të zbatohet ai regjim përgjegjësie si i administratës në përgjithësi? Me Kushtetutën e vitit 1978, kjo përgjegjësi është zhvilluar rreth dy boshteve, përgjegjësisë së administratës gjyqësore dhe asaj të magjistratëve (në regjimin e Frankos gjyqtari ishte i mbrojtur nga përgjegjësia e kufizuar e shtetit). Duke filluar nga viti 1978 si gjyqtarët, ashtu

edhe administrata gjyqësore, u ndodhën përballë gabimit të tyre, pasi përgjegjësia e tyre fillon që nga momenti kur ata zgjidhin një konflikt⁸.

Aspekti teorik themelor i kësaj gjendet në legjitimitetin e gjyqësorit dhe gjyqtarëve, në misionin⁹ e tyre, në rolin e tyre juridik, por edhe politik¹⁰. Kështu, ky debat shkon përtej përgjegjësisë së gjyqësorit dhe gjyqtarëve. Çështjet që na interesojnë këtu janë vetëm ato lidhur me përcaktimin dhe cilësimin e gabimeve të gjyqësorit, tërthorazi edhe të shtetit, si dhe gabimet e gjyqtarit në sistemin spanjoll. Përgjegjësia e gjyqtarëve spanjollë për gabimet e tyre personale mund të diferencohen nga gabimet e gjyqësorit, të cilat janë pasojë e keqfunksionimit të administratës, të një gabimi gjyqësor ose të një dënimi me burgim të përkohshëm. Pra i gjykuari, sipas rastit, mund të fillojë të kërkojë njërën ose tjetrën përgjegjësi.

Për ta kryer sa më mirë këtë studim mbi përgjegjësinë e gjyqësorit dhe gjyqtarëve në Spanjë, do të na duhet të bëjmë në pjesën e parë një paraqitje të sistemit juridiksional spanjoll, dhe në mënyrë të veçantë organizimit institucional të tij (I), dhe në pjesën e dytë të shpjegojmë që përgjegjësia e gjyqësorit ka si kurorë pavarësinë e tij (II), dhe para se të përfundojmë do të mësojmë nëse gjyqtarët spanjollë janë nëpunës të njëjtë me ata të administratës publike iberike (III).

I. DREJTËSIA SPANJOLLE:

INSTITUCIONE DHE ORGANIZIM TË VEÇANTË

Kushtetutës dhe legjislacionit që rrjedh prej saj i është dashur të pajtojë institucionet e vjetra me vullnetin dhe dëshirën për demokratizim dhe me

⁸ Eduardo Jauralde Morgado, La responsabilidad del juez, *Poder Judicial*, nr.3, 1982, f. 15-16.

⁹ Angel Torio Lopez, Tipicidad, referencia a la teoria de los tipos abiertos, *Cuadernos de Derecho Judicial*, XVII, f. 7-33.

¹⁰ Claudio Movilla Alvarez, La responsabilidad del Estado Juez, *Cuadernos de Derecho Judicial*, XIX, 1992, f. 437-479.

modernizmin e vitit 1978. Kështu, organizimi i institucioneve të reja pasqyron atë çfarë kanë dashur pjesët përbërëse të Kushtetutës së 1978-ës (A). Edhe drejtësisë spanjolle i është dashur të futet në këtë organizim, të gjejë vendin e vet dhe të respektohet ndaj pjesës tjetër të administratës publike (B).

A / Një organizim që pasqyron vizionin e Kushtetutës së vitit 1978

Ashtu siç e thamë, asaj i është dashur të pajtojë, të shkrijë në një kallëp, trashëgiminë historike me risitë, të cilat janë derdhur pastaj në sistemin që mund të duket kompleks dhe i përzier (1), dhe që përbën atë pjesë të bukur të “traditës” tipike spanjolle e cila është mundësia gjithmonë e një rekursi ose apeli (2).

1.NJË “PËLHURË MERIMANGE” KOMPLEKSE

Për ta thjeshtuar ekspozenë mbi institucionet, po zgjedhim formën klasike piramidale, duke u nisur nga baza deri në majë. Në pjesën e poshtme të piramidës ndodhet gjyqtari i pajtimit në bashkitë e vogla. Pastaj vjen gjykata e shkallës së parë dhe hetuesia, që kanë kompetenca për të gjitha fushat (sociale, civile, administrative, madje edhe penale) brenda territorit të rrethit. Në nivel krahine (që mund të krahasohet me departamentin francez) ndodhen gjykatat penale, administrative, ato sociale, të zbatimit të dënimeve dhe ato të fëmijëve (Juzgados de lo penal, de lo contencioso-administrativo, de lo social, de vigilancia penitenciaria y menores), të cilat janë grupuar në një juridiksion të vetëm. Ashtu siç e tregon vetë emri, kompetencat e saj janë të mëdha dhe korrigjojnë ato të gjykatave të shkallës së parë. Në majë të këtyre juridiksioneve lokale ndodhet Gjykata Krahinore (Audencia Provincial), të cilat kanë po ato fusha kompetencash si gjykatat e shkallës së parë. Gjithmonë duke u ngjitur në këtë piramidë, e cila siç shihet është tepër komplekse, arrijmë në juridiksionin e lartë në miniaturë, Gjykatën e Lartë të komuniteteve autonome. Për sa i përket drejtësisë autonome, është juridiksioni suprem që e ka kompetenca, vendimet e të cilit nuk kanë mundësi apelimi (e

drejta autonome e zbatuar nga të gjitha juridiksionet që kemi cituar më parë). Kjo gjykatë është e ndarë në tre dhoma, që janë: dhoma civile dhe penale, dhoma e grindjeve administrative dhe dhoma sociale. Gjithsej ka 17 Gjykata të Larta të komuniteteve autonome, nga një për çdo komunitet.

Tani do ta shohim këtë organizim në nivel kombëtar. Gjykata kombëtare (Audiencia National) është shkalla e parë e stadi kombëtar, e cila, edhe kjo është e ndarë në tre dhoma (dhoma civile dhe penale, dhoma e çështjeve administrative, dhoma sociale), ku përqendrohen të gjitha çështjet që ngjiten deri tek ajo nga i gjithë territori. Në majë të piramidës ndodhet Gjykata Supreme (Tribunal Supremo), e cila, ashtu si gjykata kombëtare, gjendet në Madrid. Ajo është instanca e fundit për zgjidhjen e grindjeve. Kjo gjykatë është e përbërë nga pesë dhoma (dhoma civile, dhoma e krimeve, dhoma e çështjeve administrative, dhoma sociale, dhoma ushtarake), të cilat mbulojnë tërësinë e çështjeve të mundshme. Duhet shënuar se dhoma e pestë, ajo ushtarake, nuk futet në të njëjtën piramidë të juridiksioneve.

Juridiksionet ushtarake organizohen në një mënyrë të veçantë. Nën dhomën ushtarake të Gjykatës Supreme Ushtarake ndodhet gjykata ushtarake qendrore, pastaj gjykatat ushtarake (në krahasim me pjesën tjetër të organizimit juridiksional, juridiksioni ushtarak është shumë i thjeshtuar).

Pas kësaj panorame të shpejtë të organizimit institucional të juridiksioneve spanjolle, është me interes të përmendim edhe dy pika: e para është që Gjykata Supreme mund të mos jetë shkalla e fundit e një procedure, pasi mund të bëhet edhe rekurs në Gjykatën Kushtetuese (kjo gjë është një nga karakteristikat e kontrollit të kushtetutshmërisë në Spanjë). Pika e dytë ka të bëjë me mbijetesën e juridiksioneve tradicionale, të cilat fillojnë që me epokën e Ripushtimit (shek. XV), dhe vazhdojnë të jenë në hierarki. Më e famshmja është gjykata e ujit në Valencia, e cila mblidhet në sheshin e katedrales dhe ka në ngarkim grindjet që lidhen me ujitjen.

Kjo shumicë juridiksionesh hyn në vizionin e apelit, gjithnjë të mundshëm, të një rekursi i cili pengon goditjen e “satërit” përfundimtar të drejtësisë.

2.NJË VAZHDIMËSI APELESH

Kjo piramidë me kate, siç është drejtësia spanjolle, i lejon njerëzin të shohin sesi çështjet e tyre gjykohen disa herë (në rastet kur ata apelojnë) nga juridiksione dhe gjyqtarë të ndryshëm. Kjo vazhdë apelesh, pra edhe gjykimesh, mund të shkaktojë probleme lidhur me afatet e gjykimit (megjithëse drejtësia spanjolle nuk dallohet për afate të tepruara), si edhe lidhur me stabilitetin e së drejtës, pasi është tepër e vështirë lindja i një jurisprudence të fortë. Mbi këtë argument mund të themi se e drejta spanjolle nuk është ndërtuar mbi jurisprudence, por mbi normat e shkruara dhe se fakti që jurisprudence do kohë të zbatohet para shumë juridiksioneve nuk ndryshon asgjë në shtetin e së drejtës dhe në stabilitetin juridik.

Kjo vazhdë apelesh shkon deri atje sa të riakuzojë hierarkinë e juridiksioneve, pasi një rekurs për pakushtetutshmëri mund të bëhet pas vendimit të marrë nga Gjykata Supreme, dhe në këtë rast, ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese mund edhe ta anultojë vendimin e Gjykatës Supreme. Gjithashtu ky numër i madh apelimesh ka si qëllim të sigurojë transparencën e drejtësisë, si edhe mbrojtjen e të drejtave themelore, pavarësisht nga të drejtat subjektive të çdo të gjykuari.

Tërësia e institucioneve përbërëse të drejtësisë shtrihet pra si një piramidë në kuptimin e lartësisë, gjë që në mënyrë simbolike tregon rëndësinë dhe fuqinë e pushtetit gjyqësor në Spanjë. Tani duhet të shohim lidhjen midis administratës dhe pushtetit gjyqësor, domethënë vendin që zë drejtësia brenda administratës.

B / Vendi i drejtësisë në administratën spanjolle

Për të vazhduar me përgjegjësinë e gjyqësorit dhe gjyqtarëve të saj, duhet të tregojmë në fillim se administrata gjyqësore, ashtu si edhe nëpunësit e saj, paraqesin disa veçori të ndryshme nga institucionet e tjera që përbëjnë pushtetin publik spanjoll. Pushteti gjyqësor është pra një administratë e pavarur (1), me një ekzistencë të veçantë në krahasim me pushtetin qendror (2).

1.NJË ADMINISTRATË E PAVARUR, SHPREHJE E PUSHTETIT GJYQËSOR

Organizimi piramidial i juridiksioneve flet qartë për parimin e ndarjes së pushteteve, duke treguar se pushteti gjyqësor është realisht i pavarur. Në kreun VI të Kushtetutës, të titulluar “Del Poder Judicial” (Për Pushtetin Gjyqësor), nga neni 117 deri në nenin 127, flitet në linja të trasha për organizimin e këtij pushteti si dhe mbrojtjen e tij nga pushtetet e tjera, duke treguar qartë vullnetin e mirë për t’i siguruar asaj pavarësinë dhe ruajtjen e kësaj pavarësie. Ligji bazë i datës 1 korrik 1985 vendos në detaje organizimin e sistemit.

Kreu i pushtetit gjyqësor, “qeveria e saj” është Këshilli i Përgjithshëm i Pushtetit Gjyqësor. Ai administron funksionimin e drejtësisë, veçanërisht nga pikëpamja materiale. Misioni i tij i parë është të zhvillojë dhe të mbrojë pavarësinë e të gjitha juridiksioneve dhe të garantojë funksionimin e mirë të tyre, duke nënkuptuar këtu edhe përgjegjësinë dhe problemet e saj në rast të keqfunksionimit të drejtësisë. Ai ka gjithashtu në ngarkim edhe karrierën e magjistratëve. Ministria e Drejtësisë, që është organ i pushtetit ekzekutiv, nuk ka lidhje hierarkike me tërësinë e administratës së gjyqësorit (përfshirë këtu edhe Prokurorinë, ose “La Fiscalia General”, e cila është krejtësisht e pavarur); ajo i përgjigjet kërkesave të Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor vetëm për sa i përket anës financiare.

Vendi i gjyqësorit në shtet mund të përmblihet si vijon: ai është një shërbim publik që shteti është i detyruar t’ua bëjë qytetarëve të vet. Ekzistenca e shtetit spanjoll, i cili është më i kritikuar dhe më pak solid se shteti francez, mbështetet mbi këtë detyrë që ka drejtësia, që të mund të tregojë kështu sesa i dobishëm dhe sa i nevojshëm është ai. Fakti që kjo ekzistencë e shtetit në Spanjë nuk kuptohet vetvetiu, e kthen në një leitmotiv kryesor dëshirën për të dhënë drejtësi në mënyrën sa më të paanshme e të pavarur që të jetë e mundur.

Pra administrata gjyqësore nuk është si gjithë të tjerat, si për sa i përket organizimit të saj, ashtu edhe lidhjeve të saj hierarkike, domethënë lidhjeve

midis shkallëve të ndryshme që e përbëjnë atë. Kërkesa e përhershme për pavarësi e bën konceptimin e administratës gjyqësore qenësisht të ndryshëm nga ai i administratës klasike, ose me më tepër dëshirë për të mbajtur lidhje mes komponentëve të ndryshëm të saj.

Integrimi i drejtësisë në shoqërinë spanjolle nuk është gjithmonë i përkryer, me gjithë përpjekjet që bëhen në këtë drejtim e që ne i kemi përshkruar. Shërbimi publik në drejtësi, me gjithë veçantitë e veta, vuan nga e njëjta mungesë besimi që qytetarët kanë për shtetin.

Tani le të kuptojmë lidhjet midis pushtetit qendror dhe administratës së tij gjyqësore.

2.ADMINISTRIM I SHKËPUTUR NGA PUSHTETI QENDROR

Një nga bazat juridike të regjimit të vendosur nga Kushtetuta e re në vitin 1978 ishte parimi i autonomisë. Ashtu siç ekziston një ndarje, një diferencim i madh, midis pushtetit qendror dhe atij lokal, po kështu ka një ndarje midis shtetit dhe drejtësisë, me qëllim ruajtjen e pavarësisë së kësaj të fundit. Kjo pavarësi e bën drejtësinë një administratë brenda Administratës, me të vetmen lidhje, atë financiare. Në qoftë se, ashtu siç do ta shohim, është e njëjta e drejtë që zbatohet për të dyja administratat, ndryshimet në zbatimin e saj te gjyqtarët dhe gjyqësori, në krahasim me të drejtën administrative “të përbashkët” janë të rëndësishme. Më poshtë ne do të duam të mësojmë nëse janë gjyqtarët nëpunës si të tjerët, me të njëjtat të drejta dhe detyra dhe të njëjtën përgjegjësi si nëpunësit e administratës klasike. Por që tani mund të themi se nga fakti i misionit të tyre dhe parimeve të mëdha juridike që kanë udhëhequr hartimin e Kushtetutës, ata nuk mund të kenë të njëjtin status dhe të njëjtin regjim me nëpunësit e tjerë të shtetit.

Në këtë “shkëputje” nga shteti, ne ndiejmë shumë rolin mbështetës dhe lëvizës të Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor. Vetëm ai, dhe jo juridiksionet, ka lidhje drejtpërdrejt me pjesën tjetër të administratës. Kjo e zgjeron pavarësinë e gjyqësorit. Ndërhyrja e paktë, por të mos thënë aspak,

e ministrisë në jetën reale të gjyqësorit bën që shteti pothuajse të mungojë në procesin juridiksional, edhe pse, siç do e shohim, pas përgjegjesisë së gjyqësorit fshihet mirë e bukur ajo e shtetit, i cili ndreq keqfunksionimet e administratës gjyqësore.

Kjo pavarësi, kjo “shkëputje”, është ende e theksuar nga forma e vetë shtetit, që është tepër i decentralizuar. Në fakt, nuk duhet të harrojmë se shkallët e para të juridiksionit, dhe kjo deri te Gjykatat e Larta të komuniteteve autonome, zbatojnë një të drejtë të veçantë, atë të autonomive. Pra e drejta është e copëzuar midis sistemeve të ndryshme juridike. Për këtë diversitet mund të flitet edhe për sa i përket një gjyqësori të pavarur nga pushteti qendror; mungesa e uniformitetit e bën pothuajse të pamundur një kontroll global, aq sa edhe vetë Këshilli i Përgjithshëm i Pushtetit Gjyqësor has ndonjëherë në vështirësi, në rastet e konfliktit me pushtetin qendror, për të bindur një juridiksion lokal që zbaton të drejtën e autonomive.

Pra bëmë një vështrim të shpejtë mbi drejtësinë spanjolle, mbi mënyrën e përbërjes dhe pjesëmarrjes së saj në gjirin e shtetit. Edhe pse efektivisht kryefjala është pavarësia, ajo nuk është e shkëputur nga parimi tjetër bazë i drejtësisë së paanshme, që është përgjegjësia.

II. PËRGJEGJËSI E LIDHUR ME PAVARËSINË E GJYQËSORIT

Për t’u futur drejt e në temë duhet të kuptojmë dhe të paraqesim përgjegjësinë e gjyqësorit nga një pikëpamja teorike (A). Pasi të kemi parë tërësinë e përgjegjesisë, do na duhet të shikojmë së bashku zbatimin e saj në dy fushat e mëdha klasike të keqfunksionimit të drejtësisë, që janë gabimi gjyqësor (B) dhe dhënia e dënimit të përkohshëm në mënyrë të padrejtë (C). Pas studimit të parimeve të përgjegjesisë së administratës gjyqësore, do të shikojmë edhe mekanizmat e zbatimit të saj (D).

A / Përgjegjësia e administratës së gjyqësorit

Një nga tiparet bazë të drejtësisë është përgjegjësia, e cila i jep asaj një

pjesë të legjitimitetit të vet në një shtet demokratik dhe liberal. Në Spanjë ky legjitimitet mbështetet në dy shtylla: e para ka të bëjë me marrëdhëniet me shtetin, ku vlen pavarësia dhe papërgjegjësia (1), ndërsa e dyta ka të bëjë me marrëdhëniet e saj me qytetarët që gjykojnë, ku më shumë vlen përgjegjësia (2).

1. PAVARËSIA DHE PAPËRGJEGJËSIA NDAJ SHTETIT

Pyetja që mund të bëjmë këtu është të dimë nëse ka nevojë funksionimi i gjyqësorit për një lloj papërgjegjësie gjatë kryerjes së misionit dhe për ruajtjen e pavarësisë së vet? Që të jetë sa më efikas funksionimi i gjyqësorit nevojitet që administrata e tij të mbajë distancë nga pushteti, pra nga shteti. Ndarja nga njëra pjesë e administratës shtetërore, e lejon gjyqësorin të ekzistojë, ashtu siç është, përkrah pjesës tjetër të administratës. Pavarësia e lejon gjyqësorin të kufizohet nga veprimi i shtetit, pra të mos i bashkohet atij. Meqë administrata nuk parapëlqehet në mentalitetin spanjoll, gjyqësorit i duhet të tregojë gjithmonë e më shumë pavarësi dhe papërgjegjësi ndaj shtetit¹¹. Papërgjegjësia e gjyqësorit ndaj shtetit do të thotë që për veprimet e shtetit si gjykatës (Estado Juez) të mos i jepet llogari shtetit në funksionet e tjera të tij¹². Kjo shpjegohet me faktin se administrata gjyqësore nuk ka nevojë për ndihmë nga shteti, dhe, në fakt, ashtu siç e kemi parë, hierarkia e saj është krejtësisht e shkëputur nga shteti, duke qenë Këshilli i Përgjithshëm i Pushtetit Gjyqësor i ngarkuar me tërësinë e problemeve që kanë lidhje me gjyqësorin dhe veprimet të tij. Kërkimi i përgjegjësisë të shtetit dhe pavarësia ndaj tij, bën që gjyqësori të përforcojë legjitimitetin e vet, i cili po të shihet nga pikëpamja historike në Spanjë, është paksa i pështjelluar.

Ne do të shohim se, që gjyqësori të mund të këtë legjitimitet, edhe pse ai

¹¹ German Fernandez-Farreres, La responsabilidad patrimonial del Estado Juez, *Poder Judicial*, 1984, f. 61-70.

¹² Alvarez Claudio Movilla, *vep. e cit.*

është e shkëpur nga shteti, i duhet të veprojë me më shumë përgjegjësi ndaj qytetarëve.

2.LEGJITIMITET DHE PËRGJEGJËSI NDAJ QYTETARËVE

Ashtu si gjithë administrata spanjolle, gjyqësori është përgjegjës për veprimet e veta para qytetarëve, para kombit, me një fjalë para mbajtësve të vërtetë të pushtetit. Shteti i së drejtës dhe demokracia, që janë bazat ideologjike të Kushtetutës së vitit 1978 për sa i përket gjyqësorit, tregohen nëpërmjet përgjegjshmërisë dhe vendimeve të tij dëmtuese. Sigurisht që atëherë kur ka keqfunksionim të drejtësisë ose gabime të njerëzve të saj ndërhyjnë kjo përgjegjshmëri.

Në Spanjë, gjyqtari, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, nuk është parë si mbrojtës natyror i ligjit, i së drejtës dhe i të drejtave. Përkundrazi. Kështu, fakti që vihet nën përgjegjësi, pra në ruajtje të çdo të gjykuari, është tregues mbrojtjeje dhe përkrahjeje. Me gjithë pavarësinë dhe papërgjegjësinë, gjyqtari është anëtar i shtetit, një nga krahët e tij, pasi drejtësia është njëri prej misionëve primare të shtetit¹³. Mbikqyrja që opinioni publik ushtron ndaj gjyqësorit është pra shpëtimtari i legjitimitetit të tij. Pushteti i gjyqtarit në Spanjë është i rëndësishëm, gjë që është klasike për demokracitë liberale¹⁴, por pesha e tij në shoqëri dhe në opinionin publik është shumë më e vogël se në Francë, për shembull. Ashtu siç e kemi thënë, e drejta spanjolle moderne nuk është ngritur mbi jurisprudencën, përkundrazi. Juristi spanjoll ka një tendencë natyrale për të mos i besuar jurisprudencës dhe ndihmesës së gjyqtarit.

Përgjegjësia e gjyqësorit vërteton kujdesin që tregohet në Spanjë për vënien e shtetit dhe degëzimeve të tij para përgjegjësisë për veprat që kryen. Edhe pse administrata gjyqësore është e pavarur, përgjegjësia e saj nis përgjatë

¹³ Ligji organik 6/1985, datë 1 korrik 1985: "Për pushtetin gjyqësor".

¹⁴ Alvarez Claudio Movilla, *vep. e cit.*

hierarkisë së juridiksioneve për të përfunduar te vetë shteti. Shteti spanjoll është kështu përgjegjës për drejtësinë e tij. Kjo mund të duket si një pohim dogmatik, por duhet konstatuar implikimi i shtetit në përgjegjësinë e gjyqësorit¹⁵. Kur i gjykuari vë drejtësinë përpara akteve të saj të dëmshme – madje para gabimeve ose të paktën gabimeve të detyrës – kjo e bën atë të ndërjegjësohet se përgjegjësia e gjyqësorit është një garanci për pavarësinë e drejtësisë, gjë që i jep administratës gjyqësore një farë legjitimiteti. Përgjegjësia dhe pavarësia janë pra shtyllat e legjitimitetit të drejtësisë, dhe në mendimin spanjoll ato nuk shkojnë dot pa njëra-tjetrën.

E gjitha kjo mbetet teorike, pra ç’bëhet me faktet që lidhen me përgjegjësinë e gjyqësorit? Do të analizojmë dy raste: përgjegjësinë për gabimet gjyqësore dhe atë që rrjedh nga dhënia gabim e dënimeve me burgim të përkohshëm.

B / Përgjegjësia për gabimet gjyqësore

Ja një shprehje juridike që përsëritet shpesh. Gabimi gjyqësor është një e keqe që prek drejtësinë, pavarësisht nga masat e sigurisë që mund të vendosen. Pasi të përkufizojmë nocionin “gabimit gjyqësor” (1), do të studiojmë se kur ai çon në përgjegjësi të gjyqësorit (2).

1. NOCIONI I GABIMIT GJYQËSOR

Për të përkufizuar gabimin gjyqësor thjesht mund të themi se ai është një gabim i bërë nga drejtësia. Ky shpjegim është pak bindës, por ligjet mund të kontribojnë në qartësimin më tej të këtij nocioni.

Në të drejtën spanjolle, kodi penal nuk flet drejtpërdrejt për gabimin gjyqësor, por në nenin 121 thotë se shteti duhet të përgjigjet për gabimet e administratës së tij, që nënkupton gjithë administratën, duke përfshirë edhe

¹⁵ Claudio Movilla Alvarez, Responsabilidad des Estados y del Juez en los supuestos de prison provisional injusta, *Cuadernos de Derecho Judicial*, XVIII, 1996, f.1-24.

atë gjyqësore¹⁶. Gabimi gjyqësor mund të identifikohet atëherë kur drejtësia ka gabuar, kur ka dënuar ose ka vepruar padrejtësisht. Megjithatë duhet thënë se një gabim i bërë në përmbushjen e një akti ose formaliteti në asnjë rast nuk mund të shkaktojë përgjegjësi të gjyqësorit dhe të shtetit, pra as dëmshpërblim për dëmin e pësuar.

Vetë kushtetuta spanjolle flet për gabime gjyqësore në nenin 121 të saj, të cilin e cituam më sipër. Mirëpo ajo e bashkon gabimin gjyqësor me keqfunksionimin e administratës gjyqësore, gjë që kërkon një riparim nga shteti të dëmeve të shkaktuara. Fakti që është parashikuar mundësia e një gabimi gjyqësor dhe e funksionimit keq të drejtësisë, bën që i gjykuari të ketë besim të drejtësia. Mesazhi juridik i dhënë është se, sigurisht, gabimi ekziston, pagabueshmëria është e pamundur, por ekzistenca e njohjes së gabimit gjyqësor është një provë e mirë e përgjegjësisë së drejtësisë, pasi një drejtësi që e di se mund të gabojë është drejtësi që do të dijë edhe të ndreqë gabimet.

Por vetëm të pranosh ekzistencën e një gabimi gjyqësor do të ishte e kotë, në qoftë se kjo nuk do të shoqërohej me ato mekanizma juridikë, të cilët do të shërbenin për fillimin e përgjegjësisë së administratës gjyqësore, dhe pas saj edhe asaj të shtetit. Pra, pas shprehjes në kushtetutë të këtij parimi, përgjegjësia duhet konkretizuar me vendosjen e një regjimi juridik specifik.

2.REGJIMI I PËRGJEGJËSISË NDAJ GABIMIT JURIDIK

Çështja kryesore këtu është të dihet se si, pas njohjes juridike të gabimit gjyqësor nga juridiksionet kompetente – në veçanti në rastet e rishikimit – i gjykuari që është prekur nga ky gabim mund të ankohet për administratën gjyqësore, dhe se si ai mund ta çojë këtë të përgjigjet para një juridiksioni për gabimin e bërë. Më poshtë do të shikojmë sesi hapet një gjyq dhe mundësinë e ndreqjes nëpërmjet gjobës në parà. Këtu, ajo që na intereson në radhë të

¹⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese 108/1986, datë 29 shtator 1986.

parë, është të njohim regjimin e përgjegjësisë dhe se nga i vjen të dëmtuarit lehtësia që ai ka për t'i kërkuar drejtësisë të jetë përgjegjëse për veprat e veta.

Përgjegjësia në rastet e gabimit gjyqësor është shprehur në Kushtetutë. Gabimi gjyqësor (kur nuk kemi të bëjmë me një gabim të rëndë të magjistratit) është parashikuar si gabim i funksionimit administrativ, që do të thotë se e drejta administrative klasike gjen zbatim ashtu si për të gjitha administratat e tjera. Ky lexim i Kushtetutës së vitit 1978 është konfirmuar dhe shpjeguar me një vendim (Sentencia) të Gjykatës Kushtetuese në vitin 1986¹⁷, i cili saktëson se të gjithë qytetarët dhe pushtetet publike i nënshtrohen kushtetutës, se administrata, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, i nënshtrohet përgjegjësisë klasike në rastet kur keqfunksionimi i saj shkaktonte dëme. Atëherë janë Dhomat e grindjeve administrative ato që ngarkohen të marrin vendime lidhur me përgjegjësinë e gjyqësorit, dhe kjo në kuadrin e ligjit të vitit 1956¹⁸, i plotësuar në vitin 1998¹⁹; pra përgjegjësia e lidhur me administratën gjyqësore i nënshtrohet detyrimisht rregullave të përgjegjësisë administrative.

Për ta thjeshtuar, kur gabimi ose keqfunksionimi njihen nga një juridiksion, fillon përgjegjësia, pasi administrata është fajtoare. Kjo thjeshtësi në regjim lejon të qartësohet situata, sepse i gjykuari e di se me cilin regjim është përballur administrata. Por gabimi gjyqësor nuk është rasti i vetëm i mundshëm i keqfunksionimit të drejtësisë. Spanja, ashtu si vendet e tjera liberale, përdor një instrument klasik të procedurës penale, që është dënimi me burgim të përkohshëm. Ne do ta shikojmë se legjislacioni spanjoll përpiket, me të gjitha

¹⁷ Ligji i datës 27 dhjetor 1956: “Reguladora de la Juridiccion Contencioso-Administrativa”.

¹⁸ Ligji 29/1998, datë 13 korrik 1998: “Reguladora de la Juridiccion Contencioso-Administrativa”. Shih Manuel Martinez Bagueño, La Materia de Personal en la Ley 29/1998 de 13 julio, Reguladora de la Juridiccion Contencioso-Administrativa, *Ciberrevista de Derecho Administrativo*, IX, 1999 f.1-10.

¹⁹ Claudio Movilla Alvarez, Responsabilidad des Estado y del Juez en los supuestos de prison provisional injusta, *Cuadernos de Derecho judicial*, XVIII, 1996, f. 341-388.

mundësitë, të lehtësojë efektet që mund të jenë tepër të dëmshme në rastet e abuzimeve në këtë praktikë.

C / Përgjegjësi mbrojtëse në fushën e dënimeve me burgim të përkohshëm

Këtu, përveç dëshirës për të përmbushur një padrejtësi që ka prekur të gjykuarin viktimë të keqfunksionimit të administratës gjyqësore, qëllimi është të pengohet me çdo mënyrë kufizimi i përdorimit abuziv të këtij instrumenti që është dënimi me burgim të përkohshëm. Pra duhet evituar sa të jetë e mundur, dhe nëse kjo nuk është e mundur, atëherë të ndreqen, eksset abuzive me dënimin e përkohshëm (1), pikërisht për të kufizuar përdorimin e kësaj arme, e cila, nëse nuk pengohet nga një përgjegjësi e mundshme, papritmas mund t'i heqë dikujt lirinë (2).

1. QËLLIMI I PËRGJEGJËSISË: SHMANGIA DHE NDREQJA E EKSESEVE TË DËNIMIT TË PËRKOHSHËM

Justifikimi i dënimit me burgim të përkohshëm është se lejon ecjen mirë të drejtësisë si dhe mbron viktimat dhe shoqërinë në përgjithësi. Ai veçon individë potencialisht të rrezikshëm – ose që mendohet se janë të tillë – gjatë kohës së kryerjes së hetimeve nga shërbimet e ngarkuara për hetimet, të cilat janë të integruara në çdo juridiksion dhe që ndihmohen nga “El fiscal” (prokurori) Mirëpo ky instrument mund të bëhet shumë i rrezikshëm për individët. Për gabime gjyqësore mund të ketë një keqfunksionim të drejtësisë, e cila çon në dënimin abuziv me burgim të përkohshëm.

Në Kodin Penal dënimi i përkohshëm parashikohet në nenin 26, shtojca 1, si edhe në nenin 34, ku thuhet se mbajtja e përkohshme në burg nuk është e thënë të jetë dënim. Mbajtja në burg është humbje e lirisë, dhe kujtimi frankist e ka detyruar të drejtën moderne ta fusë këtë vendim në kufizime tepër të sakta. Kodi Penal ka dashur të kufizojë përdorimin e tij, dhe në raste abuzimesh, të ngrrejë një sistem përgjegjësish dhe rregullimesh. Edhe një herë, është neni 121 i Kodit Penal i cili rregullon përgjegjësinë e drejtësisë në

rastet e mbajtjes së përkohshme në burg, duke e kufizuar dënimin dhe shmangur ekzeset. Me raste abuzive nënkuptojmë dënimin e pajustificuar, të ndërmarrë para procesit penal²⁰, i cili padrejtësisht i ka hequr lirinë një personi. Ligji organik mbi pushtetin gjyqësor i vitit 1985²¹, në nenin e tij 294, vendos parimin e përgjegjësisë së drejtësisë në rastet e burgimit të përkohshëm. Korrigjimi vjen direkt nga kjo përgjegjësi. Jurisprudenca e mbështet këtë sistem: vendimi i Gjykatës Supreme, datë 27 janar 1989 vendos se përgjegjësia e gjyqësorit fillon automatikisht në rastin e dënimit të përkohshëm të pajustificuar dhe abuziv. Që nga kjo kohë jurisprudenca ka punuar që ta shtrojë sistemin e përgjegjësisë dhe të ndreqjes.²²

Sot debati në gjirin e doktrinës ka të bëjë me çështjen nëse dënimi i përkohshëm, parandalues, është një akt që vjen nga keqfunksionimi i drejtësisë apo përkundrazi, nga funksionimi i mirë i saj. Sepse neni 294, paragrafi 1 dhe ligji organik mbi pushtetin gjyqësor nuk flet për keqfunksionim të drejtësisë, ngaqë dënimi i përkohshëm, i cili pas procesit konsiderohet i pajustificueshëm nga marrja e pafajësisë, në fillimet e veta ka qenë cilësuar si diçka normale. Pra do të ketë një ndryshim themelor me gabimin gjyqësor, i cili futet në kuadrin konstitucional të funksionimit jonormal²³ të administratës gjyqësore.

Përgjegjësia e gjyqësorit fillon pas shpalljes përfundimtare të pafajësisë. Rasti i mangësive procedurale nuk hyn fare në këtë hipotezë. Nëse përgjegjësia lejon, pra, të kufizohen efektet shkatërruese që mund të ketë

²⁰ *Po aty.*

²¹ *Po aty.*

²² Juan Martinez Cardus Ruiz, Prision, preventiva y obligacion de indemnizacion, *La Ley*, 16 shkurt 1988, ku autori tregon se dënimi i përkohshëm është i domosdoshëm, edhe nëse pas gjykimit deklarohet pafajësia, dënimi deklarohet i padrejtë dhe pra duhet ndrequr, prapë se prapë nuk kemi gabim të gjyqësorit. Ky arsyetim mund të krahasohet me përgjegjësinë tonë.

²³ Claudio Movilla Alvarez, Responsabilidad del Estado y del Juez en los supuestos de prision provisional in justa, *vep. e cit.*

një dënim me burgim të përkohshëm i pajustificuar, duke i dëmshpërblyer në të holla këto efekte, kjo “mbrojtje”, e mundshme *a posteriori*, është gjithashtu edhe një frenim për përdorimin e procedurës së dënimit të përkohshëm nga ana e magistratëve.

2.EFEKTET ZHBINDËSE TË PËRGJEGJËSISË: NJË ARMË SHTRËNGUESE NË DUART E DREJTËSISË

Kjo është një armë në duart e hetuesisë, e cila lejohet nga Kodi Penal në nenin 34 të tij, e që nuk duhet përdorur shpesh dhe pa asnjëfarë sigurie. Por është në natyrën e saj edhe të jetë “e verbër”, për arsye se nuk është dhënë asnjë gjykim, dhe se ajo bazohet mbi provat ose hipotezat fillestare të magjistratit të ngarkuar me hetimin, i cili është i lidhur drejtpërdrejt me juridiksionin. Për të shmangur çdo lloj abuzimi ose përdorimi sistematik të saj, e drejta spanjolle ka krijuar një përgjegjësi të drejtpërdrejtë të parë paraprakisht, e cila fillon pas deklarimit të pafajësisë, me kërkesë të të pandehurit të cenuar, me qëllim zhbindjen dhe inkurajimin për një reflektim më të pjekur të përdorimit të saj. Ne mund të flasim për armë shtrënguese, pasi ekziston siguria *a posteriori*, pas dënimit me burgim të përkohshëm dhe gjykimin, por perspektiva e një zbatimi të mundshëm të përgjegjësisë lejon një kufizim të vërtetë të këtij instrumenti. Efektivisht magjistratit, i cili është në dijeni të përgjegjësisë që mund lindë pas përdorimit të pajustificuar, do t’i duhet t’i peshojë të gjitha implikimet e mundshme²⁴.

Pra pamë se si keqfunksionimet e drejtësisë mund të shkaktonin përgjegjësinë e administratës gjyqësore, ashtu si edhe dënime të padrejta me burgim të përkohshëm, megjithatë ato nuk përbëjnë gabime. Tani na duhet të shohim se angazhimi i mundshëm i përgjegjësisë është efikas atëherë kur ekzistojnë mekanizmat e ankimit dhe të ndreqjes.

²⁴ Po aty.

D / Mekanizmat për zbatimin e përgjegjësisë

Në fakt, pas afirmimit të përgjegjësisë së shtetit lidhur me gjyqësorin, duhet që e drejta spanjolle të tregojë vazhdimësi në vizionin e vet mbi shtetin liberal. Përgjegjësia dhe dëmshpërblimi janë të lidhura nga kushtetuta, si dy gjëra që shkojnë bashkë, gjë që i jep të drejtës për dëmshpërblim një peshë jo të vogël në rendin juridik. Kjo e drejtë për dëmshpërblim supozon vendosjen e mekanizmave për t'iu drejtuar juridiksioneve në rast të gabimit gjyqësor ose të dënimit të padrejtë të përkohshëm (1), dhe gjithashtu, sigurisht, edhe mekanizmat e dëmshpërblimeve efektive (2).

1. MEKANIZMAT E HAPJES SË NJË GJYQI

Këtu ligjvënësi ka treguar thjeshtësi ose dëshirën për thjeshtësi. Duke u nisur nga ideja për të mos i shtuar gabimit ose keqfunksionimit të gjyqësorit atë kompleksitet që e karakterizon atë, e drejta spanjolle ka vendosur një sistem klasik të hapjes së një gjyqi për këto raste. I cenuari nga ndërhyrja e gjyqësorit, ciladoqoftë ajo, duhet t'i drejtohet juridiksionit që ka dhënë vendimin fajësues. Neni 294, paragrafi 1, i ligjit organik të vitit 1985 mbi organizimin e pushtetit gjyqësor vendos gurin themelor në këtë sistem. Gjykata Supreme e ka plotësuar dhe zhvilluar atë. Në vendimin e saj të datës 14 dhjetor 1989, mbi dënimin e përkohshëm (jurisprudenca është e njëjtë edhe për rastet e keqfunksionimit të drejtësisë), ajo është shprehur se që nga momenti kur, në një mënyrë apo një tjetër, është deklaruar pafajësia, ky vendim është i mjaftueshëm për t'iu drejtuar juridiksionit në fjalë. Në kërkesë duhet të shtohet vendimi që shpall pafajësinë. Këtu nuk ka juridiksione speciale, gjë që është pasojë e unitetit të juridiksionit në Spanjë, edhe pse është e drejta administrative, e quajtur “për grindjet administrative”, ajo që përdoret direkt, sipas ligjit të vitit 1956, tashmë të përmendur bashkë me shtojcën e vitit 1998, e cila ia merr stafetën të drejtës penale²⁵.

²⁵ German Fernandez-Farreres, *vep. e cit.*

Vendimi gjyqësor për përgjegjësinë jepet në instancë të fundit nga Gjykata Supreme, pasi këtu janë mundësitë për apel. Neni 61 i ligjit organik të vitit 1985 mbi pushtetin gjyqësor, parashikon mundësinë e përdorimit në instancën e fundit të një seksioni *ad hoc* gjatë rishqyrtimit. Por, në praktikë, e gjithë procedura kryhet përpara seksioneve “normale” të kësaj gjykate.

Afati i zbatimit është tre muaj nga dita e shpalljes së pafajësisë (neni 293, paragrafi 1, i ligjit organik mbi pushtetin gjyqësor). Duka marrë parasysh thjeshtësinë e procedurës së hedhjes në gjyq, ky afat sigurisht që është i kalibruar mirë. Kjo thjeshtësi, për të cilën ka shumë pak komente për të bërë, i hap rrugën dëmshpërblimit që detyrohet të kryejë administrata gjyqësore për keqfunksionimin e saj.

2. MEKANIZMAT E DËMSPËRBLIMIT

Edhe pse është drejtësia ajo që ka kryer gabimin dhe me gjithë autonominë dhe pavarësinë që i është dhënë kësaj administrate, pushteti qendror është trashëgimisht përgjegjës. Sapo merr kërkesën për gjyq, juridiksionit, nëpërmjet dhomës së tij, nëndarjes apo seksionit, sipas emërimit të çështjes administrative, do t’i duhet të gjykojë për shkallën e rëndësisë së gabimit dhe të përcaktojë kështu sasinë e dëmshpërblimit. Sistemi është i njëjtë me atë që përdoret për pjesën tjetër të administratës klasike²⁶. Ai është ndërtuar shumë mirë, sepse jurisprudenca ka krijuar këtu “një grilë” të dëmshpërblimit²⁷. Ne nuk e fshehim kompleksitetin ekstrem të kësaj “grile” ku thuren e ndërthuren një numër i madh kriteresh (rëndësia e gabimit, dëmi moral, financiar, familjar, profesional etj.), të cilat mundësojnë vlerësimin e dëmshpërblimit. Mirëpo

²⁶ Xavier Sambola, *Acerca de la reparacion integral del daño en los casos de responsabilidad patrimonial de la administration*, shkurt 2001, f.1-2.

²⁷ Claudio Movilla Alvarez, *Responsabilidad del Estado y del Juez en los supuestos de prision provisional in justa*, *vep. e cit.*, e cila përmbledh tërësinë e mendimit të doktrinës për këtë çështje.

është e vështirë të caktosh sasinë e dëmeve të pësuarra dhe pastaj të vendosësh për shumën që duhet dhënë. Një ditë heqje lirie dhe mbajtjeje në burg nuk është e lehtë për t' u llogaritur. Megjithatë gjyqtarëve u është dashur të kalojnë përtej kësaj vështirësie morale, për të gjetur më në fund një sistem dëmshpërblimi. Doktrina spanjolle nuk kritikon, të paktën në linja të trasha, vendosjen e kësaj “grile”²⁸. Por do të ishte më e drejtë të flitej, në vend të dëmshpërblimit, për përpjekje për riekulibrim të telasheve të pësuarra. Për të mbrritur në konsiderata më juridike, është interesante të theksohet që jurisprudenca, veçanërisht Gjykata Supreme, nuk mbështetet kryesisht në të drejtën administrative - e cila shërben vetëm për mekanizmat e dëmshpërblimit në të holla - por në nenin 121 të Kushtetutës së vitit 1978.

Dëmshpërblimi pra ekziston, gjë që i jep përgjegjësisë së gjyqësorit në Spanjë një ekzistencë reale duke mundësuar kështu një legjitimitet më të madh të tij. Por rastet e funksionimit jo normal të drejtësisë ose të dënimeve të përkohshme të padrejta angazhojnë vetëm përgjegjësinë e administratës. Edhe gabimet e magjistratëve janë të parashikuara në të drejtën spanjolle. Një nga pyetjet që ka lindur mbi këtë problem, është se, kur bëhet fjalë për përgjegjësinë e tyre, a janë gjyqtarët në të njëjtin pozicion me nëpunësit e tjerë të shtetit?

III. GJYQTARËT, NËPUNËS SI TË TJERËT?

Në sistemin spanjoll të krijuar në vitin 1978, administrata i nënshtrohet përgjegjësisë direkte. Mirëpo e drejta ka shkuar më larg, duke krijuar, në rastet e gabimeve personale, të vërtetuara, të një nëpunësi të shtetit, sistemin e përgjegjësisë direkte të tij. Megjithëkëtë, mund të ekzistojë një veprim i përzier, sipas të cilit qytetari sulmon vetëm administratën, e cila pastaj i kërkon llogari nëpunësit të saj për atë pjesë të dëmeve, për të cilat ajo vetë nuk

²⁸ Consejo General del Poder Judicial, La prevaricacion judicial, *Cuadernos de Derecho Judicial*, nr.4, f.1- 20.

është përgjegjëse. Edhe magjistratët nuk i shpëtojnë këtij rregulli. Nëse efektivisht përballë shtetit ata kanë një status të veçantë, i cili garanton pavarësinë e tyre, nuk ndodh e njëjta gjë me të gjykuarit, pasi përgjegjësia direkte e gjyqtarëve është një nga burimet e legjitimitetit të atyre. Fillimisht do të paraqesim këndet e ndryshme të sulmit të përgjegjësive së magjistratëve (A), pastaj mekanizmat e hedhjes në gjyq (B), dhe në fund kushtet e dëmshpërblimit (C).

A / Shtrirja e përgjegjësive së gjyqtarëve

Në këtë pjesë do të shohim se përgjegjësia zhvillohet në mënyrë tepër klasike sipas tre akteve, të cilat janë përgjegjësia civile (1), që prek gjyqtarët (atëherë kur ka mundësi ndërhyrjeje nga administrata gjyqësore), përgjegjësia penale (2), e cila prek drejtpërdrejt dhe vetëm magjistratin dhe ajo disiplinore (3).

1.PËRGJEGJËSIA CIVILE

Kjo përgjegjësi është me siguri më e njohura dhe më e zhvilluara nga përgjegjësitë. Magjistrati, ashtu si çdo nëpunës i shtetit spanjoll, i nënshtrohet një përgjegjësie civile. Në këtë rast është ende ligji i famshëm organik mbi pushtetin gjyqësor ai që rregullon këtë fushë. Edhe pse gjyqtari mund të mos ketë përgjegjësi ndaj pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, përgjegjësia e tij civile, si pasojë e pavarësisë së tij, është e domosdoshme.

Neni 411 i këtij ligji është tepër i qartë për sa i përket përgjegjësive së magjistratëve, të cilët “duhet të përgjigjen nga ana civile për dëmet që mund të shkaktojnë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, kur kanë kryer gabim ose faj”. Nenet 412 dhe 413 të ligjit për pushtetin gjyqësor vazhdojnë po për përgjegjësinë civile, por neni 413, paragrafi 2 thekson se kjo përgjegjësi nuk jep të drejtën e një rishikimi automatik të vendimit gjyqësor që e ka shkaktuar atë.

Përgjegjësia civile pra është e varur nga kryerja e një gabimi nga magjistrati sipas pikëpamjes së nenit 101 të Kodit Penal, por mbi të gjitha

sipas asaj të nenit 1092 të Kodit Civil²⁹. Bëhet fjalë për një përgjegjësi jashtëkontraktore, sipas nenit 1093, dhe magjistratët përgjigjen direkt nga të ardhurat e tyre për gabimet e bëra. Këtu duhet shënuar që nuk ekziston asnjë detyrim për magjistratin të firmosë sigurime për kryerjen e funksionit, sigurime të cilat as që nuk ekzistojnë fare. Ky sistem është i papranueshëm, pasi një gjyqtar nuk mund të paguajë ose nuk mund të ketë të ardhura të mjaftueshme, gjë që shkakton probleme dhe vonesa në dhënien e dëmshpërblimit.

Ja pra se si shpjegohet që përgjegjësia civile është më pak e përdorura nga tri tipet e përgjegjësive. Në vazhdim do të shohim gabimet për të cilat mund të nisë përgjegjësia, së bashku me studimin e përgjegjësive penale. Procedura e nisjes së përgjegjësive civile të një magjistrati është e thjeshtë: ajo bëhet para juridiksioneve të zakonshme (në dhomat civile ose penale, sipas zgjedhjes së të dëmtuarit) dhe sipas rregullave të së drejtës civile.

2.PËRGJEGJËSIA PENALE

Ligji organik dhe Kodi Penal janë ata që zbatohen në rastet e përgjegjësive penale të magjistratëve. Para se t'i shohim këto, po bëjmë një përmbledhje të gabimeve të ndryshme që mund të bëjë një magjistrat gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

“Prevaricacion judicial” (gabim gjyqësor) është termi që grupon gabimet pak a shumë të qëllimshme të gjyqtarëve. Ky sistem i “prevaricacion judicial” (ne po e ruajmë terminologjinë spanjolle, pasi asnjë përkthim i saj nuk na pëlqeu – *shënimi është i autorit*) vjen që nga e drejta romake, e cila u shfaq shumë herët në Spanjë, në të njëjtën kohë me përgjegjësinë e gjyqësorit, rasti më tipik i së cilës është ai i një gjyqtari që shkel ligjin për arsye politike, për mungesë njohurish ose edhe për motive personale. Kjo e treta vazhdon

²⁹ Maria Casas Estevez Javier, La prevaricacion judicial, *Noticias Juridicas*, korrik 1999, f.1-7.

të jetë me shumicë në jurisprudencën spanjolle³⁰. Shkelja e ligjit për arsye politike vë drejtpërdrejt në dyshim pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarit.

“Prevaricacion judicial” është përkufizuar më gjerësisht si “çdo gabim ose veprim i vullnetshëm që bie ndesh me detyrimet e detyrës së magjistratit”³¹, përkufizim i cili qartëson kuadrin e funksioneve të gjyqtarit. “Prevaricacion judicial” fillon që me Kodin Penal të vitit 1822. Nga pikëpamja penale ky “prevaricacion judicial” është konsideruar si shkelje kundër administratës gjyqësore³².

Neni 417 i të këtij ligji jep një listë të gabimeve shumë të mëdha, që janë pikërisht tradhtia e besimit të Kushtetuta (të gjithë nëpunësit, cilido qoftë rangu i tyre duhet të betohen para kushtetutës), aderimi ose anëtarësimi në një parti politike, përpjekjet për t’i bërë presion një magjistrati tjetër, gabimet e bëra nga pakujdesia e vullnetshme në zbatimin e së drejtës, rastet e korrupsionit, abuzimet me funksionin për qëllime përfitimi dhe shkelja e sekretit të hetimit. Të gjitha këto quhen gabime shumë të rënda që mund të bëjë një magjistrat.

Gabimi i rëndë, si i tillë, është shprehur në nenin 418 të ligjit, bashkë me një listë të rasteve të gabimeve. Për shkak të kryerjes së tyre mund të fillojë përgjegjësia penale e magjistratëve, mirëpo kur janë të një rëndësie të vogël, mund të kalohet në përgjegjësi civile të tyre³³. Ndër gabimet e rënda mund të përmendim mungesën e respektit ndaj hierarkisë së pushtetit gjyqësor si edhe kritikën ndaj drejtësisë, rekomandimet e dhëna mbi gjykimet e bëra

³⁰ Carlos Vieites Perez, Delitos de prevaricacion, nueva regulacion dentro de los delitos contra la administracion de la supresion de antejuicio, *Cuadernos de Derecho Judicial*, 1997, f.1-15.

³¹ *Po aty*.

³² Eduardo Jauralde Morgado, La responsabilidad del Juez, *Poder Judicial*, 1982, nr.3, f.15-16.

³³ Claudio Movilla Alvarez, Responsabilidad del Estado y del Juez en los supuestos de prision provisional injusta, *vep. e cit.*

nga një magjistrat, fakti i shfrytëzimit të pozicionit dhe statusit të gjyqtarit për të drejtuar veprime administrative, abuzimi me autoritetin, ose edhe mungesa e autoritetit dhe përgjegjshmërisë ndaj këtyre funksioneve, mungesa e pajustificuar në juridiksion nga tre deri në shtatë ditë, dhe, së fundi mospërfillja ndaj akteve që duhen përmbushur gjatë seancave publike në raste tepër të rëndësishme.

Kategoria e fundit e gabimeve, gabimet e lehta, shprehen në nenin 419 të ligjit: ajo përfshin rastet që nuk janë përmendur te gabimet e rënda dhe tepër të rënda, por që megjithatë janë të përsëritura nga ana e gjyqtarit. Këto janë mungesa e respektit ndaj superiorit hierarkik, e papërmendur te rastet e rënda, mosinteresimi për ndihmësit, kalimi i pajustificuar i afateve, refuzimi për të ndjekur udhëzimet e dhëna nga Këshilli i Përgjithshëm i Pushtetit Gjyqësor ose nga Kryetari i gjykatës së cilës i përket gjyqtari.

Neen 405 deri 409 të ligjit rregullojnë përgjegjësinë penale të gjyqtarëve në lidhje me nenin 121 të Kodit Penal. Çdo person i prekur, ashtu si edhe prokuroria, mund të kërkojnë fillimin e përgjegjësive penale. Magjistrati gjykohet nga seksionet penale të gjykata të zakonshme. Këtu rregulli është i njëjtë për të gjithë nëpunësit fajtorë që kanë kryer vepra të dënueshme nga Kodi Penal. Magjistrati akuzohet direkt, edhe pse mund të ekzistojë një veprim i dorës së dytë kundër administratës gjyqësore (që lejon ndreqje më efikase), ashtu si në fushën e përgjegjësive civile³⁴. Asgjë nuk mund ta ndryshojë përgjegjësinë e gjyqtarit, as edhe gjykata e ngarkuar për ekzaminimin e çështjes.

Pra magjistrati spanjoll, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, është penalisht përgjegjës si gjithsecili. “Prevaricacion judicial”, e cila bën që gjyqtari të pranojë gabimet penale, është një sistem i përkryer në Spanjë: në fakt, që

³⁴ Manuel Mata dhe Martin Ricardo, El principio non bis in idem de la reforma de la responsabilidad penal uy disciplinaria de jueces magistrados, *Cuadernos de Derecho Juridicial*, 1997, nr.3, f.1-18.

nga viti 1992, 21 çështje penale janë dërguar në gjykata. Interesant është fakti që për 20 prej tyre ka vendosur Gjykata e Lartë e Drejtësisë (më e kërkuara ajo e Andaluzisë), dhe vetëm një është apeluar në Gjykatën Supreme. Gjyqtarët e dënuar nuk mund të procedojnë dhe i nënshtrohen gjykimit të shokëve të tyre. Në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me çështje që lidhen me “prevaricaciones” të shkeljes së ligjit.

Përgjegjësitë civile dhe penale janë pra të njëjta për çdo funksionar, po a ndodh kështu me përgjegjësinë disiplinore?

3.PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Përgjegjësia disiplinore nuk ka të bëjë me marrëdhëniet midis magjistratit që gabon dhe të gjykuarit që është cenuar, por me marrëdhëniet midis magjistratit, funksionit të tij juridiksional dhe hierarkisë së tij. Këtu zbatohet pjesa e sanksioneve e së drejtës administrative. Përgjegjësia disiplinore realisht nuk lejon dëmshpërbim, por ajo kryen një funksion bindës dhe shembulli për mospërsëritje të të njëjtit gabim. Magjistrati gjendet i vetëm përballë makinës gjyqësore. Një mekanizëm i aksionit civil ose penal³⁵ mundëson forcimin e legjitimitetit të magjistratit që mund të sanksionohet nga hierarkia e tij.

Neuet 414 dhe 416 të ligjit organik flasin për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve. Ashtu siç e kemi përmendur edhe më parë, kjo përgjegjësi i shtohet dy të parave. Kjo “shtesë” sanksionesh bëhet vetëm pas përfundimit të plotë të procedurave civile ose penale dhe kur vendimet janë dhënë përfundimisht e nuk mund të ndryshohen. Gabimet janë të njëjta (domethënë shumë të rënda, të rënda dhe të lehta) dhe kushtet për angazhimin e kësaj përgjegjësie u përgjigjen të njëjtave kriterë si përgjegjësitë e tjera. Përgjegjësia disiplinore bëhet para juridiksioneve të zakonshme, në dhomat e çështjeve

³⁵ López Muñoz Rianzares, *vep. e cit.* Ka edhe jurisprudenca më të hershme, e para është nga Gjykata e Lartë më 10 tetor 1987, mirëpo Gjykata e Lartë e Katalonjës është e para që formulon qartë kushtet për fillimin e përgjegjësisë.

administrative, i vetmi ndryshim ky me majën e piramidës së apelit, ku “gjqytari” i fundit është Këshilli i Përgjithshëm i Pushtetit Gjyqësor. Kjo përgjegjësi disiplinore është klasike, po kështu edhe sanksionet, që fillojnë nga paralajmërimet (në raste të gabimeve të lehta) deri në gjoba dhe pezullime për një periudhë trevjeçare. Sanksion përpjesëtohet me rëndësinë e gabimit, në përputhje me kërkesat e të drejtës europiane.

Mbetet të studiojmë tani mekanizmat e ndryshëm, që shërbejnë për të zbatuar tre përgjegjësitë e shqyrtuara më lart.

B / Mekanizmat e ndryshëm të zbatimit të përgjegjësiave

Parimi i përgjegjësisë së gjyqtarëve duhet të plotësohet nga një arsenal masash që e vënë atë në zbatim, duke siguruar kështu efektivitetin e tij. Po a i nënshtrohen magjistratët një regjimi të veçantë, apo, përkundrazi, edhe për ta zbatohet ai regjim klasik si për gjithë nëpunësit? Pikërisht kjo e dyta është për zgjedhur nga ligjvënësi spanjoll (1). Pasoja e mungesës së një specificiteti në këtë rast bën që ata të gjykohen nga gjyqtarë të tjerë, të cilët mund të kenë të njëjtin funksion...dhe ndoshta të njëjtat dobësi (2).

1.REKURSET JURIDIKE JOSPECIFIKE

Para se të flasim për rekursat e mundshme në rast të përgjegjësisë së një magjistrati, duhet të kujtojmë se gjyqtari dhe gjithë aktorët e tjerë të drejtësisë, i nënshtrohen të njëjtës përgjegjësi me punonjësit e administratës, me ndryshimin e vetëm e karakteristik për të, që është pavarësia. Duke qenë se i përket funksionit publik, ai mund t’i nënshtrohet sanksioneve të mundshme administrative.

Kushtet për fillimin e një përgjegjësie janë formuluar nga Gjykata e Lartë e drejtësisë së Katalonjës më 15 janar 1993³⁶, e cila është mbështetur në ligjin organik për të përcaktuar rregullat e akuzës ndaj magjistratit. Këtu

³⁶ Ibid.

thuhet se veprimi dëmtues i gjyqtarit duhet të jetë kryer gjatë përmbushjes së detyrave të tij. Kushtet e tjera, të shpallura si “speciale” dhe “të domosdoshme” për hetimin që do bëhet ndaj gjyqtarit, përcaktojnë edhe të gjitha kriteret e duhura. Fillimisht, çështja për të cilën akuzohet gjyqtari, duhet të jetë e përfunduar krejtësisht (kjo është nxjerrë nga neni 413 i ligjit). Kuptohen lehtësisht arsyet e kësaj kërkesë, sepse duhet që gabimi i gjyqtarit duhet të jetë i sulmueshëm. Pastaj, duhet që, për çështjen për të cilën ngrihet akuza ndaj gjyqtarit, të jenë përmbushur të gjitha afatet e përcaktuara. Kriteri i tretë ka të bëjë me shkeljen flagrante të ligjit nga gjyqtari, domethënë të bëhet fjalë për një shkelje të hapur të ligjit. Kriteri i katërt që ka përcaktuar juridiksioni i lartë i Katalonjës është që të kemi të bëjmë me një dëm i cili ka lidhje shkakësore me aktin që inkriminon gjyqtarin.

Me datën 10 qershor 1995 Gjykata e Lartë, duke u mbështetur në nenin 1902 të Kodit Civil, e plotësoi këtë kriter të fundit, duke u shprehur se dëmi duhet të jetë i vlerësueshëm në parà, dhe gabimi që akuzon gjyqtarin duhet të jetë shkak i drejtpërdrejtë i këtij dëmi. Në qoftë se nuk është kështu, akuza kundër gjyqtarit shuhet. Jurisprudenca, që këtu është konstante, ka cilësuar tre tipet e gabimeve (shumë të rënda, të rënda dhe të lehta), të pafalshme, të shkaktuara nga padija dhe ato të shkaktuara me vullnet të pafalshëm³⁷. Ky cilësim bën që i gjykuari të mos synojë direkt njërin nga tre tipet, por thjesht t’i drejtohet gjykatës për gabim ose vullnet të pafalshëm, pastaj është vetë gjykata ajo që përcakton llojin e gabimit të kryer nga gjyqtari. Ky sistem paraqet kështu një thjeshtësim të madh procedural. Në fillim të procedurës viktime zgjedh, si të thuash, “këndin” e vet të sulmit, që mund të jetë vetë gjyqësori për funksionim të keq ose jonormal, ose gjyqtari për gabime të pafalshme të tij, duke ndërmarrë kështu përgjegjësinë personale. Do të shohim se mund të ekzistojë edhe një përgjegjësi e pjestuar midis të dyve.

³⁷ López Muñoz Rianzares, *vep. e cit.*

E drejta që zbatohet për gjyqtarin në akuzë, pas fillimit të procedurave dhe pasi të jenë plotësuar kushtet, është e njëjtë me atë që zbatohet për çdo nëpunës: ligji i vitit 1956 mbi grindjet administrative, i ndryshuar në vitin 1998, ai që zbatohet dhe që i detyron gjyqtarët të përdorin rregullat klasike civile dhe penale. Duhet të përmendim këtu vendimin e Audiencës Kombëtare të datës 2 mars 1991, e cila saktëson se, edhe pse magjistratët janë pjesë përbërëse e pushtetit gjyqësor të pavarur nga shteti dhe të liruar nga çdo lloj përgjegjësie ndaj tij, ata, para qytetarëve janë nëpunës si gjithë të tjerët, e po ashtu si ata duhet t'i nënshtrohen përgjegjësi.

Pas studimit të rekurseve në dispozicion të të gjykuarit të cenuar nga gjyqtarët, të shohim se cilët janë juridiksionet kompetente për njohjen e kësaj përgjegjësie.

2.GJYQTARËT E GJYKUAR NGA KOLEGËT E TYRE

Siç e kemi thënë, gjykatat e zakonshme janë ato që kanë kompetencën për këto lloj çështjesh. Ndarja brenda juridiksionit, nuk ka rëndësi niveli i instancës, bëhet thjesht kështu: kur kemi të bëjmë me një akuzë civile ndaj gjyqtarit, është dhoma civile ajo që e zgjidh atë; kur bëhet fjalë për përgjegjësi penale, atëherë është dhoma penale, dhe në rastet e përgjegjësisë disiplinore, do jetë dhoma e çështjeve administrative (me përjashtimin që maja e hierarkisë së apelit është kompetencë e Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor). Pra gjyqtarët e zakonshëm gjykojnë të tjerë gjyqtarë të zakonshëm, ku ndonjëherë ndodh që të jenë në të njëjtin juridiksion, pra të jenë kolegë.

Në rastet e përgjegjësisë civile dhe penale procedura është krejtësisht si e së drejtës së përgjithshme, si për çdo nëpunës, pra për çdo qytetar. Për sa i përket përgjegjësisë disiplinore, kemi disa ndryshime: në fakt, gjyqtari i thjeshtë i çështjeve administrative vendos për faktin që gjyqtari i vënë në akuzë është fajtor ose jo, por në rast të një përgjigje pohuese, neni 421 i ligjit organik i jep fuqinë e përcaktimit të sanksionit disa organeve të tjera. Çdo gjë varet nga gabimi i kryer prej gjyqtarit fajtor. Në rast se bëhet fjalë për gabim të lehtë, çdo gjyqtar mund të shprehet për sanksionin: mendohet se ai gjyqtar që e ka

cilësuar fajtor mund të vendosë edhe për sanksionin. Përkundrazi, kur kemi të bëjmë me gabim të rëndë, janë seancat plenare të Gjykatave të Larta, të Audiencës Kombëtare dhe Gjykata Supreme që prononcohen për sanksionin. Për gabime tepër të rënda, vendos Komisioni disiplinor i Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor. Këtu mund të zhvillohet edhe një seancë plenare e Këshillit të Përgjithshëm, kur kemi të bëjmë me largim nga detyra të një gjyqtari³⁸. Sigurisht që gjyqtari, si çdo i paditur tjetër, ka të drejtën e mbrojtjes në të gjitha stadet e procedurës. Derisa të jetë dhënë vendimi përfundimtar ai ka të drejtë të qëndrojë në detyrë – vetëm në rastet e gabimeve tepër të rënda, që mendohet se mund të dënohet me largim nga detyra, ai qëndron përkohësisht i pezulluar³⁹.

Këtij sistemi mund t'i drejtohet një kritikë: janë gjyqtarët e thjeshtë ata që gjykojnë magjistratët e akuzuar. Mund të shfaqen rreziqe për marrëveshje të fshehta, solidaritet të trupave gjykues etj., të cilat nuk duhen neglizhuar. Një tjetër kritikë, që përsëritet vazhdimisht në të gjitha sistemet juridike dhe që nuk është problem specifik vetëm i sistemi spanjoll, është se cilët janë ata që do gjykojnë gjyqtarët e lartë?

Tani na mbetet të vëzhgojmë pasojën e fundit të kësaj përgjegjësie të gjyqtarit, pra realitetin e dëmshpërblimeve.

C / Realiteti mbi dëmshpërblimet

Që kjo përgjegjësi të jetë efikase duhet të lejojë që në fund të procesit viktimat të dëmshpërblehet realisht për dëmet që i janë shkaktuar nga gabimi personal i gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës. Pra është mirë të prekim tani edhe problematikën e ndarjes së përgjegjësive midis gjyqësorit dhe gjyqtarëve të tij (1) dhe pastaj të tregojmë pasojat monetare të përgjegjësive të gjyqtarëve, domethënë se si ata bëhen llogaritarë të gabimeve të tyre (2).

³⁸ *Ibid.*

³⁹ Carlos Vicites Perez, *vep. e cit.*

1.NDARJA E PËRGJEGJËSISË MIDIS GJYQËSORIT DHE GJYQTARËVE TË TIJ

Para se të trajtojmë këtë ndarje, ju kujtojmë se për të garantuar sa më mirë interesat e tyre, u këshillohet të gjykuarve, të cilët e quajnë veten viktime të një gjyqtari ose të drejtësisë, të vënë në lëvizje dy rrugët e së drejtës. Ligji organik parashikon se çdo gjë rregullohet me administratën gjyqësore, i gjykuari pra ka të bëjë vetëm me të. Pastaj bëhet ndarja e përgjegjësisë me magjistratin e akuzuar, kur është vërtetuar se gabimi i tij personal ka shkaktuar një pjesë të dëmit. Kështu pra kemi, pas dënimit të gjyqësorit, rekurs të shtetit kundër gjyqtarit. Interesate është të theksohet që ekziston edhe një rekurs i shtetit ndaj akuzuesve dhe dëshmitarëve të rremë, që e kanë çuar drejtësinë dhe gjyqtarin në vendime të gabuara⁴⁰. Kur përgjegjësia është ndarë, administrata mund të drejtohet kundër gjyqtarit duke përdorur tre kategoritë e përgjegjësisë.

Jurisprudenca tregon orientimet kryesore të veprimeve. Në fakt ato bëhen më shumë nën formën disiplinore. Kjo gjë kufizon marrjen direkt të përgjegjësisë nga gjyqtari, pasi përgjegjësia disiplinore është sigurisht më pak poshtëruese dhe më pak e egër për magjistratin. Ne mund të përmendim këtu mendimin e Z. Lopez Muñoz, sipas të cilit “përgjegjësia disiplinore është në fakt shfaqje e fuqisë sanksionuese të administratës ndaj disa veprimeve të gjyqtarëve, të cilët edhe pse nuk kanë kryer krim, nuk kanë kryer detyrat e tyre profesionale”.

Në faktet e nxjerra nga jurisprudenca, vihet re se në një rast gabimi tepër të rëndë, që mund të çonte në përgjegjësi penale, i lënduari do të sulmojë vetëm gjyqtarin, dhe jo administratën gjyqësore, sepse përgjegjësia penale është direkte. Gjykata Supreme, në interpretimin që i bën nenit 411 të ligjit organik për këtë pikë, ka saktësuar, në vendimin e datës 10 nëntor 1987 se gjyqësori mund të futet në procedurë nëse gjyqtari ka shkelur një normë “fleksibël”, që do të thotë

⁴⁰ Claudio Movilla Alvarez, La responsabilidad del Estado-Juez, *vep. e cit.*

se i lë pushtet gjyqtarit; mirëpo në rast se gjyqtari ka shkelur një normë “të ngurtë”, e cila i imponon atij një veprim që ai e ka shkelur me qëllim, atëherë i duhet ta përballojë i vetëm përgjegjësinë e tij. Duhet nënvizuar se rasti i shkeljes së një lirie themelore hyn në kuadrin e normës “së ngurtë”.

Me t’u bërë ndarja e përgjegjesisë, qoftë kur bie plotësisht, qoftë kur bie pjesërisht në shpatullat e gjyqtarit gabues, fillon dëmshpërblimi, në kuptimin monetar të fjalës, dhe jo më në kuptimin e sanksionit, siç mund të jenë përgjegjësitë penale dhe disiplinore.

2.GJYQTARËT LLOGARITARË TË GABIMEVE TË TYRE

Po kujtojmë këtu se magjistratët edhe pse mund të preken nga procedurat e përgjegjesisë, nuk kanë sigurime të veçanta ose të detyrueshme. Pra kur gabojnë, ata janë përgjegjës me të ardhurat e tyre personale. Në rastet e rekurseve, viktimat është e mbrojtur nga pamundësia për pagesë e gjyqtarit, sepse shteti me fuqinë e vet financiare mund të plotësojë këtë pamundësi (neni 296 i ligjit organik për pushtetin gjyqësor)⁴¹. Megjithatë, mundësia që viktimat të gjendet e vetme përballë gjyqtarit “të vet” gabues, nxjerr në pah kufizimet e sistemit. Rasti i gjyqtarit me pamundësi pagese është parashikuar krejtësisht, gjë që mund të shkaktojë probleme në efikasitetin e dëmshpërblimit.

Magjistrati që gabon gjendet pra personalisht dhe financiarisht përgjegjës për gabimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës. Për ta llogaritur dëmshpërblimin, jurisprudenca përdor po ato kritere që përdoren në rastet e keqfunksionimit të administratës gjyqësore, pra dëmshpërblimi duhet bërë sipas nenit 292, paragrafi 2 i ligjit organik. Jurisprudenca shprehet se dëmi mund të jetë material dhe/ose moral.

Për vlerësimin, juridiksioni kompetent llogarit, për shembull, ditët e kaluara

⁴¹ Claudio Movilla Alvarez, Responsabilidad del Estado y del Juez en los supuestos de prison provisionnal injusta, *vep. e cit.*

në burg për gabim të gjyqtarit. Gjykata e Lartë, në vendimin e saj të datës 26 tetor 1993, ka futur në llogari pagat që nuk janë marrë, duke i shtuar edhe shumën e akorduar për një ditë burg⁴². Po kështu mund të futen në llogari edhe dëmtimet e gjendjes shëndetësore dhe impakti në reputacionin e personit. Për shembull, në çështjen e gjykuar më 16 tetor 1995, ku viktimat, për shkak të shkeljes së ligjit nga gjyqtari qëndroi në burg nga 5 maji 1988 deri më 3 qershor 1988, Gjykata e lartë i dha 10 milionë e 500 000 peseta dëmshpërblim (60 000 franga franceze)⁴³.

Gjyqtarët nuk rrinë pra të padënuar për gabimet e bëra. Çështja është, në kuadrin e studimit tonë, të dihet nëse dëmshpërblimet janë të mjaftueshme; por ne mund të konstatojmë që sistemi ka fituar përvojën e duhur dhe jurisprudenca është tashmë e plotësuar për sa i përket të drejtës për dëmshpërblim.

KONKLUZION

Para se ta mbyllim këtë studim mbi përgjegjësinë e administratës së drejtësisë në Spanjë, në rast të funksionimit të parregullt të gjyqësorit ose në rast të gabimeve të magistratëve, duhet të përmendim ndikimin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës. Gjykata dhe juridiksioni duhet të jenë të paanshëm dhe “shkarjet” duhet të ndreqen. Që me vendimin e Gjykatës Kushtetuese 5/1985, datë 23 janar 1985, gjyqtari kushtetues ka kërkuar zbatim të rreptë të këtyre parimeve⁴⁴.

Për ta mbyllur, mund të themi se sigurisht që sistemi i përgjegjësisë së gjyqësorit dhe gjyqtarëve në Spanjë nuk është i përkryer, por ai ka paraspysh gabimet gjithmonë të mundshme të drejtësisë dhe gjyqtarëve dhe vë në punë mekanizmat, të cilat, përfundimisht, janë efikase. Rasti i Spanjës, e cila, që nga heqja e diktaturës ka dëshiruar të ecë përpara me hapa të mëdha drejt demokracisë, mund të ushqejë në disa pika fushën e mendimit, dhe pse jo, edhe të shërbejë si model në shumë pikëpamje.

⁴² *Ibid.*

⁴³ Claudio Movilla Alvarez, Responsabilidad del Estado-Juez, *vep. e cit.*

Sistemi parlamentar në Republikën e Shqipërisë

*Prof. Dr. Avdullah Robaj
Prishtinë, Kosovë*

1. LINDJA E PARLAMENTARIZMIT

Pas disa dhjetëvjeçarësh si bastioni i stalinizmit në Europë dhe i njëjës nga diktaturat më të egra, në Shqipëri u vendos pluralizmi politik. Më 12 dhjetor 1990 u krijua Partia Demokratike, si partia e parë opozitare, ndërsa më 17 dhjetor 1990 Kuvendi Popullor nxori dekretin për krijimin e partive politike. Kështu, pluralizmi u bë realitet edhe në Shqipëri, por këtë herë në kushte shumë më të favorshme nga ato që paraqiteshin kur u rimëkëmb shteti shqiptar i pavarur pas Kongresit të Lushnjës. Në këto rrethana, në Shqipëri u krijuan parti të reja demokratike dhe u bënë zgjedhje të lira, që çuan në rivendosjen e parlamentarizmit.

Zgjedhjet e para pluraliste të 31 marsit 1991 u zhvilluan sipas sistemit mazhoritar. Në këto zgjedhje, ndër më masivet, morën pjesë 98,92 për qind e votuesve. Kjo pjesëmarrje, që ishte më e larta në gjithë zgjedhjet parlamentare në Europën Lindore pasqyronte interesimin e madh të shqiptarëve në jetën politike të vendit.¹

Më 29 prill 1991 u miratua ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i cili me plotësimet e mëvonshme, shërbeu si kushtetutë e përkohshme, deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

¹ Luan Omari “Sistemi parlamentar”, Tiranë, 2000, faqe 211.

të vitit 1998. U miratuan edhe shumë ligje të tjera të rëndësishme dhe të domosdoshme për demokracinë parlamentare.

Nga një vështrim në historinë e shkurtër të parlamentarizmit shqiptar, që nga viti 1991 e këtej, mund të nxirret përfundimi se mungesa e stabilitetit politik ishte shkak i mospërfundimit të plotë të legjislativave, si dhe pati një luhajtje të madhe të zgjedhësve e në mënyrë të theksuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 1991, ku Partia e Punës fitoi 2/3 e vendeve në Kuvend, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 1992, Partia Demokratike fitoi 2/3 e vendeve. Këto rezultate flasin qartë për një shoqëri ende të pastabilizuar, që ende luhatej në kërkim të identitetit të vet politik.

Rruga drejt vendosjes së një demokracie efektive, drejt një shteti të së drejtës nuk është e shkurtër dhe as e lehtë. Për këtë nuk mjafton ekzistenca e një parlamenti, qoftë edhe pluralist, dhe e një kushtetute, qoftë kjo e hartuar sipas standardeve më të përparuara ndërkombëtare. Por këta padyshim janë faktorë shumë të rëndësishëm.²

Demokracia është një kompleks i tërë marrëdhëniesh që përfshin jo vetëm aspektin legjislativ ose normativ, por edhe aspektin praktik, vënien e tyre në jetë. Përcaktimi i tipareve të demokracisë parlamentare bëhet në bazë të disa parimeve universale.

2. PËRVOJAT E PARLAMENTARIZMIT

Menjëherë pas vendosjes së pluralizmit dhe ndryshimeve demokratike të filluara në vitin 1990, edhe në Shqipëri forcat demokratike kërkuan dhe insistuan fuqishëm të hidheshin sa më shpejtë hapat e parë për krijimin e një sistemi përfaqësues parlamentar, si shprehja dhe garancia më e mirë për shkëputjen përfundimtare nga diktatura komuniste dhe vendosjen e demokracisë në Shqipëri.³

² Luan Omari “Sistemi parlamentar”, Tiranë, 2000, faqe 232.

³ Dr. Xhezair Zaganjori “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, faqe 158.

Përprojekjet e para u realizuan me mjaft sukses në kuadër të disa ligjeve kushtetuese bashkëkohore të miratuara nga Kuvendi Popullor, prej të cilave vend të veçantë zënë ligji për dispozitat kryesore kushtetuese, miratuar në prill 1991, ligji për disa ndryshime në dispozitat kryesore kushtetuese, miratuar në prill 1992, ligji për organizimin e drejtësisë dhe krijimin e Gjykatës Kushtetuese, miratuar në prill 1992, ligji për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, i miratuar më 4 shkurt 1992, ligji për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, miratuar në mars 1993 etj.

Kuvendi Popullor, i zgjedhur në mars të vitit 1992, zhvilloi një veprimtari të madhe legjislativë. Kështu, miratoi ligje të reja kushtetuese që i përkisnin organizimit gjyqësor, krijimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, krijimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe organizimit të pushtetit vendor etj. Gjithashtu, Kuvendi i asaj legjislature miratoi shumë akte juridike ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, si Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial dhe Konventa kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese. Mirëpo, Kuvendi Popullor i viteve 1992-1996 nuk arriti të miratojë Kushtetutën e vendit.⁴

Hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë më 28 nëntor 1998 pas miratimit nga Kuvendi dhe referendumi popullor, ka qenë një ngjarje e shënuar në jetën politike të vendit.⁵ Hartimi i Kushtetutës dhe miratimi i saj ishin një domosdoshmëri historike, sepse deri në nëntorin 1998 Shqipëria ishte i vetmi ndër vendet e dala nga regjimi komunist që nuk kishte një kushtetutë të plotë e tërësore.

Shfrytëzimi i përvojës së vendeve të tjera parlamentare vlen edhe për një problem kyç, siç është ai i raportit ndërmjet pushteteve të ndryshme, nga i

⁴ Luan Omari, "Sistemi Parlamentar", Tiranë, 2000, faqe 217.

⁵ Luan Omari, "Shteti i së drejtës", Tiranë, 2002, faqe 99.

cili përcaktohet edhe forma e qeverisjes, në rastin e Shqipërisë lloji i republikës. Të gjitha partitë politike shqiptare, me ndonjë përjashtim të vogël, janë shprehur të paktën formalisht, për një republikë parlamentare. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë zë vend qysh në pjesën e parë të saj, “Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit” (neni 2/1).⁶

Funksionimi i sistemit parlamentar në Republikën e Shqipërisë që nga fillimi i tranzicionit e deri më sot ka manifestuar veçori, të cilat janë pasqyrë e marrëdhënieve shoqërore në këtë vend. Parlamentarizmi, si një sfidë e demokracisë në shoqëri, në funksionimin e tij të deritanishëm ka krijuar raporte politike, të cilat kanë artikulluar kërkesat politike dhe alternativat e profilizuara.

Duke analizuar funksionimin e sistemit parlamentar në Shqipëri, mund të nxjerrim këto karakteristika:

a) E para, Shqipëria që nga fillimi i tranzicionit e deri më sot ka zgjedhur modelin parlamentar të vetëqeverisjes. Kjo do të thotë se Qeveria për të drejtuar ndërtimin politik të vendit, duhej të kishte besimin parlamentar. Kjo formë e qeverisjes parlamentare ka kërkuar një bashkëpunim të ngushtë midis Kuvendit dhe Qeverisë dhe bashkërendim, i cili fillon të ndërtohet që nga momenti kur Qeveria ka marrë votëbesimin nga Kuvendi.⁷

b) Parlamentarizmi në Shqipëri është përcjell me një sistem tipik shumëpartiak, pra me krijimin e një numri të madh të partive politike të orientimeve të ndryshme programore. Përkundër numrit të madh të partive politike në skenën politike shqiptare, janë profilizuar dy parti rivale: Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Rivaliteti politik i këtyre dy partive politike ka ndikuar në rreshtimin e partive të tjera politike kah e majta, përkatësisht kah e djathta. Duke qenë se pluralizmi dhe parlamentarizmi ende nuk ka marrë trajtën e zhvilluar, skena politike plurale e Shqipërisë vazhdon të jetë e

⁶ Prof. Dr. Aurela Anastasi, “E drejta kushtetuese”, Tiranë, 2000, faqe 49.

⁷ Prof. Dr. Aurela Anastasi, “E drejta kushtetuese”, Tiranë, 2000, faqe 73.

pa profilizuar dhe pa kritere të qëndrueshme objektive, të cilat do të profilizojnë partitë politike si të majta, të qendrës dhe të djathta.

c) E veçantë tjetër e parlamentarizmit në Shqipëri është veprimi opozitar. Opozita si një instrument i zhvillimit të demokracisë dhe i kontrollit të pushtetit në Shqipëri, nuk arriti të realizojë misionin e saj. Përkundrazi, ajo veproi në dy drejtime paralele: në drejtimin institucional brenda Kuvendit, duke zgjedhur obstrukcionin dhe bojkotin si metodë të veprimit politik dhe veprimin jashtinstitucional me nxitjen e krizave politike sociale, ekonomike, në funksion të nxitjes së zgjedhjeve të parakohshme.

Raportet pozitive-opozitive në Shqipëri nuk arritën të reflektojnë një kulturë parlamentare, e cila njih rezultatat zgjedhore dhe verdiktin e popullit. Kontestimet e rezultateve zgjedhore ishin praktikë e rëndomtë e zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri dhe e tensioneve politike në vend. Pas çdo cikli të zgjedhjeve, partia politike humbëse akuzonte shumicën parlamentare për shpërdorim dhe manipulim të zgjedhjeve, dhe jo rrallë e zgjidhte bojkotin si formë të veprimit politik. Kjo dukuri u bë tipike për zhvillimin e proceseve politike në Shqipëri, dhe s'ka dyshim, krijoi një imazh negativ të Shqipërisë në bashkësinë ndërkombëtare, që me shumë dyshime vështron aftësitë e shtetit shqiptar për të ndërtuar një shoqëri të qëndrueshme dhe demokratike.

ç) Zhvillimet parlamentare në Shqipëri në periudhën e tranzicionit shquheshin me mungesën e konsensusit politik rreth sistemeve zgjedhore, emërimin e komisioneve zgjedhore, zgjidhjen e kontesteve gjyqësore rreth mandateve të fituara parlamentare dhe fushatave populiste e agresive parazgjedhore.

d) Parlamentarizmi në Shqipëri nuk reflektoi krijimin e një shtypi të lirë dhe të pavarur dhe opinionin publik kritik. Në Shqipëri ende shtypi dhe media elektronik nuk marrin rolin e oponencës neutrale dhe kritike, por më tepër promovon politikën fragmentare të partive politike dhe grupacioneve të tjera politike.

dh) Zhvillimi i demokracisë parlamentare në Shqipëri nuk rezultoi në

ndërtimin e shtetit të së drejtës si vlerë bazike e shoqërisë demokratike. Duke trashëguar konceptin e shtetit partiak dhe ideologjinë komuniste, Shqipëria nuk arriti të ndërtojë sistemin koherent juridik dhe të ndërtojë institucione të frytshme për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

3. ORGANET E PUSHTETIT SHTETËROR DHE KOMPETENCAT E TYRE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë që në nenin 1 shprehimisht thekson: “1.Shqipëria është republikë parlamentare. 2.Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm. 3.Qeverisjs bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike”.⁸ Ndërsa në nenin 7 të Kushtetutës decidivisht thuhet: “sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”.⁹

Karakterit parlamentar i përcaktuar me Kushtetutë shprehet edhe me faktin se Qeveria dhe Kuvendi janë të lidhur nga një raport besimi, ndërsa Presidenti i Republikës është një organ kushtetues i veçantë nga Qeveria.

3.1. Kuvendi

Demokracia, si formë e veçantë e qeverisjes kërkon realizimin sa më të plotë të parimit të rëndësishëm kushtetues: “I gjithë pushteti shtetëror buron nga populli”. Por vullneti politik i popullit, dëshirat dhe kërkesat e tij mund të bëhen të realizueshme në praktikë vetëm përmes përfaqësimit në parlament.

Marrë në tërësi, mund të vërehet se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton mjaft mirë vendin dhe rolin e Kuvendit në kuadër të sistemit parlamentar të qeverisjes. Neni 2 i Kushtetutës përcakton se “sovrانيتeti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt”.¹⁰

⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 1.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 7.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 2.

Sipas Kushtetutës, Kuvendi ka të drejtën ekskluzive për miratimin e ligjeve (neni 81-85). Funkzioni ligjvënës nënkupton edhe të drejtën e çdo deputeti për të propozuar ligje.¹¹ Miratimi i ligjeve në Kuvend bëhet me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për ligjet që parashihen në mënyrë taksative në nenin 81 pika 2 të Kushtetutës, dhe me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.¹² Projektligji votohet tri herë: në parim, nën për nën dhe në tërësi.¹³ Shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi, e bën Presidenti i Republikës brenda njëzet ditëve nga paraqitja e tij. Ligji hynë në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditë, nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

Funksioni zgjedhor i Kuvendit parasheh zgjedhjen e Presidentit të Republikës (neni 87), të Këshillit të Ministrave (Qeverisë) (neni 96), Kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (neni 125), anëtarët e Gjykatës së Lartë (neni 136), Prokurorin e Përgjithshëm (neni 149) dhe Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit (neni 162). Funkzioni mbikëqyrës i Kuvendit ushtrohet vetëm ndaj Qeverisë (neni 80).

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka strukturë njëdhomëshe dhe përbëhet nga 140 deputetë (neni 64). 100 deputetë zgjidhen drejtpërdrejt me sistem maxhoritar, ndërsa 40 deputetë zgjidhen me sistem proporcional. Partitë që fitojnë në raundin e parë të zgjedhjeve më shumë se 2,5 për qind dhe koalicionet e partive që marrin më shumë se 4 për qind të votave të vlefshme në të gjithë vendin fitojnë të drejtën e hyrjes në Kuvend (neni 65).

Kuvendi zgjidhet për katër vjet (neni 65). Mandati i Kuvendit zgjatet vetëm në rast lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo. Kuvendi i porsazgjedhur thirret në mbledhjen e parë nga Presidenti i Republikës jo më vonë se 20 ditë nga përfundimi i zgjedhjeve (neni 67). Kuvendi zhvillon punimet vjetore në

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 81.

¹² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 78.

¹³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 83.

dy sesione. Sesiioni i parë fillon të hënën e tretë të janarit dhe sesiioni i dytë të hënën e parë të shtatorit (neni 74).

Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së Kuvendit të miratuar nga shumica e të gjithë deputetëve. Rregullorja mund të konsiderohet si një kompleks dispozitash të votuara nga vetë Kuvendi gjatë ushtrimit të pushtetit të tij të vetërregullimit.

Duke pasur parasysh kompetencat kushtetuese të Kuvendit me të drejtë mund të vërejmë se Kushtetuta fikson sistemin parlamentar të qeverisjes. Në të përcaktohet mjaft mirë dhe qartë vendi dhe roli përparësor i Kuvendit. Kjo do të thotë se Qeveria, për të filluar veprimtarinë e saj në drejtimin politik të vendit, ka nevojë të gëzojë besimin e Kuvendit, ose me fjalë të tjera, midis Qeverisë dhe Kuvendit duhet të vendoset raporti i besimit. Kështu Kuvendi nuk ka një funksion të thjeshtë për të nxjerrë ligje, por gëzon edhe funksionin për të bashkëpunuar me Qeverinë, në zhvillimin e të gjithë veprimtarisë së drejtimit politik të vendit.

Veprimtaria e drejtimit politik mund të konsiderohet e ndarë në tri faza kryesore: faza e parë i përket përcaktimit të veprimtarisë shtetërore. Në fazën e dytë, organet e drejtimit politik disponojnë një aparat administrativ dhe mjetet e nevojshme për të ndjekur qëllimet e caktuara prej tyre. Faza e tretë zhvillohet me një seri aktesh, në të cilat qëllimet e programuara gjejnë zbatim.

Mbi bazën e përgjegjësisë parlamentare, Kushtetuta parashikon shprehimisht se mund të kërkohet dhe të miratohet mocion mosbesimi për Kryeministrin dhe zgjedhjen e një Kryeministri tjetër. Heqja e votëbesimit dhe zgjedhja e një Kryeministri të ri varet nga gjykimi politik i Kuvendit.

3.2. *Presidenti i Republikës*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 përcakton Presidentin e Republikës si përfaqësues i unitetit të popullit dhe simbol i unitetit kombëtar.¹⁴

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 86, paragrafi 1.

Si simbol unitetit të popullit, Kushtetuta i jep karakter asnjënjës Presidentit, duke mohuar mundësinë e të qenit të njëkohshëm lider i partisë politike. Ky pozicion i Presidentit pajtohet më mirë me natyrën e republikës parlamentare dhe garanton zgjidhje më të kënaqshme të ndarjes midis pushteteve. Kushtetuta e vesh Presidentin me kompetenca mjaft autoritative si: e drejta ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm njëherë (neni 85), e drejta e shpërndarjes së Kuvendit kur nuk arrin ta zgjedhë kryeministrin (neni 86), e drejta e arbitrimit në konfliktet që lindin midis Kuvendit dhe Qeverisë etj. Një rol të veçantë, sipas Kushtetutës, Presidenti ka edhe në mbikëqyrjen e zbatimit të Kushtetutës.

Kushtetuta përcakton për Presidentin edhe këto kompetenca: Emëron Kryeministrin dhe ministrat, i drejton mesazhe Kuvendit, ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit, jep shtetësinë shqiptare, jep dekorata e tituj nderi, jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit, emëron me propozimin e Kryeministrit përfaqësuesit diplomatikë të Republikës së Shqipërisë në shtetet tjera dhe në organizatat ndërkombëtare, me propozimin e Kryeministrit, emëron drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, cakton datën e zgjedhjeve parlamentare dhe vendore etj. (neni 92).

Presidenti i Republikës së Shqipërisë mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.¹⁵ Presidenti i Republikës zgjidhet me votim të fshehtë dhe pa debat nga Kuvendi me një shumicë prej 3/5 të të gjithë deputetëve.¹⁶ E nëse edhe pas votimit të pestë nuk arrihet kjo shumicë, Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e parakohshme, të cilat bëhen brenda 60 ditëve.¹⁷ Presidenti i Republikës zgjidhet për pesë vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.¹⁸ Presidenti i Republikës mund të

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 86.

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 87.

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 87.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 88.

shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë.¹⁹ Vendimin për fajësinë e Presidentit të Republikës e deklaroi Gjykata Kushtetuese.

3.3. Këshilli i Ministrave

Qeveria e Republikës së Shqipërisë emërtohet si Këshilli i Ministrave dhe përbëhet nga kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat.²⁰ Fuqia kushtetuese e Qeverisë Shqiptare, shprehet në nenin 95 pika 2, ku thuhet shprehimisht se “Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore”.

Krijimi i Qeverisë Shqiptare, si në çdo qeverisje parlamentare kalon nëpër disa faza. Fillimisht Presidenti i Republikës, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve parlamentare dhe duke u thirrur në dispozitën e nenit 96 të Kushtetutës, pas këshillimore me partinë ose koalicionin e partive që kanë fituar shumicën në Kuvend, propozon kandidatin e mundshëm për kryeministër. Më pastaj, propozimi i Presidentit shkon në Kuvend, ku Kuvendi duhet ta votojë propozimin e Presidentit. Në qoftë se Kryeministri i emëruar nga Presidenti nuk miratohet nga Kuvendi, Presidenti emëron një Kryeministër të ri brenda 10 ditëve. Nëse pas tri raundeve, përkatësisht tri propozimeve të Presidentit, Kryeministri nuk votohet nga Kuvendi, atëherë President i Republikës shpërndan Kuvendin (neni 96).

Kryeministri i miratuar nga Kuvendi, së bashku me zëvendëskryeministrin dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës (neni 99). Kryeministri i emëruar nga Kuvendi, brenda 10 ditëve paraqet për miratim para Kuvendit programin politik nga i cili do të udhëhiqet Qeveria në veprimtarinë e saj gjatë gjithë mandatit deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 90.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 95.

Programi politik i Kryeministrit është i detyrueshëm për të gjithë ministrat e kabinetit qeveritar, por jo edhe për organet e tjera kushtetuese dhe për qytetarët e thjeshtë. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesorë të politikës së përgjithshme shtetërore (neni 100). Aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe ministri propozues (neni 100). Pra, në përgjithësi Këshilli i Ministrave me Kushtetutë ngarkohet të zbatojë dhe realizojë politikën e përditshme shtetërore. Ajo përqendrohet kryesisht në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve ekonomike e shoqërore, të problemeve të rendit dhe sigurisë, të problemeve të mbrojtjes, marrëdhënieve me jashtë etj. Kryeministri e përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij, koncepton dhe paraqet drejtimit kryesorë të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to, siguron zbatimin e legjisllacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave (neni 102).

Praktika e funksionimit dhe organizimit të Qeverisë Shqiptare mundëson nxjerrjen e këtyre përfundimeve: e para, mungesën e kohabitacionit midis pozitës dhe opozitës në ekzekutivin e shtetit. E dyta, formimin e qeverisë nga mazhoranca parlamentare dhe aleatët e saj. E treta, mungesën e një stabiliteti qeveritar dhe prirjen e vazhdueshme për marrjen e votëbesimit të Qeverisë para skadimit të afatit.

4. PUSHTETI VENDOR

Organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor në Republikën e Shqipërisë është normuar me ligjin kushtetues nr. 7570, datë 3.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor”.²¹

Ligji në fjalë e ka ndarë pushtetin vendor në tre nivele: në komuna, bashki e rrethe.²² Ndërsa Ligji për Prefekturat ka krijuar edhe një ndarje tjetër të territorit të vendit, që është ajo në qarqe.²³ Por një ndarje e tillë nuk ka

²¹ Ligji për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, 1992.

²² Po aty, neni 2.

²³ Ligji për Prefekturat, nr.7608, datë 22.09.1992.

ndonjë rëndësi për nga pikëpamja e formimit dhe funksionimit të organeve vendore të pushtetit. Prefekturat janë organe të pushtetit vendor që përfaqësojnë pushtetin qendror. Apo thënë ndryshe, prefekturat janë pushtet qendror i shtrirë në rrafshin horizontal dhe se janë organe të pushtetit që përfaqësojnë drejtpërdrejt Qeverinë dhe institucionet tjera qendrore në njësitë administrativo-tokësore përkatëse. Edhe Kushtetuta në nenin 108 ndarjen e pushtetit vendor e bën në 3 nivele: komuna, bashki dhe qarqe.

Të njëjtën ndarje duke u bazuar në dispozitat kushtetuese e bën edhe ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Edhe pse komunat dhe bashkitë konsiderohen njësi më të vogla në organizimin e pushtetit vendor, kjo nuk do të thotë se ato vihen në pozita inferiore dhe varësie ndaj rretheve.²⁴ Para se gjithash komuna, bashkitë dhe rrethet janë njësi territoriale publike. Komunat, bashkitë dhe rrethet janë, gjithashtu, njësi autonome, pasi që edhe sipas nenit 3 të ligjit nr.7570, datë 3.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor” thuhet se organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor bëhet mbi bazën e parimeve të vetëqeverisjes, të pavarësisë, të autonomisë vendore dhe të decentralizimit. Kjo do të thotë, se ato kanë një hapësirë lirie në lidhje me pushtetin qendror.

Autonomia e pushtetit vendor buron nga fakti se organet e pushtetit vendor janë njësi përfaqësuese të popullit të zgjedhur në mënyrë demokratike me votën e tyre drejtpërdrejt nga qytetarët që banojnë dhe jetojnë në territoret e tyre përkatëse.

Në mbështetje të ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, zgjedhjet për njësitë vendore kryhen në çdo katër vjet, pra për këshillat e komunave, bashkive dhe rretheve. Ndërsa sipas nenit 109 pika 1 të Kushtetutës, “Organet përfaqësuese të njëjësive bazë të qeverisjes vendore janë këshilla, të cilat zgjidhen çdo tre vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë”.

²⁴ Ligji për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, neni 4.

Autonomia e njësisve territoriale publike shprehet në planin politik, në planin normativ dhe atë administrativ. Ndërsa organizimi i njësisve vendore përngjan shumë me organizimin e pushtetit qendror. Edhe komuna, edhe bashkia, edhe rrethi formohen nga aparatet politike si dhe nga aparatet administrativo-burokratike. Komunitat dhe bashkitë janë pushtete publike që ndjehen më shumë nga shtetasit, pasi ato janë dhe qëndrojnë më afër jetës së tyre të përditshme. Dhe derisa komunitat përfshijnë kryesisht fshatrat, bashkitë shtrihen nëpër qytete. Megjithatë edhe ligji nuk bën diferencime në detyrat e komunave dhe ato të bashkive, është e qartë se volumi dhe shumëllojshmëria e detyrave që kryhen nëpër bashkitë janë shumë më të mëdha.

Kushtetuta në pjesën e gjashtë, në mënyrë eksplicite dhe decitive rregullon organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Sipas nenit 108 të Kushtetutës, njësitë e qeverisjes vendore janë komunitat ose bashkitë dhe qarqet. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ndërsa qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e shoqërore dhe të interesave të përbashkët.²⁵ Qarku është njësi ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore. Ndërsa këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarkut rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre.²⁶

5. PUSHTETI GJYQËSOR

Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.²⁷

Zbatimi konsekuent i parimit të ndarjes së pushteteve do të kërkonte që secili pushtet të kishte monopole të funksionit përkatës dhe që të tri pushtetet

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 110.

²⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 113.

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 7.

të vendoseshin në një rrafsh barazie të plotë. Megjithatë, pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv jo gjithnjë i janë përmbajtur rreptë parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe sidomos me raport me pushtetin gjyqësor.

Pushteti gjyqësor në Shqipëri u konceptua si kategori kushtetuese, qysh me miratimin e ligjit kushtetues “Për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese” më 29.4.1992.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pjesën e tetë, të nëntë dhe të dhjetë bën fjalë për pushtetin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Sipas neni 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Tani në vend të Gjykatës së Kasacionit është krijuar Gjykata e Lartë, e cila, ndryshe nga e para, ka jo vetëm funksionin rishikues, por edhe fillestar. Ndërsa niveli i shkallshmërisë është ruajtur, përkatësisht edhe sipas Kushtetutës, gjyqësia është e organizuar në tri nivele: Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë.²⁸ Anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.²⁹ Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi. Ndërsa gjyqtarët e tjerë emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pra, sipas Kushtetutës emërimi i gjyqtarëve është paraparë në mënyrë taksative dhe atë në dy forma. Forma e parë, parashih emërimin nga Presidenti i Republikës, por të kushtëzuar nga pëlqimi i Kuvendit, ndërsa forma e dytë, parashih, gjithashtu, emërimin e gjyqtarëve nga Presidenti i Republikës, por të kushtëzuar nga Këshillit i Lartë i Drejtësisë.

Përsa i përket organizimit financiar, sipas Kushtetutës, gjykatat kanë buxhet të veçantë, të cilin e administrojnë vetë.³⁰ Gjykatat i japin vendimet

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 135.

²⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 136.

³⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 144.

në emër të Republikës. Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Pozita e Prokurorisë është normuar në pjesën e dhjetë të Kushtetutës. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit.³¹ Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Prokurori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kuvendit, për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit.³²

Në Republikën e Shqipërisë organizimi i drejtësisë mbështetet në përgjithësi në katër parime: 1. decentralizimi, 2. përshtatja ndaj konflikteve që gjykohen, 3. hierarkia dhe, 4. kolegjaliteti.

6. GJYKATA KUSHTETUESE

Pas rënies së komunizmit dhe ndryshimeve të bëra në Shqipëri, akti më i madh sinjifikativ politik dhe juridik pasqyrohet me nxjerrjen e ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”. Pas miratimit të këtij ligji përmbytësor, i cili ndryshoi kahet e zhvillimit të Shqipërisë, duke i avancuar ato në drejtime pozitive, u paraqit nevoja e kontrollit dhe mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, përkatësisht e formimit të një organi kompetent, përkatësisht Gjykatës Kushtetuese.

³¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 148.

³² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 149.

Ligji kushtetues nr. 7561, datë 29.4.1992 “Për Organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese”, që u bë pjesë e dispozitave kryesore kushtetuese të miratuara me 29.4.1991, është akti që shënon krijimin e Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri. Ky ligj përmban 11 nene për Gjykatën Kushtetuese, ku përcaktohet funksioni dhe pavarësia e Gjykatës Kushtetuese, përbërja, mandati dhe koha e qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, si dhe mënyrat e marrjes së vendimeve dhe karakter përfundimtar i formës së prerë. Megjithatë, Kushtetuta e vitit 1998 dhe ligji organik “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i 10 shkurtit 2000 bëjnë avancime të theksuara cilësore e pozitive, përsa i përket fushëveprimtarisë, organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese.

Ndryshimet dhe avancimet që i ka sjell Kushtetuta në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, kanë të bëjnë lidhur me mënyrën e zgjedhjes (emërimet) e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kriterëve për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve. Kushtetuta ka zgjedhur edhe rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj (neni 124). Ndërsa kompetencat tjera të saj janë përcaktuar në mënyrë shteruese në Kushtetutë, në nenin 131.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare (të formës së prerë). Vendimi i Gjykatës Kushtetuese u njoftohet organeve përkatëse që ato të marrin masat e parashikuara në këtë vendim. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj ose një akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me një marrëveshje ndërkombëtare, ka efekt që nga hyrja e tij në fuqi, pra nuk ka fuqi prapavepruese.

Ligji organik “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i 10 shkurtit 2000, shtjellon dhe plotëson normat përkatëse të Kushtetutës. Ky ligj, në krahasim me ligjin kushtetues nr. 7561, datë 29.4.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese”, ka dallime si në aspektin

e strukturës së ligjit të ri dhe si në aspektin e përmbajtjes. Në aspektin strukturor, ligji i ri është ndarë në 9 krerë. Janë nxjerrë më vete kreu mbi statusin e gjyqtarit kushtetues, kreu mbi parimet e gjykimit kushtetues dhe kreu mbi procedurat e veçanta. Ligji i ri, gjithashtu, ka një ndërtim më shkencor dhe sipas një rendi kronologjik. Përsa i përket aspektit përmbajtësor, ndryshimet në ligjin e ri për Gjykatën Kushtetuese janë qartësisht të dallueshme. Ligji i ri sanksionon në mënyrë decisive elementet e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese. Në ligjin e ri theksohet se Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative e financiare.³³ Gjithnjë në të njëjtin ligj thuhet se Gjykata Kushtetuese administron buxhetin, i cili hartohet prej saj dhe miratohet nga Kuvendi.³⁴

Nga observimi i punës 15-vjeçare të kësaj Gjykate shihet përpjekja e saj për të evituar dukuritë e kundërkushtetutshmërisë dhe të kundërligjshmërisë, në zgjidhjen e kontesteve kundërkushtetuese e në mënyrë të veçantë të kontesteve zgjedhore, të shfaqura para zgjedhjeve parlamentare. Me gjithë pavarësinë e garantuar me Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese nuk ka mundur t'u rezistojë gjithmonë presioneve politike, çka ka ndikuar në paraqitjen e akuzave për politizimin e saj në procesin e vendimmarrjes.

Me të drejtë vlerësohet se Gjykata Kushtetuese është garantuesja dhe mbrojtësjja më e mirë e lirisë dhe e Kushtetutës. Vendimet e saj janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha pushtetet, përfshirë edhe pushtetin legjislativ.

7. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË E VITIT 1998

Në historinë e shteteve miratimi i Kushtetutës evidentohet si ngjarje e rëndësishë së veçantë. Sigurisht edhe miratimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë më 28 nëntor 1998, paraqet ngjarje me rëndësi historike për

³³ Ligji organik “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, 10 shkurt 2000, neni 3.

³⁴ Ligji organik “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, 10 shkurt 2000, neni 6.

Shqipërinë dhe shtetin shqiptar. Miratimi i Kushtetutës së re shqiptare shënoi përfundimin e krizës kushtetuese të shfaqur në Shqipëri pas rënies së sistemit komunist.

Në pikëpamje të formës së qeverisjes, Kushtetuta e vitit 1998 Shqipërinë e përcakton si “republikë parlamentare”.³⁵ Sovraniteti në Shqipëri buron dhe i përket popullit, i cili ushtrohet drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve.³⁶

Nga aspekti përmbajtësor, Kushtetuta përcakton dhe juridikisht rregullon marrëdhëniet themelore shoqëro-politike të vendit. Në aspektin juridik Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ishte akt i sanksionimit të shtetit shqiptar në një fazë kritike të zhvillimit të tij. Si një akt më i lartë juridik dhe demokratik i shtetit shqiptar dhe e vlerësuar nga mekanizma ndërkombëtarë, si “në pajtim të plotë me standardet dhe vlerat europiane”, ajo paraqet një dëshmi bindëse se shteti shqiptar është përcaktuar dhe zotuar drejt ndërtimit të një demokracie të qëndrueshme parlamentare me vlera europiane dhe drejt ndërtimit të shtetit të së drejtës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon një balancë elastik midis tri pushteteve, duke siguruar njëkohësisht një varshmëri të tyre të ndërsjellë. Kështu ajo siguron edhe mekanizma institucionalë me të cilët një pushtet mbrohet nga mbizotërimi i pushtetit tjetër. Ndërkaq funksioni i mbrojtjes dhe i kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë i besohet Gjykatës Kushtetuese, si organ i pavarur shtetëror.

Ky karakter parlamentar i Republikës së Shqipërisë është parashikuar shprehimisht në nenin 1 paragrafi 1 të Kushtetutës. Ndërsa neni 7 i Kushtetutës forcon edhe më tej balancimin dhe raportet ndërmjet tri pushteteve, duke garantuar se “sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”. Nga ky raport kushtetues del pa mëdyshje karakteri parlamentar

³⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 1.

³⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 2, al. 1 e 2.

i Republikës së Shqipërisë dhe karakteri i ndërtimit të vlerave demokratike europiane.

Sipas Kushtetutës, Qeveria dhe Kuvendi janë të lidhura nga një raport besimi, ndërsa Presidenti i Republikës është një organ kushtetues i veçantë nga Qeveria. Sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit.³⁷

Në Kushtetutë është evidentuar roli i Kuvendit si organ ligjvënës dhe e drejta e tij për ta kontrolluar Qeverinë. Megjithatë, e drejta e kontrollit të Kuvendit ndaj Qeverisë nuk do të thotë interferencë vend e pa vend të Kuvendit. Sipas Kushtetutës, në të vërtetë pasqyrohet forcimi i rolit të Qeverisë edhe me njohjen e të drejtës që ajo të nxjerrë akte normative me fuqi ligjore, në rast nevoje dhe urgjence.³⁸ Gjithashtu, sipas Kushtetutës, pozita dhe roli i Kryeministrit është i veçantë, pasi ai, përveç se përfaqëson Qeverinë, edhe koncepton dhe paraqet drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to si dhe bashkërendon e kontrollon punën e ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit.

Vendosja e balancit midis tri pushteteve në sistemin kushtetues të Shqipërisë ka për qëllim dhe duhet të sigurojë një stabilitet politik dhe një bashkëpunim të ndërsjellë midis organeve shtetërore. Për sa i përket pushtetit gjyqësor, Kushtetuta e Shqipërisë garanton pavarësinë e tij prej organeve ekzekutive dhe legjislativë. Kjo edhe më tepër ia shton rëndësinë, kur dihet fakti se në Shqipëri gjithmonë ka pasur probleme dhe fërkime në sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit.

Për sa i përket përbërjes dhe strukturës së Kushtetutës, ajo paraqet një akt modern dhe standard nga pikëpamja e vëllimit të saj. Ajo ka gjithsej 183 nene, të ndarë në dy pjesë kryesore: preambulën dhe pjesën normative. Preambula ka karakter deklarativ, por njëkohësisht, ajo afirmon disa nga

³⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 86.

³⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 101.

parimet, vlerat e qëllimet më themelore të shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, të cilat shërbejnë për interpretimin e gjithë pjesës normative të Kushtetutës.³⁹

Pjesa normative e Kushtetutës është e ndarë në 18 pjesë, në të cilat përpunohen institucionet kushtetuese në të cilat bazohet sistemi kushtetues i Shqipërisë. Pjesa e parë, “parimet themelore”, përcakton parimet themelore kushtetuese me të cilat përkufizohet shteti shqiptar, përcaktohet forma e qeverisjes dhe atributet e tjera shtetërore të Republikës.⁴⁰ Në pjesën e dytë⁴¹ të Kushtetutës, vëmendje e posaçme iu kushtohet të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kushtetuta 6 krerë ia kushton këtyre të drejtave, ku në mënyrë koncize dhe eksplicite janë normuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.⁴² Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.⁴³ Pjesa e tretë përmban dispozitat për Kuvendin, mënyrën e zgjedhjes dhe të mandatit të tij⁴⁴, dispozitat për të drejtat dhe detyrat e deputetëve,⁴⁵ organizimin dhe funksionet e Kuvendit,⁴⁶ dispozitat për procesin ligjvënës.⁴⁷

Në pjesën e katërt përcaktohet instituti i Presidentit të Republikës, mënyra e zgjedhjes dhe funksionet e tij kushtetuese.⁴⁸ President mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e

³⁹ Prof. Dr. Aurela Anastasi “E drejta kushtetuese”, Tiranë, 2000, faqe 15.

⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 1-14.

⁴¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 15-63.

⁴² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 15, paragrafi 1.

⁴³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 15, paragrafi 2.

⁴⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 64-67.

⁴⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 68-73.

⁴⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 74-80.

⁴⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 81-85.

⁴⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 86-94.

fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.⁴⁹ Pjesa e pestë i referohet Këshillit të Ministrave.⁵⁰ Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore.⁵¹ Në këtë pjesë pasqyrohen në formë taksative të gjitha autorizimet dhe kompetencat e Qeverisë Shqiptare, mënyra e zgjedhjes, kontrolli parlamentar e deri te shkarkimi i Qeverisë. Në pjesën e gjashtë përcaktohen parimet kushtetuese të qeverisjes vendore në Shqipëri.⁵² Pjesa e shtatë, “Aktet normative dhe marrëveshjet ndërkombëtare”, në thelb, përcakton burimet formale të së drejtës kushtetuese në Shqipëri.⁵³ Pjesa e tetë përmban dispozitat për Gjykatën Kushtetuese, kompetencat edhe autorizimet e saj.⁵⁴ Pjesa e nëntë dhe pjesa e dhjetë u kushtohen pushtetit gjyqësor, përkatësisht gjykatave⁵⁵ dhe prokurorive.⁵⁶ Në pjesën e njëmbëdhjetë parashihen dispozitat për referendumin, mënyrën e shpalljes dhe të realizimit të tij.⁵⁷ Pjesa e dymbëdhjetë i kushtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,⁵⁸ kurse pjesa e trembëdhjetë përcakton financat publike në Shqipëri.⁵⁹ Pjesa e katërbëdhjetë përmban dispozitat për “Kontrollin e Lartë të Shtetit”.⁶⁰ Në pjesën e pesëmbëdhjetë përcaktohet vendi dhe roli i forcave të armatosura,⁶¹ kurse në pjesën e gjashtëmbëdhjetë parashihen dispozitat

⁴⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 86, paragrafi 2.

⁵⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 95-107.

⁵¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 95, paragrafi 2.

⁵² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 108-115.

⁵³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116-120.

⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 124-134.

⁵⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 135-147.

⁵⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 148-149.

⁵⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 150-152.

⁵⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 153-154.

⁵⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 155-161.

⁶⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 162-165.

⁶¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 166-169.

për gjendjen e jashtëzakonshme dhe zgjatjen e kësaj gjendje.⁶² Në pjesën e shtatëmbëdhjetë Kushtetuta parasheh rishikimin e Kushtetutës, nismën për rishikim, mënyrën dhe organet kompetente të rishikimit.⁶³ Pjesa e tetëmbëdhjetë përmban dispozitat kalimtare dhe të fundit.⁶⁴

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Republika e Shqipërisë që nga fillimi i tranzicionit e deri më sot ka zgjedhur modelin parlamentar të qeverisjes. Kjo formë e qeverisjes parlamentare ka kërkuar një bashkëpunim të ngushtë midis Kuvendit dhe Qeverisë. Parlamentarizmi në Shqipëri është përcjell me një sistem tipik dypartiak, të dy partive rivale: Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike.

Veçori e parlamentarizmit në Shqipëri paraqitet edhe veprimi opozitar. Opozita, si instrument i zhvillimit të demokracisë, nuk arriti të ishte në funksion të saj. Zhvillimet parlamentare në Shqipëri janë shquar me mungesën e konsensusit politik rreth sistemeve zgjedhore.

Forcimi i demokracisë së brishtë shqiptare varet në një shkallë të madhe nga vendosja e shtetit të së drejtës, i cili duhet të bëhet tipar i përhershëm i panoramës politike të vendit. Gjithashtu, Shqipëria duhet të zhvillojë kulturën e të drejtave dhe të detyrave, në të cilën ligji dhe rendi janë realitete të jetës së përditshme dhe jo çështje të lëna në duart e policëve dhe gjyqtarëve. Në të vërtetë, Shqipëria ka shumë ligje të mira me standarde europiane, por e keqja është se ato nuk zbatohen plotësisht.

Demokracia parlamentare është e lidhur ngushtë me vendosjen e institucioneve demokratike, ndarjen e qartë të pushteteve, duke respektuar pavarësinë dhe kompetencat e secilit pushtet, funksionimin e sistemit shumëpartiak dhe me zgjedhje të mirëfillta.

⁶² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 170-176.

⁶³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 177.

⁶⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 178-183.

BIBLIOGRAFIA

- [1]. Anastasi Aurela, “Vështrimi historik mbi të drejtën kushtetuese shqiptare në vitet 1925-1939”, “Drejtësia” nr.5/1995, Tiranë, 1995.
- [2]. Anastasi Aurela, “Historia e institucioneve”, Tiranë, 2002.
- [3]. Anastasi Aurela, “Institucionët politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri”, Tiranë, 1998.
- [4]. Anastasi Aurela, “E drejta kushtetuese”, Tiranë, 2000.
- [5]. Bajrami Arsim, “Demokracia parlamentare”, Prishtinë, 2005.
- [6]. Filo Llambro, “Historia për shtetin e mirëqenies sociale”, Tiranë, 1999.
- [7]. Jaho Njazi, “Probleme të Kushtetutës”, Tiranë, 1998.
- [8]. Klod Lëfor, “Demokracia dhe totalitarizmi”, Tiranë, 1993.
- [9]. Loloçi Krenar, “E drejta kushtetuese”, Tiranë, 1997.
- [10]. Loloçi Krenar, “Kushtetuta e re dhe nevoja për një mentalitet të ri”, Tiranë, 2002.
- [11]. Luarasi Aleks, “Akte juridike për historinë e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri”, Tiranë, 1999.
- [12]. Omari Luan, “Sistemi parlamentar”, Tiranë, 2000.
- [13]. Omari Luan, “Parime dhe institucione të së drejtës publike”, Tiranë, 1999 dhe 2006 (botimi i tetë).
- [14]. Omari Luan, “Shteti i së drejtës”, Tiranë, 2002.
- [15]. Sadushi Sokol, “Kontrolli paraprak i kushtetutshmërisë së normës juridike”, “Klinika e ligjit”, nr.1/2001, Tiranë, 2001.
- [16]. Saliu Kurtesh “E drejta kushtetuese I”, Prishtinë, 2004.
- [17]. Zaganjori Xhezair, “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, Tiranë, 2002.
- [18]. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998.
- [19]. Ligji për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, miratuar në mars 1993.
- [20]. Ligji për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, i miratuar më 4 shkurt 1992.
- [21]. Ligji për organizimin e drejtësisë dhe krijimin e Gjykatës Kushtetuese, miratuar në prill 1992.
- [22]. Ligji për disa ndryshime në dispozitat kryesore kushtetuese, miratuar në prill 1992.
- [23]. Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese, miratuar në prill 1991.
- [24]. Ligji për Prefekturat, nr.7608, datë 22.09.1992.
- [25]. Ligji për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal.
- [26]. Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.
- [27]. Ligji organik “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, 10 shkurt 2000.

Veprimtaria e Kuvendit në lidhje me integrimin për periudhën shkurt - mars 2007

Përgatiti: Denis Gila

Kuvendi i Shqipërisë, për muajin shkurt, ka miratuar disa projektligje, ndër të cilët ishte edhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”. (K.P.)

Ndryshimet në kodin penal janë iniciativë e Këshillit të Ministrave në bazë të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës.

Projektligji është shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i ligjeve, administratës publike dhe të drejtave të njeriut, ku i janë bërë edhe ndryshimet e nevojshme dhe përfundimtare projektligjit në fjalë.

Duke marrë në konsideratë fenomenet ndërkombëtare dhe rritjen e aktiviteteve të brendshme dhe të jashtme të një shteti, aktivitetet ekonomike, juridike, sociale në të gjitha fushat, duke rritur edhe intensitetin e komunikimit dhe shpejtësinë e tij ndërmjet shteteve, duke parë edhe fenomene të ndryshme kryesisht në fushën e kriminalitetit ndërkombëtar, është tashmë konsideruar edhe fenomeni i terrorizmit ndërkombëtar, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i substancave të ndryshme *inter alia* në rrugë të jashtëligjshme, fenomene këto që janë paraqitur masivisht edhe në Shqipëri, nga nevojat e reja që kanë lindur për të rregulluar këto fenomene, fryte të globalizimit, është parë e nevojshme që kodi penal i Republikës së Shqipërisë, me gjithë amendimet e bëra, ka shfaqur disa mangësi të cilat janë pasqyruar në ligjin e miratuar në Kuvend gjatë muajit shkurt. Këto ndryshime vijnë jo vetëm si

pasojë e fenomeneve, por edhe për faktin se Shqipëria ka ratifikuar disa marrëveshje ndërkombëtare të cilat, sipas nenit 121 të Kushtetutës përbëjnë burim të së drejtës së brendshme për shtetin shqiptar.

Ligji i kaluar tashmë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që pritet të hyjë në fuqi sipas dispozitave të tij, pasuron kodin penal në respektim të angazhimeve të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Ky ligj kryesisht konsideruar sa më sipër dhe disa fenomene të brendshme, mund të përmblihet në 4 drejtime: veprimet me qëllime terroriste, *tortura, informacioni i rezervuar dhe gjakmarrja*.

Bashkimi Europian në shtyllën e tretë të tij, në bashkëpunimin gjyqësor dhe në çështjet e brendshme ka konsideruar të një rëndësie të veçantë luftën kundër terrorizmit, në të gjitha format e tij. Për këtë, Këshilli ka miratuar vendimin kuadër për luftën kundër terrorizmit nr.2002/475/GAI, datë 13 qershor 2002.

Në arenën juridike ndërkombëtare është e vështirë të gjesh një përkufizim të **terrorizmit**, megjithatë, vendimi kuadër parashikon disa raste që konsiderohen të tilla. Projektligji në fjalë është bazuar tek ky vendim dhe duke konsideruar këtë nuk kufizohen rastet e veprimeve me qëllime terroriste.

Për Qeverinë shqiptare, në kuadrin e integritimit europian, amendimi i Kodit Penal bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (neni 5, 8 pika 3, 82, 84 dhe neni 85) është i domosdoshëm për të përafëruar legjisllacionin shqiptar me *acquis communautaire*. Duke konsideruar prioritetet e procesit të integritimit në aspektin e parë të dhënies së përkufizimeve, në ligjin e mëparshëm konsideroheshin vetëm aktet terroriste, aspektin fenomenal të tyre. Në fjalë të tjera, ndëshkoheshin vetëm aktet terroriste. (neni 7 pika c KP). Dallimi midis akteve terroriste dhe veprimeve me qëllime terroriste (në ligjin e ndryshuar) qëndron në shtrirjen e fushës së veprimeve. Veprime (ose vepra) terroriste mund të konsiderohen të gjithë ato veprime të renditura në nenin 15 të ligjit të ndryshuar i cili ndryshon nenin 230 të kodit penal, ku mund të përmenden përgatitja psikologjike, stërvitja fizike (*me qëllim*) për

akte terroriste të mundshme, njohja e teknikave të terrorit, të armëve të ndryshme, të gjitha këto çështje të trajtuara paraqiten në ndryshimet e fundit të kodit penal. Me gjithë parashikimet e mundshme në pikën 2 të nenit 230 të ndryshuar, lista e veprave lihet e hapur në rast se mund të paraqiten fenomene të reja nga kjo pikëpamje.

Teksti shkruan: “*veprat me qëllime terroriste përfshijnë, por nuk kufizohen në:...*

Kjo pikë e kodit është e rëndësishme përse i përket parandalimit të fenomeneve të tilla që po shqetësojnë arenën ndërkombëtare

Fenomene të ndryshme që kanë evoluar kohët e fundit duke paraqitur edhe vështirësi në përballjen e tyre, kanë bërë që legjislatori të lërë rrugë të hapur për fenomene që mund të paraqiten dhe që duhen trajtuar si akte apo veprime me qëllime terroriste. Në këtë aspekt duhen pasur parasysh edhe organizata (*organizim me mbi dy persona*) si IRA, ETA apo Brigade Rosse. Terrorizmi ndërkombëtar nuk identifikohet vetëm me atë terrorizëm islamik me të cilin tashmë jemi të bombarduar nga mediat. Fenomeni, për vetë rastet e sipërpërmendura, ka një shtrirje më të gjerë të konceptit

Aspekt tjetër i këtij projektligji është edhe **koncepti i torturës** i bazuar në *Konventën Ndërkombëtare Kundër Torturës dhe Trajtime ose Ndëshkime të Tjera të Pamëshirshme, Çnjerëzore apo Poshtëruese*.

Në Kodin Penal të pamodifikuar (neni 86) dënohet “*tortura dhe çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruës...*” Në nenin 87 përshkruhet tortura me pasoja të rënda shëndetësore dhe karakteri i tyre i përhershëm, siç mund të jenë gjymtimi, shëmtimi si dhe tortura që ka pasojë vdekjen. Në këtë rast dënimi dyfishohet. Por nuk përcaktohen cilat janë aktet që mund të konsiderohen si torturuese. Në ligjin e ri përkufizohet tortura sipas Konventës kundër Torturës, neni 1 i saj.

Ndërsa në Kodin Penal lihej relativisht hapësirë për përkufizimin sipas rasteve të këtij lloji akti, në ligjin e ndryshuar rastet kur mund të konsiderohen të tilla, janë tashmë të cilësuar në rëndësinë e tyre

Në tekstin e projektligjit cilësohen si të tilla kryerja me dashje e veprave nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda fizike apo mendore, nga një person që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim:

a. për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime;

b. për të ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër;

c. për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një personi tjetër;

ç për çdo lloj qëllimi tjetër bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi;

d. çdo lloj akti tjetër çnjerëzor apo poshtërues, përbëjnë veprë penale..... (neni 10).

Pra, shihet qartë tendenca e dy teksteve të ligjeve. Në rastin e parë të pranimit të torturës si akt penal, ku nuk përshkruhet se cili akt mund të quhet torturues, në rastin e projektligjit jepet qartësisht se çdo lloj veprimi që ka si synim nxitjen për të marrë një informacion ose për arsye tjetër të paligjshme përbën një veprë për ndjekje penale.

Natyrisht, në nene përshkruhet edhe kush mund të ushtrojë këtë akt.

Përkufizimi në të njejtën linjë me konventat ndërkombëtare dhe me të drejtat e njeriut bën të mundur arritjen e standardeve ndërkombëtare, të cilat kërkohen nga institucionet ndërkombëtare për të marrë pjesë në arenën ndërkombëtare me të drejta të plota në këto organizata, por në këtë aspekt është e rëndësishme si përjasja e ligjeve kombëtare me ato ndërkombëtare, por sidomos respektimi i të drejtave dhe lirive të personave të sanksionuara fillimisht në Kushtetutën e Shqipërisë e cila është e bazuar në parimet demokratike.

Informacioni, transmetimi ose marrja e tij në rrugë të paligjshme si dhe deklaratave të rreme organeve të policisë gjyqësore kur ai klasifikohet sekret dhe për këtë arsye konsiderohet si një shkelje e rëndë për çështje sigurie etj.

Në Kodin Penal, përhapja e informacionit të kualifikuar si sekret shtetëror përmbahen në nenet 294 dhe 295 respektivisht dallohen nga përhapja e

informacionit sekret nga *person i besuar* dhe nga *shtetasit*. Në modifikimet e fundit ligji 9686, date 26.02.2007 shton pikën *a* në nenin 295 të KP, në të cilën shtohet figura e funksionarit publik në tregimin e të dhënave sekrete ose të një personi të ngarkuar në shërbim publik.

Në pikën *a* të nenit 295 të ligjit që ndryshon K.P. konsiderohen edhe tregimi i të dhënave sekrete në fushën e tregtisë industriale, zbulimi i të dhënave që përmbajnë akte sekrete nga prokurori, oficeri i policisë gjyqësore, si dhe zbulimi i të dhënave në procesin e bashkëpunimit, të mbrojtjes ose për vendndodhjen e dëshmitarëve, garanci dhe elemente juridike të cilët i shtohen duke pasuruar K.P.

Gjakmarrja është një fenomen që në shoqërinë shqiptare ka shkaktuar një numër të madh viktimash në territorin e Shqipërisë, dhe pasi janë kryer vrasje me një gjykim subjektiv konsideruar që normat që pretendohen të respektohen si *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, nuk janë më në fuqi dhe sot paraqiten me një anakronizëm perfekt. Natyrisht që një ligj të bëhet i tillë kërkon karakteristikat e tij si *opinio juris sive necessitatis* dhe *diuturnitas*. Këto ligje, në qoftë se sot mund të konsiderohen, nuk i kanë këto dy elemente duke marrë parasysh që janë fenomene të izoluara për në pjesë të territorit të Shqipërisë ku ato kanë një ndjeshmëri të lartë, kushtëzojnë jetën në këto vende. Mund të shihet raporti i fundit i Departamentit të Shteteve të Bashkuara për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Ligji për disa ndryshime në K. P. parashikon edhe këtë fenomen të shoqërisë shqiptare në dënimin e tij dhe në mënyrë indirekte fton të dëmtuarit nga ky fenomen t' i drejtohen drejtësisë. Ligji i ri shton pikën *a* në nenin 83 të K. P. ku citohet gjakmarrja, në të cilin shkruhet "*kanosja serioze për hakmarrje ose gjakmarrje....*", aspekt ky jo i konsideruar më parë në K. P.

Në ligjin që modifikon K. P parashikohet si kanosja me qëllim gjakmarrjen, e cila detyron persona për t' u mbyllur në shtëpi sipas zakoneve kanunore, si dhe nxitjen (neni 6 i ligjit që shton pikën *b* në nenin 83 të K.P.) për qëllime të tilla. Shtrirja e rasteve duhet të ndihmojë shoqërinë shqiptare për të dalë nga

ky fenomen, si dhe nga parime tashmë të tejkaluara nga shoqëritë demokratike.

Këto janë disa nga pikat kryesorë të ligjit 9686, datë 26.02.2007 të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë si domosdoshmëri në ecurinë e reformave të ndërmarra nga qeveria shqiptare për të përafuar legjislacioni shqiptar me atë komunitar si angazhime në procesin e integritit në strukturat e Bashkimit European.

Këto shënime nuk pretendojnë të jenë përfundimtare dhe ezauruese për sa i përket kësaj lënde. U konceptuan të jenë vetëm një përmbledhje.

Kuvendi i Shqipërisë, për muajin mars 2007, në lidhje me fushën e Integritit European, ka miratuar projektligjet e mëposhtme, të propozuara nga Këshilli i Ministrave sipas neneve të parashikuara nga Kushtetuta (neni 121).

· **Projektligji** “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre”.

Në tërësi, konventa synon të luajë një rol parandalues dhe eliminimin e shfrytëzimit të të gjithë punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre gjatë procesit migrator. Aderimi në këtë konventë do të përmirësojë legjislacionin vendas për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Gjithashtu, aderimi në konventë është në kuadrin e zbatimit të MSA-së, të zbatimit të planit kombëtar për procesin e integritit european, në zbatim të strategjisë kombëtare të migracionit dhe të planit kombëtar të veprimit të migracionit.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijojnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Komisioni i Jashtëm

Komisioni i Integritit European

Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

· **Projektligji** “Për ratifikimin e marrëveshjes strategjike, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor European”.

Kjo marrëveshje është nisur nga qëllimi i mirë dhe nga interesi i ndërsjellë për të rritur bashkëpunimin në luftën kundër formave të rënda të krimit ndërkombëtar, si dhe në kuadër të angazhimeve në përbushjen e kriterëve të përcaktuara në procesin e Stabilizim – Asocimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

Marrëveshja bazohet në platformën dhe në vullnetin e përbashkët të palëve për të luftuar format e rënda të krimit të organizuar që kanë të bëjnë me: trafikimin e paligjshëm të drogës, krimet e lidhura me lëndët bërthamore dhe radioaktive, kontrabandën e paligjshme të imigrantëve, trafikimin e qënieve njerzore, krimin me mjete motorike, falsifikimin e parasë dhe mjeteve të pagesës si dhe veprimtari të paligjshme të pastrimit të parave.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijojnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Komisioni i Jashtëm

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

· **Projektligji** “Për ratifikimin e marrëveshjes, për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qëndrore”.

Në këtë marrëveshje paraqiten liberalizimi i plotë i importeve dhe eksporteve të produkteve industrial nga data 1 janar e vitit 2007. Kjo datë përkon me periudhën e përfundimit të periudhës tranzitore të përcaktuar në marrëveshjet dy palëshe të tregëtisë së lirë më vendet që kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Lidhur me produktet bujqësore, procesi paraqitet në dy forma:

1. Transferimi i të gjitha konçesioneve për Serbinë, Maqedoninë dhe Bosnjë Herecegovinën.

2. Rinegociimi i konçesioneve në fushën e produkteve bujqësore për vendet e tjera do të bëhet me Kroacinë, Kosovën dhe Malin e Zi.

Për mirëfunksionimin e marrëveshjes së vetme të tregëtisë së lirë CEFTA të zgjeruar dhe të amenduar palët kanë rënë dakort për ngritjen dhe funksionimin e një sekretariati të përhershëm më qendër në Bruksel, i cili do të mbështetet financiarisht nga donatorët si sekretariati i CEFTA-s dhe donatorë të tjerë për një periudhë fillestare trevjeçare.

Marrëveshja nuk ka efekte të reja financiare për buxhetin e shtetit.

Sipas nenit 4 të marrëveshjes ajo do të hyjë në fuqi në 1 maj 2007.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijojnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Komisioni i Jashtëm

Komision për Integrim Europian

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

· **Projektligji** “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi, (OPRC) 1990”.

Shqipëria ushtron një veprimtari në transportin detar nga anijet e huaj të vendeve të ndryshme, nga anijet e peshkimit dhe ato turistike, të cilat mund të përmbliohen në shifrat e mëposhtme

Transporti ndërkombëtar numëron rreth 70 anije me tonazh rreth 60000 GRT dhe 200 anije peshkimi. E gjithë kjo veprimtari paraqet një rrezik për ambjentin detar duke shtuar ndotjen. Në të njëjtën kohë, portet detare të Shqipërisë numërojnë një transport deri në 2000 mjete lundrimi, ku përfshihen edhe ato mjete që transportojnë karburant

Qëllimi i konventës është të sigurojë që të gjitha shtetet të kenë marrë masat për të kundërvepruar ndaj incidenteve të ndotjes në det nga derdhjet e karburantëve.

Shqipëria është palë e një sërë konventave që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit detar, në bazë të një strategjie të përcaktuar nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO).

Konventa për mjedisin detar detyron operatorët e fushave që kanë të bëjnë me veprimtari që mund të shkaktojnë ndotje në det, të paraqesin planin e tyre të kontingjencës për kufizimet e ndotjes si dhe për rekuperimin e gjendjes normale në det.

Nga kjo konventë, shteti shqiptar do të marrë asistencë nga shtetet e mëdha për ngritjen e strukturave dhe të standarteve të nevojshme për ruajtjen e ambjentit detar nga ndotja prej produkteve të naftës.

Para kalimit të seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijojnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Komisioni i Jashtëm

Komision për Integrim Europian

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

· **Projektligji** “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin me kredi, të projektit “Ndërtimi i terminalit të trageteve dhe shesheve përreth, në Portin e Durrësit”.

Qëllimi kryesor i kredisë, që jep Banka Europiane e Investimeve (BEI) është ndërtimi i ndërtesës së terminalit të trageteve të pasagjereve në portin kryesor të Shqipërisë në Detin Adriatik, si dhe punime të tjera ndihmëse në funksionin e tij.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijojnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Komisioni i Jashtëm

Nga punimet e kuvendit për muajin maj 2007

Përgatiti: Alma Kondakçiu

1. P/ligji “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (shqyrtuar në seancë plenare më datë 21 maj 2007).

Projektligji përcakton kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet në sistemin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe ka qëllim t’u sigurojë institucioneve të arsimit të lartë autonomi të plotë financiare, liri akademike, liri vendimmarrjeje e pavarësi institucionale. Ai synon të modernizojë sistemin e arsimit të lartë, të rrisë cilësinë e mësimdhënies dhe të përgatitjes së studentëve, në përputhje me Kartën e Bolonjës.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zhvilloi një seancë të posaçme diskutimi me Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, si dhe organizoi disa seanca dëgjimore me përfaqësues të universiteteve, Zyrës për Mbrojtjen e Qytetarëve, Lëvizjes “Mjaft” dhe qeverisë studentore, në të cilat mori mendimet e tyre për projektligjin.

Gjatë diskutimit të projektligjit në këtë Komision, si dhe në seancë plenare shumica e deputetëve e vlerësuan pozitivisht projektligjin, i cili vendos bazën ligjore, deri tani të munguar, për të tri ciklet e studimit sipas formatit evropian, ligjëron mundësinë e programeve të studimeve ndërdisiplinore, të përbashkëta dhe të formimit të vazhduar, rrit cilësinë e punës në universitete, u jep pavarësi financiare atyre, organizon më mirë kërkimin shkencor, krijon një kuadër të plotë ligjor për shkollat e larta private, si dhe përmirëson qeverisjen dhe administrimin e dokumentacionit në universitete.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin, me argumentet që ai nuk merr në konsideratë zhvillimin që ka marrë arsimiti i lartë në vendin tonë dhe detyrimet në kuadër të Kartës së Bolonjës, kufizon autonominë dhe standardet e shkollave të larta, nuk realizon kërkesat për pjesëmarrje dhe përfaqësim të studentëve në administrimin e universiteteve dhe në politikat arsimore, nuk siguron mbështetje të mjaftueshme ligjore për kërkimin shkencor, ka paqartësi dhe pasaktësi në përkufizimin e strukturave dhe njësive universitare. Ata propozuan disa amendamente për të përmirësuar përmbajtjen e projektligjit.

Pas ndryshimeve në disa dispozita, projektligji u miratua me shumicë votash.

2. Pligji “Për transmetimet numerike eksperimentale në Republikën e Shqipërisë” (shqyrtuar në seancë plenare në datën dhe 28 maj 2007).

Projektligji përcakton rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve të medias audiovizive në fushën e transmetimeve dixhitale, duke plotësuar boshllëkun ekzistues ligjor në këtë fushë.

Ky projektligj u bë objekt i një debati të gjerë disamujor me grupet e interesit, shoqërinë civile dhe shoqata të ndryshme të interesuara.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, si dhe në seancë plenare, shumica e deputetëve e konsideruan projektligjin të rëndësishëm, pasi ai vë në baza ligjore një veprimtari që deri tani është kryer në rrugë informale dhe u krijon mundësinë e licencimit subjekteve që kërkojnë të investojnë në fushën e transmetimeve dixhitale.

Mendimi i pakicës së deputetëve ishte se projektligji penalizon operatorët që kanë investuar në fushën e transmetimeve dixhitale, duke u hequr të drejtën e përdorimit të disa frekuencave dhe se hartimi i tij nuk mban në konsideratë vërejtjet e institucioneve ndërkombëtare dhe të grupeve të interesit.

Mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Europës dhe në mendimet e grupeve të interesit, projektligjit iu bënë disa përmirësime, siç janë zgjatja e

periudhës së licencimit për transmetuesit kombëtarë, rajonalë e lokalë, përcaktimi i një periudhë kohe për lejimin e transmetimeve analoge, deri në ndërprerjen e tyre, vendosja e rregullave për transmetimin e programeve të televizionit publik, trajtimi i disa çështjeve që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe promovimin e pluralizmit në fushën e transmetimeve dixhitale etj. Duke marrë parasysh se mjaft qytetarë kanë kontrata me transmetuesin “Dixhitalb” që operon sot në treg, iu dha e drejta këtij operatori që, në marrëveshje me KKRT-në, ta ushtrojë këtë veprimtari deri në përfundimin e afatit të të gjitha kontratave.

Projektligji u miratua në tërësi me shumicë votash.

3. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar” (shqyrtuar në seancë plenare në datën 28 maj 2007).

Ndryshimet në ligjin ekzistues synojnë përcaktimin e procedurave për organizimin e llotarisë kombëtare dhe të llotarisë për parashikimet sportive, dhënien e licencave nëpërmjet konkurrimit, përcaktimin e zonave në territorin e Republikës së Shqipërisë ku lejohen të hapen kazinotë, vendosjen e gjobave për shkeljet administrative, krijimin e njësisë për mbikëqyrjen e lojërave të fatit etj.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe në seancë plenare, u bënë vlerësime të ndryshme nga deputetët.

Shumica e deputetëve e vlerësoi pozitivisht projektligjin. Sipas tyre, licencimi i një operatori të vetëm në veprimtarinë e llotarisë kombëtare dhe të llotarisë për parashikimet sportive mbështetet në praktikat ndërkombëtare, shmang veprimtarinë e operatorëve që nuk japin garancitë e nevojshme, rrit garancinë e lojtarëve dhe kufizon përhapjen e madhe të këtyre veprimtarive në të gjithë territorin e vendit. Projektligji përmirëson rregullat në fushën e kontrollit të veprimtarive të lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve, pasi rrit ndjeshëm kapitalin e shoqërive që operojnë në këto fusha, si dhe fondin e garancisë, që përdoret për shpërblimin e lojtarëve. Gjithashtu, projektligji

parashikon rritjen nga 18, në 21 vjeç të moshës së personave të punësuar në këto veprimtari. Për të kufizuar dhe kontrolluar këto veprimtari, projektligji ndalon dhënien e huave, të borxheve e kredive për organizatorët e tyre.

Deputetët e opozitës kundërshtuan dhënien e një licence të vetme për veprimtaritë e llotarisë kombëtare dhe të parashikimeve sportive, duke pretenduar që kjo do të çojë në krijimin e monopoleve në dy llotaritë kryesore, ku qarkullojnë shuma të mëdha parash. Ata ishin të mendimit që këto veprimtari duhet të ushtrohen nga kompani shtetërore ose nga kompani të zotëruara kryesisht nga shteti, sepse këto biznese janë bizneset më me risk në fushën e pastrimit të parasë. Për shkak të ndikimit që kanë lojërät e fatit në jetën shoqërore dhe politike të vendit, deputetët e opozitës propozuan të ndalohet reklama e tyre më median audiovizive dhe të shkruar. Ky propozim u mor në konsideratë nga Kuvendi.

Projektligji u miratua me shumicë votash dhe në tekstin e tij u miratuan disa ndryshime.

4. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar (shqyrtuar në seancë plenare në datën 28 maj 2007).

Nevoja për hartimin e këtij projektligji lindi për shkak të kërkesave të shumta për leje ndërtimi, një situatë bllokuese në dhënien e tyre dhe shmangies së papajtueshmërisë së kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban me Kushtetutën, të evidentuar me vendimin nr.29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë diskutimit në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe në seancë plenare projektligji u vlerësua pozitivisht nga shumica e deputetëve, me argumentet që ai është në përputhje me Kushtetutën, do të sjellë zhblokimin e situatës së krijuar në Bashkinë e Tiranës, si rezultat i mosfunksionimit për një kohë të gjatë të KRRT-së, do të ndihmojë biznesin, si dhe do të zgjerojë autonominë e pushtetit vendor.

Pakica e deputetëve e kundërshtoi projektligjin, veçanërisht nenin 3 të tij dhe argumentoi se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ka krijuar boshllëk ligjor. Sipas tyre, nuk është e nevojshme të ndërhyhet me një projektligj të përkohshëm, por të presim të vijë ligji i plotë i planifikimit urban.

Pas përfundimit të diskutimit, projektligji u miratua me shumicë votash.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako
Jurist

Ligj nr.9485, datë 6.3.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Montrealit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”. Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit” i janë bërë disa amendamente, të cilave u janë bashkëlidhur disa anekse, të cilat përmbajnë të dhëna teknike, formula etj., lidhur me grupe substancash ozonholluese potenciale, substanca transitore etj. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të një ndryshimi në Aneksin E, çdo palë do të ndalojë importin e substancës së kontrolluar në këtë aneks, nga shtete që nuk janë palë e këtij Protokollit. Në rast se kur pas kalimit të datës së aplikueshme për një substancë të kontrolluar, një palë është në gjendje, megjithëse ka marrë të gjitha hapat praktikë, për të përmbushur detyrimet e protokollit, të ndalojë prodhimin e kësaj substance për konsum vendas, me përjashtim të përdorimeve të tjera të rënda dakord nga palët që janë thelbësore, ajo do të ndalojë dhe sasitë e përdorura, të ricikluara dhe rikuperuara të kësaj substance, për qëllime të tjera përveç shkatërrimit. Gjithashtu, çdo palë, që nga 1 janari 2000 ose brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, cilido nga këto data që është e mëvonshme, do të vendosë dhe do të zbatojë një sistem për licencimin e importit dhe eksportit të substancave të reja të ricikluara ose rikuperuara në anekset A, B, C dhe E. Në Amendament theksohet fakti që asnjë shtet ose organizatë për integrim ekonomik rajonal nuk mund të depozitojë një instru-

ment ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi me këtë Amendament në rast se, më parë ose në të njëjtën kohë, nuk ka depozituar një instrument të tillë për Amendamentin e miratuar në takimin e katërt të palëve në Kopenhagen më 25 nëntor 1992. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 21.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22 të vitit 2006 në faqen 690. Ligjit i bashkëlidhet Amendamenti i Montrealit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit.”

Ligj nr.9486, datë 6.3.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Pekinit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”. Ndryshimet dhe shtesat që bën Amendamenti i Pekinit kanë të bëjnë kryesisht me prodhimin dhe eksportimin e substancave të kontrolluara të cilat janë renditur në pesë Aneksë të Protokollit të Montrealit. Sipas Amendamentit, çdo palë prodhuese e një ose më shumë prej këtyre substancave do të sigurojë që, për një periudhë 12-mujore duke filluar nga 1 janari 2004 dhe në çdo periudhë 12-mujore të mëpasme, niveli i përlllogaritur i prodhimit të substancave të kontrolluar në grupin I të Aneksit C nuk e kalon, në vit, mesataren e shumës së nivelit të përlllogaritur të konsumit në 1989 dhe shumës së nivelit të kalkuluar të prodhimit në vitin 1989. Megjithatë, niveli i përlllogaritur i prodhimit mund të kalojë këtë limit deri në pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të përlllogaritur të prodhimit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C. Në amendament parashikohet që, duke filluar nga 1 janari 2004, çdo palë do të ndalojë eksportin e substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C, në çdo shtet që nuk është palë e këtij Protokollit dhe, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi, sa u tha më sipër, çdo palë duhet të ndalojë eksportin e substancave të kontrolluara në Grupin III të aneksit C në çdo shtet jopalë të këtij Protokollit. Asnjë shtet ose organizatë për integrimin rajonal ekonomik nuk mund të depozitojë ndonjë instrument ratifikimi për këtë Amendament, në rast se nuk ka depozituar më parë ose në të njëjtën kohë një instrument të tillë në amendimin e adoptuar në takimin e nëntë të palëve në Montreal, 17 shtator 1997. Amendamenti hyn në fuqi më 1 janar 2001, në rast se të paktën njëzet instrumente ratifikimi

janë depozituar nga shtetet ose organizatat për integrim ekonomik rajonal që janë palë të Protokollit të Montrealit për substancat që dobësojnë shtresën e ozonit. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 21.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22 të vitit 2006, në faqen 692. Ligjit i bashkëlidhet Amendamenti i Pekinit.

Ligj nr.9487, datë 6.3.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”. Me ligjin e lartpërmendur, ligjit në fuqi, pra ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 i bëhen tri shtesa dhe dy ndryshime. Kështu në nenin 10, i cili parashikon kohëzgjatjen e shërbimit, në pikën 1 të këtij neni thuhet se shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollat e larta universitare me shkëputje nga puna, brenda ose jashtë vendit, në përshtatje me diplomimin e tyre dhe sipas përcaktimeve që bën Ministri i Mbrojtjes kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ për një periudhë 1-mujore. Me ndryshimin që i bëhet kësaj pike, problemi thjeshtohet pasi, sipas ndryshimit, mjafton që shtetasi shqiptar të ketë përfunduar një shkollë të lartë me shkëputje nga puna, brenda ose jashtë vendit dhe përjashtohet nga kryerja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Në nenin 14 parashikohen lirimet e parakohshme nga shërbimi ushtarak, ligji në fuqi këtë parashikim e ka për tri raste, në pikat a, b dhe c, por me ligjin e lartpërmendur, pra ligjin nr.9487, datë 6.3.2006 shtohen edhe dy raste, pra pikat ç dhe d. Sipas shtesës së pikës ç lirimimi nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak bëhet edhe kur shtetasi kryefamiljar, gjatë kohës së kryerjes së shërbimit ushtarak bëhet me dy ose më shumë fëmijë dhe, gjithashtu sipas shtesës së pikës d lirohet nga ky shërbim kur shtetasi titullohet ushtar profesionist. Pika “b” e nenit 14 të ligjit në fuqi parashikon lirimimin para kohe nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak për raste fatkeqësive të rënda familjare, kur prindi ose bashkëshortja bëhet invalid ose vdes dhe fëmijët mbeten pa përkujdesje. Sipas ndryshimit që i bëhet kësaj pike, ky lirim bëhet për rastet e fatkeqësive familjare dhe kur personat në ngarkim të ushtarit mbeten pa përkujdesje. Neni 36/1 që shtohet parashikon detyrimet e

organeve të Policisë së Shtetit. Sipas këtij neni organet e Policisë së Shtetit në qarqe detyrohen të shoqërojnë për në qendrën e rekrutim-mobilizimit të qarkut shtetasit, të cilët janë thirrur për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, sipas listëthirrjeve të dërguara nga qendra e rekrutim-mobilizimit dhe që nuk janë paraqitur në qendrën e rekrutim-mobilizimit. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.24 të vitit 2006, në faqen 723.

Ligji nr.9488, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e protokollit shtesë të Konventës Europiane “Për informimin për të drejtën e huaj”. Konventa Europiane për informimin mbi të drejtën e huaj, është nënshkruar në Londër më 7 qershor 1968. Por shtetet nënshkruese, anëtare të Këshillit të Europës, duke e konsideruar se është e nevojshme dhe e dëshirueshme të zgjerohet sistemi i ndihmës së ndërsjellë ndërkombëtare, të iniciuar nga kjo Konventë në fushën e të drejtës dhe procedurës penale, në një kuadër shumëpalësh, të hapur për të gjitha palët kontraktuese të Konventës, kanë rënë dakord të miratojnë këtë Protokoll shtesë të Konventës. Sipas Protokollit Shtesë, palët kontraktuese marrin përsipër t’i ofrojnë njëra tjetrës, në përputhje me dispozitat e Konventës, informacion mbi të drejtën e tyre materiale dhe procedurale dhe organizimin gjyqësor në fushën penale, duke përfshirë autoritetet e ndjekjes penale, si dhe në lidhje me zbatimin e masave penale. Kërkesa për informacion për çështjet e përmendura më sipër mund të nxirret jo vetëm nga një gjykatë, por edhe nga autoritetet gjyqësore që kanë juridiksion për të ndjekur penalisht veprat penale, ose që ekzekutojnë dënimet e formës së prerë. Po ashtu kërkesa mund të bëhet jo vetëm kur janë filluar procedimet, por edhe kur është parashikuar fillimi i këtyre procedimeve. Protokollit detyron që çdo palë kontraktuese, e cila nuk ka krijuar apo caktuar organe për të vepruar si agjenci transmetuese, do të krijojë ose caktojë këtë apo këto agjenci për qëllime të transmetimit të çdo kërkesë për informacion, ndaj agjencisë kompetente të huaj marrëse. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës nënshkruese të kësaj

Konvente. Por një shtet anëtar i Këshillit të Europës nuk mund ta nënshkruajë këtë protokoll pa rezervë, në lidhje me ratifikimin, aderimin ose miratimin, as ta ratifikojë, aderojë ose miratojë atë, për sa kohë që nuk ka ratifikuar ose aderuar në Konventë në të njëjtën kohë ose në një kohë të mëparshme. Protokollin është bërë në Strasburg më 15 mars 1978. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr,24 të vitit 2006, në faqen 724. Ligji i bashkëlidhet Protokollin.

Ligj nr.9489, datë 13.3.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në dispozitat për zhvillimin, pranimin dhe zbatimin e kërkesave të përbashkëta të aviacionit”. Objekti i Konferencës së Aviacionit Civil European (ECAC) përfshin nxitjen e sigurisë së Aviacionit Civil European. Disa autoritete të Aviacionit Civil European kanë filluar në vitin 1970 të bashkëpunojnë për përpunimin e përbashkët të “Kërkesave të përbashkëta të vlefshmërisë ajrore”, për të lehtësuar procesin e certifikimit të produkteve të prodhuara në Europë dhe importin e eksportin e produkteve brenda Europës. Në vitin 1979 Autoritetet e Aviacionit Civil European kanë nënshkruar “Dispozitat për zhvillimin dhe pranimin e kërkesave të përbashkëta të vlefshmërisë ajrore”. Nga këto dispozita del se Autoritetet (kjo fjalë nënkupton të gjitha palët në Autoritetin e Aviacionit Civil) marrin përsipër për të bashkëpunuar në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë e avionit, në veçanti me projektimin, prodhimin, vazhdueshmërinë e vlefshmërisë, mirëmbajtjen dhe operimin, për të siguruar një nivel të lartë sigurie në të gjitha shtetet anëtare, për të shmangur dublimin e punës ndërmjet autoriteteve dhe për të lehtësuar këmbimin e produkteve, të shërbimeve dhe individëve, jo vetëm ndërmjet autoriteteve, por edhe ndërmjet autoriteteve dhe të tjerëve. Dispozitat përbajnë gjithashtu edhe detyrat e Autoriteteve, organizimin dhe procedurat, fillimin e operimit (këto dispozita fillojnë operimin më 1 tetor 1990 për palët që e kanë nënshkruar para 30 shtatorit 1990), regjistrimin e palëve, amendimin e këtyre dispozitave etj. Është parashikuar edhe procedura për ndonjë shtojcë e aneks që mund t’u shtohet dispozitave

aktuale. Këto dispozita kanë 4 shtojca. Shtojca I përmban zhvillimin dhe publikimin e kërkesave, shtojca II trajton kryerjen e përbashkët të certifikimit, shtojca III jep organizimin e IAA (Autoritetet e Përbashkëta të Aviacionit) dhe shtojca IV tregon se si bëhet ndarja e buxhetit qendror të IAA. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 26.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.28 të vitit 2006, në faqen 921. Ligjit i bashkëlidhen dispozitat mbi zhvillimin, pranimin dhe zbatimin e kërkesave të përbashkëta të Aviacionit dhe 4 shtojca.

Ligj nr.9490, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e Konventës për Ruajtjen e Trashëgimi Kulturore Jomateriale, Paris 2003”. Konferenca e përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsimin, shkencën dhe kulturën, miratoi në Paris më 17 tetor 2003 këtë Konventë, duke marrë parasysh rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përmbledhëse e diversitetit kulturor dhe garanci e zhvillimit afatgjatë, siç theksohet në Rekomandimin e UNESCO-s për mbrojtjen e kulturës tradicionale dhe popullore të 1989-s, Deklaratën e përbotshme të UNESCO-s për diversitetin kulturor të vitit 2001 dhe Deklaratën e Stambollit të vitit 2002. Gjithashtu, për miratimin e kësaj Konvente është pasur parasysh edhe roli i pashmangshëm i trashëgimisë kulturore jomateriale si faktor afrimi, shkëmbimesh dhe kuptimi midis qenieve njerëzore. Në Konventë shpjegohet se me “Trashëgimi kulturor jomateriale” kuptohen praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë dhe dijeberja, si dhe veglat, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore, që bashkëshoqëron ato që bashkësitë, grupet dhe, kur është rasti, individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Më poshtë flitet për Organet e Konventës, duke theksuar se Asambleja e Përgjithshme e shteteve palë është organi sovran i kësaj Konvente. Organ tjetër është edhe Komiteti ndërqeveritar i ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale”. Në pjesën e tretë trajtohen probleme të ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale në shkallë kombëtare, duke treguar me hollësi për masat që duhen marrë për ruajtjen e tyre, për inventarët, edukimin, sensibilizimin etj. Në mënyrë të veçantë jepen porosi për mënyrat

e ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale në shkallë ndërkombëtare. Lidhur me bashkëpunimin dhe mbështetjen ndërkombëtare jepen objektivat e kësaj mbështetjeje etj. I rëndësishëm është fakti që Komiteti ndërqeveritar të përfshijë në listën paraqitëse të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit elementet e shpallura “Kryevepra të trashëgimisë gojore dhe jomateriale të njerëzimit. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.24 të vitit 2006, në faqen 727. Ligjit i bashkëlidhet Konventa.

Ligj nr.9491, datë 13.3.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit”, i ndryshuar. Me ligjin e lartpërmendur ndryshohet neni 25 i ligjit në fuqi. Sipas këtij të fundit, privatizimi i pronës shtetërore nëpërmjet shitjes së aksioneve organizohet dhe shpallet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, që përcakton edhe vlerën normale të aksionit. Rregullat për emetimin, shpërndarjen, ruajtjen dhe shitjen e aksioneve përcaktohen nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shtetit Shqiptar. Me ligjin nr.9491, datë 13.3.2006 ky nen ndryshohet krejtësisht. Sipas neni 25 të ndryshuar, Ministria e Financave është i vetmi organ që i kryen procedurat e shitjes së pronës shtetërore që privatizohet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj. Agjencia Kombëtare e Privatizimit shtrihet dhe pushon së funksionuari si institucion qendror në varësi të Ministrit të Financave. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.24 të vitit 2006, në faqen 738.

Ligj nr.9492, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit”. Shtetet palë në këtë Konventë e kanë hartuar dhe miratuar atë, duke vlerësuar seriozitetin e problemeve dhe rreziqeve që dalin nga korrupsioni për stabilitetin dhe sigurinë e shoqërive, duke dëmtuar institucionet dhe vlerën e demokracisë, vlerat etike dhe drejtësinë dhe duke rrezikuar zhvillimin thelbësor dhe shtetin ligjor.

Po ashtu kanë vlerësuar shqetësimin se përfitimi i paligjshëm i pasurisë vetjake mund të jetë veçanërisht i dëmshëm për institucionet demokratike, ekonominë kombëtare dhe shtetin ligjor. Qëllimet e kësaj Konvente janë nxitja dhe forcimi i masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit më me efikasitet dhe efektivitet, nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rimarrjen e pasurisë dhe nxitja e integritetit, e përgjegjësisë dhe administrimit i rregullt i çështjeve publike dhe pasurisë publike. Në krerët në vazhdim trajtohen masat parandaluese, duke vënë theksin sidomos në politikat dhe praktikat parandaluese, organet parandaluese, kodet e sjelljes për nëpunësit publikë, raportimin publik, masat për parandalimin e pastrimit të parave etj. Penalizimi dhe përmbarimi trajtohet në kreun III, duke veçuar dhënien e rryshfetit nëpunësve publikë, trafikimin e influencave, abuzimin me funksionet, pasurimin e paligjshëm, pastrimin e fitimeve nga krimi, pengimin e drejtësisë, ndjekjen penale, gjykimin dhe sanksionet, mbrojtjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe viktimave, mbrojtjen e personave raportues, kompesimin e dëmit, bashkëpunimin me organet e përmbarimit etj. Rëndësi të veçantë Konventa i ka kushtuar bashkëpunimit ndërkombëtar lidhur me ekstradimin, transferimin e personave të dënuar, asistencës ligjore të përbashkët, investigime të përbashkëta, transferimit të procedimeve penale etj. Krerët e fundit trajtojnë rikuperimin e aseteve, kthimin dhe hedhjen e aseteve, asistencën teknike dhe këmbimin e informacionit dhe mekanizmat e zbatimit. Nga ligji del se në zbatim të pikës 3 të nenit të nenit 6 të Konventës, autoriteti që mund të asistojë shtetet e tjera palë në zhvillimin dhe zbatimin e masave të veçanta për parandalimin e kompromisit është Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorupsionit në Këshillin e Ministrave, kurse në zbatim të shkronjës “a” të pikës 6 të nenit 44 të Konventës, Republika e Shqipërisë pranon këtë Konventë si bazë ligjore në bashkëpunimin me shtetet e tjera palë të Konventës për ekstradimin. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.27 të vitit 2006, në faqen 885. Ligjit i bashkëlidhet Konventa më 71 nene.

Ligji 9493, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit “Për pesë poliklinika në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë”. Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. bëhet për financimin e programit “Për pesë poliklinika në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë”, me një kredi të butë prej 5.080.000. Kredia e butë është një financim të cilin Artigiancassa do të japë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në Marrëveshje, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe mbi propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë. Sipas Marrëveshjes Qeveritare, të nënshkruar më 17 maj 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, kjo e fundit është angazhuar ta financojë programin përmes një kredie të butë në një shumë maksimale prej 5.080.000 euro. Kohëzgjatja e shlyerjes së saj do të jetë 38 vjet dhe do të paguhet me 42 këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmuaj, të principalit, i pari i të cilëve kthehet në detyrim për t’u paguar 210 muaj nga data e disbursimit të parë. Norma e interesit nominal vjetor do të jetë 0.10 për qind e pagueshme në fund të çdo periudhe 6-mujore nga data e secilës tërheqje. Siç u tha edhe më lart, qëllimi i kredisë do të jetë programi për pesë poliklinikat në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë. Kjo kredi do të përdoret për përfitimin e mallrave dhe të shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimumi sa 30 për qind e shumës së kredisë së butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe importe të mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga vende të tjera në zhvillim. Secila kontratë që lidhet në këto rrethana do të negociohet nëpërmjet dhe do të nënshkruhet vetëm nga kontraktori/eksportuesi italian kryesor. Kredia e butë nuk do të përdoret për të financuar taksat vendore, detyrimet doganore dhe TVSH-në. Marrëveshjes i bashkëlidhen Shtojca A “Formulari i kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit”, Shtojca B “Formulari i kërkesës për disbursim”, Shtojca C

“Formulari i njohjes së të qenit në borxh” dhe Shtojca D “Formulari i vërtetimit për faturë të paguar”. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.24 të vitit 2006, në faqen 739. Ligjit i bashkëlidhen Marrëveshja dhe Shtojcat.

Ligj nr.9494, datë 13.3.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, i ndryshuar. Ligji nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore” deri tani ka pësuar 3 ndryshime. Ndryshimi i fundit i është bërë me ligjin nr.9330, datë 6.12.2004, të botuar në Fletoren Zyrtare nr.107 të vitit 2004, në faqen 6846. Me ligjin nr.9494, datë 13.3.2006 është shfuqizuar paragrafi i dytë i nenit 1/1, si dhe shënimi i bërë në Aneksin 1 të këtij ligji. Nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim Aneksi 2 (me më shumë se 500 artikuj) dhe Aneksi 3 (Azhurnimi i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave sipas versionit 2004 të BE) me më shumë se 600 artikuj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.24 të vitit 2006, në faqen 750.

Ligj nr.9495, datë 20.3.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Shpëtimin, Londër 28 prill 1989”. Duke njohur dobinë e caktimit me marrëveshje të rregullave uniforme ndërkombëtare, në lidhje me operacionet e shpëtimit, shtetet palë hartuan dhe miratuan në Londër më 28.4.1989 Konventën e lartpërmendur dhe, gjithashtu, duke patur parasysh shqetësimin në rritje për ruajtjen e mjedisit, kanë pasë nevojën e rishikimit të rregullave ndërkombëtare që janë momentalisht në Konventën për unifikimin e disa rregullave ligjore në lidhje me asistencën dhe shpëtimin në det, bërë në Bruksel më 23 shtator 1910. Kjo Konventë zbatohet kurdoherë që në një shtet palë fillojnë procese gjyqësore ose arbitrazhi për çështje që trajtohet në të. Konventa nuk zbatohet për luftanijet ose mjetet e tjera jotregtare të lundrimit. Nëse një shtet palë vendos të zbatojë këtë Konventë për luftanijet dhe mjetet e tjera të lundrimit

duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, duke saktësuar rrethanat dhe kushtet për një zbatim të tillë. Konventa trajton disa probleme, siç janë ato të hyrjes së operacioneve të shpëtimit, ku jepen të detajuara detyrat e shpëtuesit dhe të pronarit të kapitenit, detyrat për të dhënë asistencë, bashkëpunimi etj. Të drejtat e shpëtuesve gjenden në Kreun III dhe flitet kryesisht për kushtet e shpërblimit, kriteret për caktimin e shpërblimit, kompensimin e veçantë, pjesëtimin e shpëtimit ndërmjet shpëtuesve, efektet e sjelljes së parregullt të shpëtuesit, ndalimi i veprimit të shpëtimit etj. Kur midis palëve lindin probleme lidhur me pagesën për shpëtimin, Konventa trajton të drejtën e pengut mbi anijen, detyrimin për të dhënë garanci, pagesat paraprake, kufizimin e padive etj. Në dispozitat e fundit bëhet fjalë për nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin dhe aderimin, si dhe për rezervat, denoncimin, rishikimin, ndryshimin etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 26.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.28 të vitit 2006, në faqen 931. Ligjit i bashkëlidhet Konventa.

Ligj nr.9496, datë 20.3.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për transferimin e personave të dënuar”. Nënshkruer të kësaj Marrëveshjeje janë Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, për të çuar më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin social të personave të dënuar dhe vendosja në baza ligjore të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe UNMIK-ut për çështjet që kanë të bëjnë me transferimin e personave të dënuar. Sipas Marrëveshjes palët marrin përsipër t’i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja përmban ndërmjet të tjerash kushtet e transferimit, duke i dhënë ato në mënyrë taksative, përmban detyrimet për të dhënë informacion nga pala dënuese çdo personi të dënuar,

lidhur me përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje, informacion i cili duhet t'i jepet me shkrim dhe në një gjuhë që ai e kupton. Rëndësi e veçantë i kushtohet sidomos respektimit të të drejtave të personit të dënuar, për të cilin kërkohet që pala dënuese duhet të sigurohet që personi të cili i kërkohet të japë pëlqimin për transferimin ta ketë dhënë atë vullnetarisht dhe duke pasur dijeni të plotë në lidhje me pasojat ligjore të këtij veprimi. Trajtohen, gjithashtu, probleme të afatit të transferimit për palën dënuese dhe palën administruese për konvertimin e dënimit, për zbatimin e avantazheve të amnistisë ose të zbutjes së dënimit, të rishikimit të vendimit etj. Gjithashtu, vendosen detyra midis palëve në lidhje me informacionet për ekzekutimin e dënimit, kur pala administruese mendon se ekzekutimi i dënimit ka përfunduar. Ligji ka dy nene dhe ka hyrën ë fuqi më 26.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.28 të vitit 2006, në faqen 940. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr.9497, datë 20.3.2006 “Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Binesit dhe Investimeve”. Objekti i këtij ligji është krijimi i Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve, përcaktimi i fushës së veprimtarisë dhe i parimeve e rregullave të përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e kësaj Agjencie. Funksionimi dhe veprimtaria e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve përcaktohen në statut, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kurse struktura dhe organika përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Kjo Agjenci është në varësi të ministrit të lartpërmendur. Objekt i veprimtarisë së saj, ndërmjet të tjerash, janë: zbatimi i politikave dhe strategjive, zhvillimi i programeve dhe projekteve, në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat, studimi, kërkimi, analizat dhe konkluzionet për klimën e biznesit, nxitja, tërheqja dhe mbështetja e investimeve të huaja, në përputhje me përparësitë e politikës së Qeverisë, identifikimi i mundësive për investime në Shqipëri dhe promovimi i tyre etj. Agjencia Shqiptare e biznesit dhe Investimeve, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të realizojë të ardhura nëpërmjet

shërbimeve që kryen, në funksion të qëllimit të fushës së veprimtarisë së vet. Kjo Agjenci nuk lejohet të ushtrojë veprimtari fitimprurëse. Organet drejtuese të saj janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv. Përbërja e këtij Këshilli, mënyra dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të tij caktohen nga Këshilli i Ministrave. Burimet e financimit të Agjencisë janë Buxheti i Shtetit, në përputhje me situatën financiare, donatorë të ndryshëm dhe të ardhurat nga shërbimet dhe projektet e realizuara nga vetë ai. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen: ligji nr.8877, datë 4.4.2002 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja”, ligji nr.9023, datë 6.3.2003 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve”, si dhe nenet 12 e 13 të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”. Ligji ka 12 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.4.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26 të vitit 2006, në faqen 869.

Ligj nr.9498, datë 3.4.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Neni 74 i ligjit në fuqi trajton kompetencat e Këshillit Administrativ. Sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij neni, Këshilli Administrativ i propozon Ministrin të Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë ndryshimet në statusin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe në ligjin e sigurimeve shoqërore. Pas ndryshimit që bëhet, shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 74 ka këtë përmbajtje: “Këshilli Administrativ propozon te Ministri i Financave ndryshimet në statusin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe në ligjin e sigurimeve shoqërore. Neni 77 i ligjit në fuqi ka si titull “Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë”. Ky titull ka ndryshuar dhe bëhet: “Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Ministrinë e Financave”. Po në nenin 77 në pikën 1 fjalët “nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale”, zëvendësohen me fjalët “nëpërmjet Ministrisë së Financave.”. Në pikën 2 fjalët “do t’i

paraqesë Ministrin të Punës dhe Çështjeve Sociale”, zëvendësohen me fjalët “do t’i paraqesë Ministrin të Financave.” Në pikën 3 emërtimi “Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale” zëvendësohet me emërtimin “Ministri i Financave.” Në pikën 4 emërtimi “Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale” zëvendësohet me emërtimin Ministrinë e Financave.” Në nenin 78 fjalët “ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale” zëvendësohen me fjalët “ndërmjet Ministrisë së Financave.” Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.5.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.37 të vitit 2006, në faqen 1159.

Ligj nr.9499, datë 3.4.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në ligjin në fuqi, pra në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003, bëhen vetëm 2 ndryshime me ligjin nr.9499, datë 3.4.2006. Në nenin 20 të ligjit në fuqi janë përcaktuar kushtet për t’u zgjedhur anëtar i Komisionit të Konkurrencës. Sipas pikës “c” të këtij neni, për t’u zgjedhur anëtar i këtij Komisioni, ndërmjet të tjerash, kandidati duhet të jetë i njohur për kontributin në fushën e shkencave ekonomike dhe juridike ose për aftësitë drejtuese dhe profesionalitetin e shfaqur në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Me ndryshimin që është bërë, shkronja “c” e nenit 20 ndryshohet si më poshtë: “të jetë, prej jo më pak se 5 vjetësh, pjesëtar i trupit akademik universitar ose të mbajë titull apo gradë shkencore në fushën e ekonomisë a të drejtësisë, specialiteti “E drejtë civile/administrative.” Ndryshimi tjetër bëhet në nenin 22 “Papajtueshmëritë dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të Komisionit.” Sipas shkronjës “c” të pikës 3 të këtij neni, anëtari i Komisionit largohet nga detyra me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit, kur mungon në detyrë për më shumë se tre muaj në mënyrë të pajustificuar. Me ndryshimin që bëhet, koha e mungesës bëhet 1 muaj dhe konkretisht shkronja “c” e pikës 3 të nenit 22 formulohet si më poshtë: “mungon në detyrë mbi 1 muaj në mënyrë të pajustificuar.” Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.5.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.37 të vitit 2006, në faqen 1160.

Ligj nr.9500, datë 3.4.2006 “Për ratifikimin e protokollit shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi për bashkëpunimin kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij”. Ky Protokoll shtesë është bërë në Athinë më 3.12.2004 dhe është miratuar nga qeveritë e shteteve anëtare të organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) ku bëjnë pjesë: Republika e Shqipërisë, Republika e Armenisë, Republika e Azerbajxhanit, Republika e Bullgarisë, Republika e Greqisë, Republika e Moldavisë, Republika e Rumanisë, Federata Ruse, Serbia dhe Mali i Zi, Republika e Turqisë, Gjeorgjia dhe Ukraina. Ky Protokoll tregon preokupimin e shteteve të lartpërmendura se terrorizmi në të gjitha format dhe manifestimet e tij është një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, stabilitetin politik, ekonomik dhe social të palëve, për integritetin dhe sigurinë territoriale të shteteve anëtare të BEDZ-it, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore dhe të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh ndërmjet shteteve të rajonit të Detit të Zi. Sipas Protokollit Shtesë me fjalën “terrorizëm” nënkuptohen ato krime që përcaktohen si të tilla në Konventat dhe protokollat e Kombeve të Bashkuara mbi luftën kundër terrorizmit, dhe u vë detyrë palëve që të bashkëpunojnë për parandalimin, zbulimin, goditjen, demaskimin dhe hetimin e akteve të terrorizmit në bazë të Marrëveshjes së BEDZ-it dhe këtij Protokollit Shtesë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, si dhe me angazhimet ndërkombëtare të tyre. Nëse është e nevojshme, palët mund të krijojnë linja komunikimi urgjente, të kryejnë takime dhe këshillime të rregullta ose të jashtëzakonshme, dhe brenda kuadrit të Marrëveshjes së BEDZ-it dhe këtij Protokollit Shtesë të shkëmbejnë informacion, në mënyrë të veçantë për aktet e terrorizmit të planifikuara, për organizatat terroriste, grupet ose personat terroriste, tentativat dhe aksionet terroriste, organizatat dhe grupet terroriste që veprojnë në territorin e shteteve palë, organizatat dhe institucionet që mbështesin terrorizmin etj. Gjithashtu, u vihet detyrë palëve që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar

përgatitjen e akteve të terrorizmit në territorin e shteteve të tyre, kur këto akte terrorizmi do të kryhen në vende të tjera, si dhe për të refuzuar azilin për personat që kanë planifikuar ose marrë pjesë në përgatitjen e akteve terroriste. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.5.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38 të vitit 2006, faqe 1175. Ligjit i bashkëlidhet Protokollin Shtesë.

Ligj nr.9501, datë 3.4.2006 “Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë”. Palët në këtë Traktat janë Komuniteti European nga njëra anë dhe Palët Kontraktuese nga ana tjetër ku bëjnë pjesë Republika e Shqipërisë, Republika e Bullgarisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, ish-Republika Federale e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi, Rumanisë, Republika e Serbisë, Republika e Turqisë dhe Misioni i UNMIK-ut në Kosovë, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Përmes këtij Traktati, palët krijojnë ndërmjet tyre një Komunitet të Energjisë, kurse vendet anëtare të Komunitetit European mund të bëhen anëtarë të Komunitetit të Energjisë në bazë të nenit 95 të këtij Traktati. Detyrat e Komunitetit të Energjisë do të jenë: organizimi i marrëdhënieve ndërmjet Palëve dhe krijimi i kuadrit ligjor dhe ekonomik në lidhje me rrjetin energjetik. Veprimtaria e këtij Komuniteti përfshin kufizimin e një kuadri rregullues specifik që lejon funksionimin efikas të tregjeve të energjisë së rrjetit në territoret e Palëve Kontraktuese dhe në pjesë të territorit të Komunitetit European, si dhe krijimin e një tregu të energjisë së rrjetit, pa kufij të brendshëm, duke përfshirë bashkërendimin e asistencës së ndërsjellë në rastet e çrregullimeve të rënda të rrjeteve të energjisë ose defekteve të jashtme. Asgjë në këtë Traktat nuk do t’i prekë të drejtat e një pale, për të caktuar kushtet për shfrytëzimin e burimeve të saj të energjisë, zgjidhjen e saj ndërmjet burimeve të ndryshme të energjisë, si dhe strukturën e saj të përgjithshme të furnizimit me energji. Po ashtu ndalohet çdo diskriminim brenda fushës së veprimit të këtij Traktati. Përsa i përket shtrirjes gjeografike, parashikohet që dispozitat dhe masat e parashikuara për t’u ndërmarrë brenda

krerëve të Traktatit, do të zbatohen në territoret e Palëve Aderuese dhe në territorin nën juridiksionin e Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Gjithashtu, është parashikuar edhe hartimi i një liste të standardeve përgjithësisht të zbatueshme të Komunitetit European, që do t'i paraqitet për miratim Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, me qëllim që Palët Kontraktuese të hartojnë plane zhvillimi për të sjellë sektorët e tyre të energjisë të rrjetit në një linjë me standardet përgjithësisht të zbatueshme të Komunitetit European. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.5.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38 të vitit 2006, faqe 1175. Ligjit i bashkëlidhet Traktati me 105 nene dhe 4 shtojca.

Ligj nr.9502, datë 3.4.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës”. Më 29 janar 2004, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë është lidhur një Marrëveshje, ku kjo e fundit është angazhuar të financojë programin e emërtuar “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës”, me anë të një huaje të butë me një maksimum prej 6 000 000 euro. Kohëzgjatja deri në shlyerje do të jetë 38 vjet, kurse shlyerja do të bëhet në 42 këste të principalit, të barabarta gjysmëvjetore të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve bëhet i pagueshëm 210 muaj prej datës së disbursimit të parë. Norma e interesit nominale do të jetë 0.10 për qind e pagueshme në fund të çdo periudhe 6-mujore prej datës së çdo tërheqje. Huaja e butë do të përdoret për sigurimin e mallrave dhe të shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 30 për qind e shumës së referuar huasë së butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe të importit të mallrave dhe shërbimeve me origjinë prej vendeve në zhvillim. Huaja e Butë nuk mund të përdoret për të financuar taksat vendore, taksat doganore dhe TVSH-në. Marrëveshja do të qeveriset dhe rregullohet në përputhje me ligjin italian. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje është parashikuar që palët do të përpiqen

t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse këto përpjekje nuk do çojnë në ndonjë zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një periudhe kohe të arsyeshme, mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar. Nëse edhe këto përpjekje do të dështonin, mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nga një gjyq arbitrazhi prej tre arbitrash. Përveç Marrëveshjes janë edhe katër shtojca që kanë të bëjnë me rregullat dhe dokumentimin e marrjes së huasë. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.5.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.39 të vitit 2006, faqe 1207. Ligjit i bashkëlidhen Marrëveshja dhe katër Shtojcat.

Ligj nr.9503, datë 3.4.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR) dhe Protokollin e nënshkrimit”. Palët kontraktuese, duke njohur dobinë e standardizimit të kushteve që rregullojnë kontratën për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave, sidomos në lidhje me dokumentet për këtë transport dhe përgjegjësinë e transportuesit, kanë rënë dakord të hartojnë e monitorojnë në Gjenevë më 19 maj 1956 këtë Konventë. Kjo Konventë zbatohet për çdo kontratë transporti rrugor të mallrave në automjete me shpërblim, ku vendi i marrjes në dorëzim të mallrave dhe vendi i caktuar për dorëzim, sipas parashikimit në kontratë, ndodhen në dy vende të ndryshme. Në të parashikohet, gjithashtu, se kush janë personat për të cilët transportuesi është i përgjegjshëm. Kështu, transportuesi është i përgjegjshëm për veprimet ose mosveprimet e agjentëve dhe të shërbyesve të tij dhe të personave të tjerë, shërbimet e të cilëve ai i përdor për të kryer transportin, nëse këto agjentë, shërbyes ose persona të tjerë veprojnë në kuadrin e punësimit të tyre, sikurse këto veprime ose mosveprime të ishin të tijat. Gjithashtu, transportuesi përgjigjet për humbjen tërësore ose pjesore të mallit dhe për dëmtimin e tij, që ndodh nga çasti kur ai merr në dorëzim mallin deri në çastin e dorëzimit, si dhe çdo vonesë në dorëzim. Por transportuesi lirohet nga përgjegjësia nëse humbja, dëmtimi dhe vonesa janë shkaktuar nga veprimi i gabuar ose neglizhenca e

pretenduesit. Në Konventë janë parashikuar edhe mënyrat e procedurat e zgjidhjes së pretendimeve dhe padive të palëve, duke detyruar palët që paraprakisht t'i japin njëra-tjetrës ndihmë të arsyeshme për të bërë hetime dhe kontrollë të përshtatshme. Sqarohet, gjithashtu, edhe fakti që, në proceset gjyqësore që lindin nga transporti, në bazë të kësaj Konvente paditësi mund të ngrejë padi në çdo gjykatë ose autoritet të një vendi kontraktues që është caktuar në marrëveshjen midis palëve. Rregullim gjejnë në disa dispozita edhe problemet në lidhje me transportin e kryer nga disa transportues, ose rastet e pavlefshmërisë së dispozitave në kundërshtim me Konventën, problemi lidhur me buxhetin, me ratifikimin ose aderimin në këtë Konventë etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.5.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.39 të vitit 2006, faqe 1217. Ligji i bashkëlidhet Konventa.

Ligj nr.9504, date 3.4.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për transportin e mallrave me rrugë detare (Rregullat e Hamburgut)”. Dispozitat e kësaj Konvente janë të zbatueshme për të gjitha kontratat e transportit me rrugë detare midis dy shteteve të ndryshme, nëse porti i ngarkimit dhe porti i shkarkimit, siç parashikohet në kontratën e transportit me rrugë detare, ndodhen në një nga shtet palë kontraktuese. Përgjegjësia e transportuesit për mallrat sipas kësaj Konvente mbulon periudhën gjatë së cilës transportuesi merr në ngarkim mallrat në portin e shkarkimit. Transportuesi ka përgjegjësi për humbjen që rezulton ose për dëmin ndaj mallrave, si dhe nga vonesa në dërgimin e tyre, nëse ngjarja që shkaktoi humbjen, dëmin ose vonesën ka ndodhur, ndërsa mallrat ishin në ngarkim të tij, përveçse kur transportuesi provon që ai ka marrë të gjitha masat që mund të kërkoreshin në mënyrë të arsyeshme, për të shmangur këtë ngjarje dhe pasojat e saj. Në Konventë, përveç sa u tha më lart lidhur me përgjegjësinë, trajtohen edhe kufijtë e përgjegjësisë, aplikimi për dëmshpërblime jokontraktuale, humbja e së drejtës për kufizimin e përgjegjësisë etj. Janë parashikuar në një seksion të veçantë edhe përgjegjësitë e dërguesit. Një vend të rëndësishëm në Konventë janë edhe trajtimi i problemeve lidhur me dokumentet e transportit, ankesat dhe

paditë. Kështu tregohet se kur bëhet lëshimi i fletëngarkesës dhe si nënshkruhet ajo, cila është përmbajtja e fletëngarkesës, vërejtjet dhe evidentimi i tyre në fletëngarkesë, dokumentet e tjera veç fletëngarkesës etj. Lidhur me ankesat dhe paditë trajtohen si bëhet njoftimi i humbjeve, dëmtimeve ose vonesave, cili është juridiksioni në procedurat gjyqësore, cila është procedura që ndiqet etj. Përcaktime të tilla bëhen dhe u jepet zgjidhje edhe e problemeve me arbitrazhin, gjithmonë kur ndodhin mosmarrëveshje. Në fund trajtohen probleme të nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit dhe aderimit në këtë Konventë, probleme lidhur me rezervat, hyrjen në fuqi, rishikimin dhe amendimin e Konventës etj. Në fund gjendet edhe një Memorandum Mirëkuptimi dhe një Rezolutë e miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave në rrugë detare. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.5.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.40 të vitit 2006 në faqen 1235. Ligjit i bashkëlidhet Konventa, Memorandumi dhe Rezoluta.

Legal Analysis of Citizen's Complaints about the Judiciary

*Center for
Parliamentary Studies*

This legal analysis aims at identifying the legal and institutional background based on which the registration, examination, verification and proceedings of citizen's complaints about the judiciary is handled out, the relevant issues to be addressed and drawing recommendations for increasing the accountability of the judiciary toward the public. This activity is carried out in the framework of the project "Citizens' complaints on judicial inspection: increasing transparency and accountability of the judiciary toward the public" supported by USAID/Rule of Law Program .

I. CITIZEN'S COMPLAINTS ABOUT THE JUDICIARY

The Albanian Constitution of 1998, as the fundamental law provides for the right of citizens to file complains.

Everyone by himself or together with others may direct requests, complaints or comments to the public organs.¹

As in many European countries, in Albania there are three main institutions that have jurisdiction over the investigation of citizen's complaints about the judiciary. In this analysis, we will focus on the activity that the H CJ's

¹ Constitution of the Republic of Albania, article 48

Inspectorate, Ministry of Justice and the Office of the President of the Republic carry out in regard to citizen's complaints about the judiciary.

Law Nr. 8436, dated 28.12.1998 "On the Organization of the Judicial Power in the Republic of Albania", changed, and the Regulation on "Organization and Functioning of HCJ's Inspectorate"², has identified among other functions the role that the High Council of Justice and its Inspectorate play in the investigation of citizen's complaints.

The Ministry of Justice through its Inspectorate conducts and carries out disciplinary proceeding of the first and appellate court's judges. In addition to the regular investigation, the Ministry of Justice does also disciplinary proceedings based on the complaints received by citizens and institutions.³

According to the Constitution, the President of the Republic is the Chairman of the High Council of Justice.⁴ As the Chairman, he calls and leads the meeting of the High Council of Justice and sees the implementation of law during the holding of meetings and for the taking of decisions.⁵

The appointment of the judges is made by a Presidential decree upon the proposal of the High Council of Justice. The decision to propose to the President of the Republic the appointment of a judge is taken by a majority of the votes of the HCJ's members present and is announced publicly.⁶ During the last years, the President of the Republic, in a considerable number of cases, has not decreed the proposals of the HCJ. The first cases of non-

²Regulation on Organization and functioning of HCJ's Inspectorate, approved by decision no. 195, dated on 05.07.2003.

³ Law No. 8678, dated 14.05.2001 "On the Organization and Functioning of the Ministry of Justice", article 6 (9)

⁴ Constitution of the Republic of Albania, article 147 (2)

⁵ Law Nr. 8811 dated May 17, 2001 "On the Organization and Functioning of the High Council of Justice", article 11

⁶ Ibid, article 30

decreasing the HCJ proposals opened a wide discussion between the members of the HCJ, and among the legal community, in general. Many lawyers were of the opinion that the proposals of the High Council of Justice must be approved, thus, be decreed, by the President of the Republic, because the President does not have the constitutional competence to refuse the proposals of a professional body, such as the high Council of Justice. However, the constitutional provision sets the appointment of judges, in typical checks and balances format. Being so, the President may not, alone, make the appointment of a judge, unless he is sent a proposal by the High Council of Justice. By the same token, neither the HCJ is exclusive in the appointment of a judge, because the after its proposal, in order to finish the process of the appointment, a presidential decree is required.

The considerable number of refusals of HCS proposals brought up other discussions, such as whether the career of judges was violated or threatened. It is true that every judge a right to a career, but, on the other hand there is no obligation for the President of the Republic to promote those who do not meet the criteria and the standards to make a career. It is true that the candidates have met the criteria defined in law, and probably, that is what the HCJ has taken into consideration when voting its proposals. But, in this case, we are before the case of a potential right, not a substantial right. So, the criteria set in law, should be the initiating basis for the evaluation of a candidate, but the promotion of a judge includes other elements, which complete the judge's file, such, as: the necessary human and professional maturity for promotion, the necessary professional ability, and the necessary ethical standards.

The practice established by the President of the Republic for the reviewing of the information and the data on the proposals of the HCJ, is based in three groups of information: the amount of work and the quality of the judge's work (for example, the number of the tried cases, the number of cases overruled by higher courts, etc); the complaints of the citizens and the fol-

low up of this complaint, and information from other institutions. Thus, the complaints of the citizens are an important element in the evaluation of the work of a judge. The verification of a complaint from a citizen is made through the inspectorate of the HCJ.

This practice established by the President of the Republic was an innovation in the appointment procedures and promotion of judges. As such, maybe a more crystallize practice in decision making is needed. Possibly, it is natural, that the President of the Republic may not explain the motivations and reasons for decreeing or not decreeing a judge, because of the above mentioned reasons also. The president should not explain his discretion on judges' promotion. Furthermore, when, from specialized services there might be information that can not become public. Because of this, it might be necessary that judges at the moment of submitting their applications they undertake the responsibilities that the promotion has. Being so, they voluntarily give up from their immunity for this phase of the process, in order to make their appointment and promotion accordingly to the best standards possible. HCJ has seen as necessary to set a deadline within which the President of the Republic gives its decree or non decree of HCJ's proposal⁷.

What is the level of awareness among citizens about the right to file complaints?

The number of complaints submitted to the HCJ has increased. This is reflected in the number of complaints registered in the protocol's office and in the special register that the HCJ's Inspectorate keeps. Every year, there

⁷ Rregullore e Komisionit të Shqyrtimit të kandidaturave për gjyqtare. (Vendimi nr.137, date 21.02.2003). Neni 12 I kesaj rregulloreje percakton se ne qofte se Presidenti i Republikes brenda 30 diteve, nuk ben emerimin e kandidatit te propozuar nga Keshilli i Larte i Drejtesise, ky i fundit, nga kandidurat konkurrese, i paraqit Presidentit propozimin per nje kandidat tjetër.

are approximately 100 complaints submitted to the HCJ which don't consist of possible disciplinary violation.⁸

II JURISDICTION

Law Nr. 8811 dated May 17, 2001 “On the Organization and Functioning of the High Council of Justice”, and the Regulation on “Organization and Functioning of HCJ’s Inspectorate” provides for the duties and functions of the Inspectorate of the High Council of Justice.

The Inspectorate of the High Council of Justice verifies and sends to the Minister of Justice complaints of citizens that are directed to the High Council of Justice about actions of judges considered to be in conflict with proper fulfillment of duty. The Inspectorate verifies only those complaints that cannot be solved through a judicial appeal or for the exclusion of the members of the judicial body. It verifies the complaints of citizens and other subjects that are directed to the Minister of Justice and that are judged by him to be followed up by the Inspectorate of the High Council of Justice.⁹

A new regulation on the organization and functioning of the HCJ’s Inspectorate is in place. According to the conversations held with representatives of the HCJ’s Inspectorate, this regulation, which was approved and entered into force in July of 2006, consists of new elements which provide citizens with more thorough and comprehensive information. This regulation is accessible on Internet.

The High Council of Justice consists of the President of the Republic, the President of the High Court, the Minister of Justice, three members elected by the Assembly of the Republic of Albania and nine judges of all levels elected by the National Judicial Conference.¹⁰

⁸ Journal “Parliamentary Right and Legal Policies”, Publication No. 26 of the Center for Parliamentary Studies

⁹ Law Nr. 8811 dated May 17, 2001 “On the Organization and Functioning of the High Council of Justice”, article 16 (1) (a)

¹⁰ Ibid, article 3

The Inspectorate attached to the High Council of Justice consists of the Chief Inspector and the inspectors. The rules of organization and functioning and the number of inspectors are specified by the High Council of Justice. The Chief Inspector and the inspectors are named and discharged by the High Council of Justice on the proposal of the Vice Chairman. The candidacies of inspectors are selected, after a public announcement, from among the judges who meet the conditions to be named a judge in the Courts of Appeal and, in their absence, among jurists who have served as judges for no less than five years.¹¹

The object of activity of the HCJ's Inspectorate is focused on the gathering of data about the activity of courts and judges based on the verification of complaints, inspection of courts, inspection of judges and evaluation of their professional skills, based upon which the High Council of Justice exercises its legal responsibility.¹²

Effectively, there are six inspectors operating at the HCJ's Inspectorate. During the conversations held with the representatives of the HCJ's Inspectorate, it was stressed that the number of the inspectors currently operating is very limited and the work load is very high. The Chief Inspector decides which inspector will be in charge of the verification based on the work load of the inspector and the districts where he is working at the moment of the assignment. In reality, there are no criteria defined in law and regulation about the assignment of cases to the HCJ's inspectors and this might lead to certain level of subjectivity by the Chief Inspector.

III. REGISTRATION OF COMPLAINT

The Regulation on the Organization and Functioning of the Inspectorate of the High Council of Justice regulates the work and the activity of the

¹¹ Ibid, article 14

¹² Regulation "On the Organization and Functioning of the Inspectorate of the High Council of Justice", article 1

Inspectorate. The complaints addressed to the High Council of Justice may be filed through the mailing system or directly in the Protocol's Office. The complaints filed in the Protocol's Office are directly submitted to the Chief Inspector.

The complaints filed in the HCJ's Inspectorate, as well as the complaints made publicly through media are registered in the Register of Complaints. The Register of Complaints is divided into sections, such as the identity of the complainer, court or judge against whom the complaint is made, object of the complaint, the date of issuance of the verification order, inspector in charge of the verification, date of receiving of the complaint, date of the verification order and date of submission of the verification file by the inspector. The Register of Complaints is kept by the Chief Inspector.¹³

The register is kept manually and electronically, but the last one doesn't reflect the progress of the cases. The regulation of the HCJ's Inspectorate doesn't stipulate any specific provision that allows for the accessibility of the register by the public. As it was stated by the HCJ's Inspectorate, the register is accessible by the citizens. In this point of view, the missing of legal provisions that provide for the accessibility of the register doesn't necessary imply its prohibition, since there are no rules for that purpose.

IV. VERIFICATION OF THE COMPLIANT

The new Regulation on the Organization and Functioning of the Inspectorate of the High Council of Justice provides for comprehensive information about the form and object of the complaint. The complaint should at least include the following elements in order to be considered for verification by the HCJ's Inspectorate:

¹³Regulation "On the Organization and Functioning of the High Council of Justice's Inspectorate", article 25

a) Facts and circumstances that relate to the malfunctioning of the judge's office.

b) Facts and circumstances that might consist of a violation of the judicial duties which generally consist of lack of respect of law, of solemnity in the court's room, violation in the planning and organization of the work, breach of judge's behavior inside and outside the courtroom, or violation in the case of unjustifiable delay of the process.....

c) Facts and circumstances that might be considered as violation of the proper behavior and ethics of judge.¹⁴

The Regulation specifies the facts and circumstances that don't consist of the object of verification of the complaints. In this regard, the regulation has brought something new in terms of the necessary criteria for the beginning of a proceeding.

The Inspectorate has the obligation to verify only those complaints that cannot be solved through a judicial appeal or for the exclusion of the members of the judicial body.

BEGINNING OF THE VERIFICATION PROCESS

The verification process is regulated to some extent by the Regulation of the HCJ's Inspectorate. The Regulation doesn't provide for concrete and detailed steps that should be followed for the verification of the complaints. Once the complaint is submitted to the HCJ's Inspectorate, the Chief Inspector carries out the examination of the complaint.

According to the article 147/6, of the Constitution, the judge can be dismissed from HCJ for committing a crime, mental or physical disability, for acts that discredit the judges' position and image or for professional deficiency. The Inspectors don't deal with the essence of the case. So, to be in

¹⁴Regulation "On the Organization and Functioning of the Inspectorate of the High Council of Justice", article 24 (1)

compliance, as much as possible, with the constitutional provision, (which provides that the judge can be dismissed for professional reasons only if he violates work ethic or in case of professional deficiency) and also for a more realistic evaluation of a judge's work, HCJ has approved an evaluation system of judges, which has been tested in three pilot courts. The HCJ is actually analyzing the effects and changes in this evaluation system.

The HCJ's Inspectorate takes the point of view that the Chief Inspector is the only authority in charge of the complaints about the judiciary, including not only those which are submitted directly to the HCJ but also those which are referred to by other institutions such as President's Office, Ministry of Justice, Council of Ministers and People's Advocate.

During the conversations held with the Ministry of Justice's Inspectorate, it was emphasized that the Inspectorate of the Ministry of Justice carries out independent verification from those conducted by the HCJ's Inspectorate. According to the legal provisions in power, the HCJ's inspectorate and the Ministry of Justice Inspectorate have the authority to carry out independent complaint verification process from each other. In practice, both inspectorates may set up joint working groups to conduct verification process on the citizen's complaints.

The cooperation between two inspectorates is recently regulated based on a Memorandum of Cooperation which establishes a framework for an open and constructive working relationship between the Minister of Justice and the High Council of Justice with a view to establishing a common understanding and procedural framework for the waging of the function of controlling judges and courts which they share in accordance with the law. The Memorandum is not intended, by any means, to replace the relevant applicable provisions of the respective laws. Rather than addressing the issue of division of competences, it is a good will and mutually useful engagement instrument at the hands of the Minister and the HCJ with a two fold intention: overcoming legal confusion and lacunae on certain concepts

regarding the controlling of judges and courts and legal terminology, as well as streamlining the judicial inspection procedures and practice.¹⁵

The Memorandum of Cooperation states that based on the respective responsibilities assigned by law regarding verification of complaints made by individuals and juridical persons on alleged judicial or extra judicial breaches by members of courts of first and second instances, the Minister and the HCJ undertake to co-operate in respect of:

a. Standardizing the process of complaint verification. As a result, the services of control of judges and courts, of both the Ministry of Justice and High Council of Justice, shall be guided by a streamlined normative act detailing the steps to be undertaken in terms of actions and interactions, phases and timing, organization, resources and conditions required from the reception of a complaint to the submission of the verification reports to the respective authorities.

b. Standardizing the procedure of the registration of the complaints. The standardized procedure mentioned above shall provide for the set up of a complaint registry in both the Ministry of Justice and High Council of Justice, which is streamlined in terms of nature, contents and format thereby allowing for an effective data and information exchange as well as a shared computerized system to be installed in the future.¹⁶

V. ASSESSMENT OF THE COMPLAINT

The Regulation “On the Organization and Functioning of the Inspectorate of the High Council of Justice envisages preliminary evaluation of the compliant. In any case, after the Chief Inspector examines the complaint

¹⁵ Memorandum of Cooperation between the Minister of Justice of the Republic of Albania and the High Council of Justice of the Republic of Albania, dated 13 July 2006

¹⁶ Memorandum of Cooperation between the Minister of Justice of the Republic of Albania and the High Council of Justice of the Republic of Albania, dated 13 July 2006

and the attached materials, he examines if there is ground for verification. The Chief Inspector reports the complaint to the HCJ's Deputy Head and upon his approval, orders either the archiving of the complaint or the performance of the verification of the complaint. In the case when the complaint is assessed as inappropriate in terms of form and content and its archiving is ordered, an immediate response is given to the complainer by the Chief Inspector, in which are stated the reasons for non completion of verification.

In the case when it is evaluated that that there is ground for verification, the Chief Inspector, upon his order assigns one or more inspectors to the case.

The Deputy Head when he evaluates as appropriate, may ask the Chief Inspector to be in charge of the verification of the complaint.¹⁷ The Inspector besides the duties assigned at the Verification Order, verifies the verity of the claims raised by the complainer, as well as any other issue that is related to the functioning or the normal activity of the judge, that is evident and that might be considered as a disciplinary violation. In any case of verification, the inspector informs the Chief Judge and the respective judge, making him aware of the complaint and the Verification Order. Exceptionally, upon the order of the Deputy Head and the Chief Inspector, the judge may not be informed about the content of the complaint, when it is evaluated that this will cause an inappropriate situation but in any case the judge is informed about the claims of the complaint.

In the case when it is observed that the complaint is related to a case that is under judgment, the inspector should take all necessary measures and make all the efforts to ensure that his activity doesn't harm the independence of the judge. In this case, the verification is done only for claims re-

¹⁷ Regulation "On the Organization and Functioning of the Inspectorate of the High Council of Justice", article 27

lated to the delay of the court proceedings, or for issues related to the ethics of the judge.¹⁸

In compliance with the verification, the inspector prepares reports on all investigative actions carried out by him.

The verification of the complaint and the delivery of the information by the inspector to the Chief Inspector are made not later than 30 days from the day of registration of the complaint in the Register's of Complaints. This term might be postponed by the Chief Inspector on the inspector's request for legitimized reasons.¹⁹

The verification of the complaint may be completed upon:

The documentation of the case, when from the verification of the complaint, there are not facts or circumstances observed for the initiation of a special process or when they are insufficient or inappropriate by responding to the complainer. In this case the judge is informed about that.

The reports prepared by the inspector are presented to the Minister of Justice through the Chief Inspector for the initiation of the disciplinary proceeding against the judge, when there are such facts and circumstances observed that might be considered as appropriate to begin the disciplinary proceeding.²⁰

Judge's inspection is performed on the HCJ's decision.

The inspection of the judge might have an exploring character on the effectiveness of his activity or identifying character on his disciplinary violations.²¹

¹⁸ Ibid, article 30

¹⁹ Ibid, article 32

²⁰ Ibid, article 33

²¹ Ibid, article 36

VI. PROPOSAL OF THE DISCIPLINARY MEASURE

The carrying out of a disciplinary proceeding is regulated by Law “On the Organization and Functioning of the High Council of Justice” and Regulation “On Disciplinary proceedings of Judges”. The request for disciplinary proceeding is submitted to the HCJ by the Minister of Justice based on the reports submitted by the inspectors.

The Minister of Justice carries out inspections in implementation of duties set by the High Council of Justice, as a continuation of the process of verification of the complaints of citizens and juridical subjects, as well as according to data of which he is made aware on his own initiative or through the Inspectorate of the High Council of Justice.

At the conclusion of the inspection and on the basis of the results of the inspection, the Minister of Justice proposes a disciplinary proceeding of judges before the High Council of Justice and deposits the respective documentation with the High Council of Justice.

A request for a disciplinary proceeding, in addition to the documentation with the respective data that show the violations committed by the judge, also includes the proposal for the type of disciplinary measure that it is judged should be taken against the judge proceeded against.

The Inspectorate of the High Council of Justice, when it has been charged with duties of verification, is obligated to carry out the procedures of verification within 15 days and to deposit the respective report.

In every case, at the conclusion of the process of verification or inspection, the Minister of Justice, or the Inspectorate of the High Council of Justice, shall ask the person proceeded against to present his claims in writing, which must be reflected in the final documentation.²²

²² Law Nr. 8811 dated May 17, 2001 “On the Organization and Functioning of the High Council of Justice”, article 31

The proposal of the disciplinary measure should also rely on the claims and the evidence that the judge against whom this measure is proposed has presented before the inspector. The Constitutional Court has ruled on a case that related to the role of the Minister of Justice as an inspector and initiator. This ruling comprised the issue whether the Minister of Justice's role is constitutional or not. In this case, the Constitutional Court has decided that the role of the Minister of Justice is constitutional.²³ However, this debate on the role of the Minister of Justice as an inspector or initiator remains still open. The issue here remains the use of discretion of the Minister of Justice to not begin a disciplinary proceeding even when there is clear evidence against the judge. The Minister of Justice doesn't have to reason his decision before the HCJ even though he needs to notify the HCJ for his motivation for non-initiation of the disciplinary proceeding based on a complaint submitted by the HCJ to the Minister of Justice for verification.

There might be some solutions for this issue. For example, one is to ask the Minister of Justice to inform publicly the reasons for non-initiation of the disciplinary proceeding or to allow the HCJ to examine the case and decide on the initiation of the proceeding. Another solution is the delegation of competences on the initiation of the disciplinary proceeding to another body. As long as initiation of disciplinary proceeding is in Minister's discretion than HCJ can also have the competence to initiate a disciplinary case. So, by proposal of a member and approval of a majority of HCJ can initiate the disciplinary proceeding toward a judge.

Once the request is submitted to the Minister of Justice, this request is registered in the register of the Disciplinary Proceeding²⁴, which is kept by

²³ Constitutional Court Decision No.11 dated 27 May 2004

²⁴ Regulation "On the Disciplinary Proceeding of Judges", article 3

the Chief Inspector. Then, a meeting is fixed. The judge against whom the disciplinary proceeding is conducted should be notified on the date, time and venue, at least 48 hours before its beginning and the materials should be made available to him not earlier than ten days from the date of meeting”.²⁵

VII. EXAMINATION OF THE PROPOSAL

The disciplinary proceedings are discussed during the HCJ’s meetings and the normal provisions on the quorum and voting are applied. A meeting of the High Council of Justice is valid when no less than eight members take part in it.²⁶

The members of the High Council of Justice who are present at the meeting and who have no legal impediment to vote within the meaning of Article 37 of Law no 8485 dated May 12, 1999 “The Code of Administrative Procedure of the Republic of Albania” may not abstain.²⁷ The High Council of Justice takes decision by open voting. In the cases of voting on questions related to its members, the High Council of Justice, by a majority of votes of the members present, may decide to take decisions by secret voting. Members of the High Council of Justice who are in the conditions of a legal impediment do not take part in the discussion and voting process.

The Minister of Justice does not take part in the voting in the cases of disciplinary proceedings initiated by him, while the President of the Republic does not take part in the voting in the cases of proposals for appointment of judges. The chair of a meeting of the High Council of Justice votes last.²⁸ The High Council of Justice takes decisions by a majority of the votes of the members who are present at the meeting.²⁹

²⁵ Ibid, articles 5 and 6

²⁶ Law Nr. 8811 dated May 17, 2001 “On the Organization and Functioning of the High Council of Justice”, article 23

²⁷ Ibid, article 24

²⁸ Ibid, article 25

²⁹ Ibid, article 26 (1)

The Vice Chairman takes necessary measures for minutes to be kept at a meeting of the High Council of Justice. The members who took part in the meeting, the issues that were examined, the discussions of the participants, the decision-taking, and the form and result of the voting are noted in the minutes. After examination by the members of the High Council of Justice, the minutes are signed by the Vice Chairman. Every member of the High Council of Justice has the right to check the content of the minutes and to present his objections, which are made known to the High Council of Justice at the following meeting. Decisions of the High Council of Justice are deposited with the High Council of Justice together with the respective minutes. Every member of the High Council of Justice may ask that the fact that he voted against a decision taken, and the reasons for his vote, be noted in the minutes.³⁰

During the meeting, in the beginning the Minister of Justice brings up the case before the HCJ and after that, the right to be listened is given to the judge or his attorney. Every member of the HCJ has the right to direct questions to the judge, but nobody plays the role of the prosecutor.

Generally, the judges have been present in the meeting with the presence of an attorney, but none of them has brought witnesses or presented evidence before the HCJ. Meetings are held with closed doors. After conclusion of the presentation of the material by the Minister of Justice, protection of the judge by himself or attorney or both of them and the questions of the members of HCJ on the judge, the HCJ continues its discussion without the presence of the judge. The HCJ may ask the Inspector for further verification, for example more information on the unjust decisions given by the judge.

Even though, there is a legal vacuum, in general there are no complaints in relation to transparency of the process. The issue is whether the process complies with international standards. For example there in no legal provi-

³⁰ Ibid, article 27

sion that determines the standards of evidence before the HCJ decides whether the judge is responsible or not. Also, there are no legal provisions for presentation of witnesses from the judge. The preliminary notice on the meeting is short, especially for judges who reside and work outside of Tirana. Even though, the regulation provides for further inspection by the Inspectorate, the law doesn't stipulate a second meeting for the case.

Usually the meetings for disciplinary proceedings are carried out as regular meetings of the HCJ, where other issues, besides those of discipline may be analyzed. A special organization of these meetings with an ad hoc HCJ's commission may increase the focus over this important process. This will give a more formal atmosphere to this process.

VIII. TRANSPARENCY AND RESPONSIBILITY

Transparency and access to public information are key elements in a democratic society and serve to give media, civil society and other interested bodies the necessary tools to scrutinize how state power is used and resources are managed.³¹

Article 23 of the Constitution of Albania provides:

1. The right to information is guaranteed.
2. Everyone has the right, in compliance with law, to obtain information about the activity of state organs, and of persons who exercise state functions.

Article 11(4) of the Regulation of the Disciplinary Proceedings provides that HCJ decisions should be reasoned in all cases. There is no a predefined formulation of the decision, but in general it is aimed at following an outline starting with the description of proceedings of the court itself, a summary of the verification process followed by a summary of the legal and constitu-

³¹ See "Analysis of the Criminal Justice System of Albania", Report by the Fair Trial Development Project, OSCE 2006

tional base of the decision and the conclusion reached by the HCJ, and closing with the disciplinary measure taken by the HCJ. Usually, the HCJ's decisions consist of six pages. It is worth, also, to identify that HCJ has decided that, generally, its meeting will be open to the media. Its last four meetings, HCJ's proceedings, and those with a strong problematic have been opened to the media.

IX. APPEAL AGAINST THE DISCIPLINARY MEASURE

An appeal against a decision of the High Council of Justice for the discharge from duty of a judge, as well as every other measure of a disciplinary nature, is done by the latter to the High Court within 10 days from receipt of notification of the decision of the Council. The chairman or judges of the High Court, who, in their capacity as members of the High Council of Justice have taken part in the meeting of the High Council of Justice during which the disciplinary measure was taken against the appellant, do not take part in the judicial body of the Joint Colleges of the High Court.³²

The representation of the High Council of Justice in the High Court, in cases of appeal against a decision of the High Council of Justice, is done by a person authorized by the Council.

The authorization for the representation is signed by the Vice Chairman. In the text of the authorization, the name of the representative and the specific question on which he is authorized to be representative is shown in a clear manner.³³

The judge against whom the taking of disciplinary measures will be examined must be called to the HCJ meeting. He has the right to be defended by an attorney. The notification is made in one of the manners that the

³² Law Nr. 8811 dated May 17, 2001 "On the Organization and Functioning of the High Council of Justice", article 34

³³ *Ibid*, article 35

“Code of Administrative Procedure” contemplates. Non-appearance without good reason does not impede the High Council of Justice from examining and deciding on the measure.³⁴ There have been cases when the Constitutional Court or the High Court has rejected to HCJ decisions which the former has taken without the presence of the judge. For this reason, HCJ requires to be in accordance with the law and such decisions. But from the other hand, long duration of disciplinary proceedings for many months, leads in loosing the actuality of proceedings. Perhaps, it is necessary to decide the time limits that HCJ can wait for a judge to be present in the meeting, or if we are in front of often medical reports, to start proceeding with the presence of the judges’ attorney.

X. RECOMMANDATIONS

Jurisdiction

New criteria or standards should be defined to eliminate any possible influence or subjectivity that Chief Inspector might have on the assignment of cases to the HCJ’s inspectors. Transparency and responsibility are important in this decision-making.

REGISTRATION OF COMPLAINTS

In the framework of the right to information, new rules should be defined for the accessibility of the Register of Complaint by citizens. In this regard, a need for public awareness should be emphasized.

TRANSPARENCY AND RESPONSIBILITY

The provision on the reasoned decision is important for judges to know which are those matters and decisions that might consist of a breach of law.

³⁴ Ibid, article 33

The HCJ should make its decisions know in a broader scale. Usually, the publication of the disciplinary proceedings is published in the media, but the content of the decision is not published anywhere. The decisions may be distributed through various publications, for example by making the full content of the decision available on the HCJ's web page, by submitting copies of decisions to all judges or by publishing periodical reports on the disciplinary proceedings.

The computerization of the HCJ Inspectorate and the creation of internet pages where HCJ decisions are posted is a significant step towards a more transparent justice system in Albania. Apart from this, however, much remains to be done to give media and the general public the insight into the HCJ's decision-making process that is necessary in a democratic society based on respect for human rights and the rule of law. Thus, the HCJ need to establish internal rules as well as to create structures to respond diligently to requests for access.

